Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (154) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Portret

Edlira Haxhiymeri, pedagogia e përkushtuar për arsimin dhe shoqërinë

Nga **SHAQIR SKARRA**



Investime

Veip Salkurti, "shqiponja" që po kërkon lartësi të reja

Nga **OSMAN XHILI**



Kujtime

Dr. **Qemal Çadri**, mjeku legjendë i Dibrës

Nga Prof.as. **NAZMI KOÇI**



Rruga e Arbrit realizohen 30% e punimeve



Pamje nga punimet në Urën e Vashës. Ajo lidh dy tunelet në dy shpatet e malit. Ura përbëhet nga konstruksion metalik në një hark rihter. Ka 27 kolona paralel në të dyja anët e urës, të cilat ngrihen drejt lart. Ura ka një gjatësi hapësirë drite 160 metra, pjesa e kalueshme mbi konstruksion metalik është 220 metra, ndërkohë që vetë ura është 242 metra. (Foto: MIE)

- **Ministrja Balluku: "E gjithë pjesa e rrugës së Arbrit që ka mbetur për t'u ndërtuar është 54 km, në të cilën koncensionari ka realizuar më shumë se 28% të punimeve".**
- **TV Klan: Deri tani janë kryer 30% e punimeve totale të rrugës. Afati për të përfunduar totalisht segmentin është në fillim të vitit 2022, por inxhinierët e firmës thonë se nëse punimet vijojnë me këto ritme, aksi do të jetë gati në Pranverë të vitit 2021".**
- **Buxheti i shtetit lëvron 2.1 miliardë lekë për kompaninë Gjoka. Disa media të tjera e theksuan këtë faks si një favorizim që qeveria po i bën kompanisë në fjalë. Por në kontratën e nënshkruar mes qeverisë dhe kompanisë thuhet se "pagesat nga Autoriteti Kontraktor kundrejt Koncesionari, do të fillojnë, pasi Koncesionari të këtë kryer 25% të volumit të punimeve të parashikuara në grafikun e punimeve".**

LEXONI NË FAQE 2-3

PROPOZIMI I LID PËR KONFERENCËN SHKENCORE:

Çfarë duhet të bëjmë për një rigjallërim të ekonomisë në Dibër?

Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë, në bashkëpunim me organizata të tjera joqeveritarë do të mbajë gjatë muajit Maj një konferencë shkencore, ku do të evidentohen rrugët dhe mundësitë e rigjallërimit ekonomik me vënien në funksionim të rrugës së Arbrit.

NË BRENDËSI:

- **Ç'kemi** asaj Dibre
- **Gjyqe, borxhe** dhe shpyllëzim: Pasojat që lanë pas HEC-t në liqenet e Bulqizës
- **Bashkitë e Dibrës** nën "pushtetin" e qenve endacakë
- **Bulqiza** ndërtoi vendin, por vendi e harroi atë
- **Gjakhumburit** e jetëharruarit në kërkim të floririt...
- Kur pikonte rakia...
- **Profesor Egriu**, dibrani "ambasador" në Suedi
- Pse jo dhe varret...
- **Sinoret** e Luznisë
- **"Qesh e qaj me lot",** dëshmi e pjekurisë krijuese të Mevlud Bucit
- **Hafiz Xhemal Dibra**, intelektual, teolog dhe patriot i shquar
- **Përse u harrua Dibra** në këtë përvjetor të vdekjes së Skënderbeut?!
- **Në ashensor** - tregim nga Ramiz Gjini
- **Guri i vashës** - tregim nga Arian Kadiu
- Zyberi u flet të vdekurve
- Tre Hasanët
- Fjalë e frazeologjizma
- Lamtumirë miku ynë Ramazan Rama!
- Kryeinxhinieri fjalëpak e punëshumë

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 2 (154). Shkurt 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit mars 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Nazmi KOÇI
Xhafer MARTINI
Astrit DACI
Ahmet ÇAUSHI
Ramiz GJINI
Arian KADIU
Mevlud BUCI
Qazim SHEHU
Selman MËZIU
Hashim HOXHA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Ç’kemi asaj Dibre

Nga **BUJAR KAROSHI**

Shkurt 2019 - Në fillim të muajit na nderoi me praninë e saj në Dibër ministrja Balluku. Ajo shkoi te kantieri i Rrugës së Arbrit, se e thërriste detyra, te punishtja e jufkave, se e kishte porosi nga ministri i Bujqësisë dhe te një punishte e punimeve me grep, ngaqë është... grua. Po të ishte burrë, do të kishte bërë edhe një vizitë në galeritë e Bulqizës, meqë atje po aksidentohen e vdesin minatorë...

Një masiv shkëmbi u shemb në minierë. Iku në botën tjetër një minator... Tre të tjerë u përcollën për mjekim të specializuar disa ditë më pas... Por “specialistët” që mbajnë përgjegjësi për aksidentet, nuk kapën kurrë. Fajin, si gjithmonë, e kanë viktimat...

Uji vazhdon të mungojë në Peshkopi. Dhe kur mësohesh pa ujë, nuk të ngacmojnë as protestat për ujin. “Punë bulqizakësh: ngrenë kokën për ujin, mbyllin sytë për kromin...”

Këtë muaj kemi mbjellë pemë. Njëqind në filan fshat e njëqind në filan katund. Pesëdhjetë në këtë mal e njëzet në atë rrugë... I numërojmë pemët që mbjellim, i numërojmë hektarët që djegim.

Dibra është e bukur. Na e tregoi Ecovolis në mes të shkurtit. Me foto, me video, me mbjellje pemësh... Por, ca mbjellin pemë, ca mbjellin qese... Dhe vjen një i huaj e na i mbledh në Lurë, duke na nxjerrë erzin fejsbukëve të botës... S’kemi as ndonjë tenor dibran që të na përmirësojë imazhin me koncerte rreth botës... Ndaj na rrofshin rrahjet e gjoksit dhe mburrjet në facebook “O sa mirë me qenë dibranë”...

Ca kanë marrë lopatat e kazmat të mbjellin pisha, por ca të tjerë kanë kapur sëpatat të presin mollët... Përderisa kokrrat kalben në magazina, pse të mos i presim edhe drurët në ara... Në fund të vitit të njëjtin rezultat kanë...

Ky muaj ishte plot me protesta. Dhe protestaxhinjtë e Peshkopisë, kur arritën në Burrel, ia mbushën mendjen vetes që do ta rrëzojnë kryeministrin. Kur arritën në Tiranë, rrëzuan kërpudhën...

Ariu u mundua ta bllokonte lëvizjen e lirë të protestuesve - dhe qytetarëve, por rroftë Arusha që i solli protestuesit në Tiranë... dhe provuan shijen e gazit...

Dy deputetë na i dorëzuan mandatet. Por pa deputetë nuk mbetemi. Një besnike e LSI nuk e pyeti Monikën tonë, ndërsa u është hapur oreksi partive të vogla mos u vjen radha të marrin mandatin e Gjunkshit...

Qentë kanë msy në qytet. Pa leje dhe të pavaksinuar. Për t’i vrarë, nuk i vrasim dot, se nuk na lejojnë kafshëmbrojtësit, por plane për t’i hequr nga rruga kemi plot...

Shkurti u mbyll me një të mirë: na bëri edhe ne dibranëve me dosje. Na vunë edhe damkën 184. Tani mund të themi me krenari se jemi të vaksinuar nga virusi i vjedhje-blerjes së votës, si gjithë Shqipëria...

Ministrja Balluku: “E gjithë pjesa e rrugës së Arbrit që ka mbetur për t’u ndërtuar është 54 km, në të cilën koçensionari ka realizuar më shumë se 28% të punimeve”.

TV Klan: Deri tani janë kryer 30% e punimeve totale të rrugës. Afati për të përfunduar totalisht segmentin është në fillim të vitit 2022, por inxhinierët e firmës thonë se nëse punimet vijojnë me këto ritme, aksi do të jetë gati në Pranverë të vitit 2021”.

Buxheti i shtetit lëvron 2.1 miliardë lekë për kompaninë Gjoka. Disa media të tjera e theksuan këtë faks si një favorizim që qeveria po i bën kompanisë në fjalë. Por në kontratën e nënshkruar mes qeverisë dhe kompanisë thuhet se “pagesat nga Autoriteti Kontraktor kundrejt Koncesionari, do të fillojnë, pasi Koncesionari të këtë kryer 25% të volumit të punimeve të parashikuara në grafikun e punimeve”.

“RRUGA E ARBRIT është një vepër shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të zonës. Gjëja më e rëndësishme është që duhet të përfundojë në kohë, duhet të përfundojë me cilësi”, - deklaroi Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku gjatë një vizite në kantierin e Rrugës së Arbrit në fillim të shkurtit 2019.

Në këtë vizitë ajo shoqërohej nga deputetja e Dibrës Almira Xhembulla, kryetari i bashkisë së Peshkopisë dhe pronari i kompanisë Gjoka Konstruksion.

Balluku, siç njoftoj zyra e shtypit pranë kësaj ministrie, inspektoi punimet në kantierin e urës së Vashës, e cila lidh tunelet T5 dhe T6.

Ministrja Balluku ka parë nga afër ecurinë e punimeve dhe është njohur me volumet e punës që janë kryer deri tani. Vepra ka hyrë tashmë në fazën përfundimtare të betonimit dhe hidroizolimit. Ritmet e mira të ecurisë së punës premtojnë për një përfundim të rrugës përpara afatit të parashikuar në kontratë.

“Koçensionari do të ketë vetë mirëmbajtjen e rrugës për 10 vjet, kështu që cilësia është absolutisht një nga kërkesat kryesore, por që dhe juve do t’ju duhet për vazhdimësinë. Shpresojmë të mbarojmë përpara afatit për t’ja dhënë shqiptarëve këtë arterie jashtëzakonisht të rëndësishme sa më parë në përdorim” është shprehur ministrja Balluku .

Ura e Vashës lidh dy tunelet në dy shpatet e malit. Ura përbëhet nga konstruksion metalik në një hark rihter. Ka 27 kolona paralel në të dyja anët e urës, të cilat ngrihen drejt lart. Ura ka një gjatësi hapësirë drite 160 metra, pjesa e kalueshme mbi konstruksion metalik është 220 metra, ndërkohë që vetë ura është 242 metra.

“E gjithë pjesa e rrugës së Arbrit që ka mbetur për t’u ndërtuar është 54 km, në të cilën koçensionari ka realizuar më shumë se 28% të punimeve”, thekson njoftimi për shtyp i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

“Në bazë të kontratës rruga duhet të përfundojë brenda 44 muajsh, por me volumin e kryer dhe me angazhimin e koçensionarit pritet që rruga të përfundojë më herët”, mbyllet njoftimi nga Zyra e Shtypit.

Pak ditë më parë ishte edhe Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cila ka inspektuar punimet e “Rrugës së Arbrit”, në afërsi të urës së Drinit që është drejtë përfundimit.

Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) citon ministren Xhaçka të ketë thënë se “Rruga e Arbrit’ përveçse lidh Dibrën me Tiranën, në këtë segment këtu pranë urës së Drinit, zgjidh edhe disa probleme që kemi pasur me parë”.

“Puna në ‘Rrugën e Arbrit’ vijon në të gjithë gjatësinë e saj dhe bashkë me veprat e artit, në Gjoricë po ndërtohet edhe argjinatura, e cila pritet të ulë rrezikun e përmbytjeve, ndërkohë që për banorët do të shtohen mbikalimet, për të lëvizur sa më lehtë nga njëra anë e rrugës në tjetrën”, u shpreh ministrja.

ATSH njofton se punimet po ecin me ritëm të shpejtë ndërsa ka përfunduar ura e Cerenecit dhe është në përfundim ura e Drinit me një gjatësi 260 ml.

Por që nga dita kur kanë filluar punimet, rreth një vit më parë, televizioni KLAN realizoi një kronikë në terren në Rrugën e Arbrit, aty ku po punohet në dalje të Tiranës, pranë Qafës së Tujanit.

“Në kilometrin e 7 të Rrugës së Arbrit, sapo kalon tunelin e parë që lidh kryeqytetin me Dibrën, punimet kanë ecur me 80%”, thotë gazetarja. Ky është kantieri i parë që kompania po punon për ndërtimin e këtij segmenti.

Inxhinieri Laurant Bahollari i tha TV Klan se “deri në fund të muajit Mars, ky aks i rrugës deri në kilometrin e 13-të do të jetë gati për të hedhur shtresën asfaltike”.

“Përfundimi i kilometrave të para do të lidhë fshatrat përgjatë Zall Bastarit me Tiranën. Edhe për disa kilometra të tjera, punimet vazhdojnë për sheshimin e rrugës dhe përgatitjen e saj për të hedhur shtresën asfaltike”.

“Më pas nuk ka më rrugë. Kompania që po ndërton segmentin ka hapur në mal rrugë ndihmëse për të realizuar punimet në tunelin e Murrizit”.

“Këtu po ndërtohen dy tunele, njëri i cili ka vëllim më të vogël do të jetë për emergjencat, ndërsa i madhi, me volum 240 metër kub do të shërbejë për automjetet kur të hapet rruga”, thotë inxhinier Bahollari.

Të dy tunelet kanë një gjatësi prej 3.2 kilometrash. Ky kantier është edhe pika e fundit e kalueshme në këtë rrugë nga Tirana. Për të shkuar në afërsi të Urës së Vashës, një tjetër vepër arti në infrastrukturën rrugore, mundësia e vetme është në rrugën e vjetër, atë që kalon nga Burreli.

Punimet në Urën e Vashës do të arrijnë të bashkojnë dy shpate mali, ku në secilin prej tyre ndodhen dy tunelet e fundit: tuneli 5 dhe 6. Ura do të jetë e gjitha konstruksion metalik me 27 kolona paralele në të dy anët e saj, të cilat ngrihen lart. E gjithë gjatësia e kalueshme mbi të është 220 metra.

Kronika e TV Klan thekson se “deri tani janë kryer 30% e punimeve totale të rrugës. Nga 70 kilometra, kanë mbetur për t’u ndërtuar edhe 54 të tjera. Afati për të përfunduar totalisht segmentin është në fillim të vitit 2022, por inxhinierët e firmës thonë se nëse punimet vijojnë me këto ritme, aksi do të jetë gati në Pranverë të vitit 2021”.

GJOKA KONSTRUKSION MERR 2.1 MILIARDË NGA BUXHETI I SHTETIT

Publiku duket se është i informuar se pagesat e buxhetit të shtetit për kompaninë kon-

Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë, në bashkëpunim me organizata të tjera joqeveritarë do të mbajë gjatë muajit Maj një konferencë shkencore, ku do të evidentohen rrugët dhe mundësitë e rigjallërimit ekonomik me vënien në funksionim të rrugës së Arbrit.

Rruga e Arbrit
realizohen 30% e punimeve



Pamje nga punimet në Urën e Vashës. Ajo lidh dy tunelet në dy shpatet e malit. Ura përbëhet nga konstruksion metalik në një hark rihter. Ka 27 kolona paralel në të dyja anët e urës, të cilat ngrihen drejt lart. Ura ka një gjatësi hapësirë drite 160 metra, pjesa e kalueshme mbi konstruksion metalik është 220 metra, ndërkohë që vetë ura është 242 metra. (Foto: MIE)

censionare do të fillojnë kur rruga të vihet në funksion, por duket se realisht nuk është kështu. Gazeta "Shekulli" më 18 shkurt raportoi se nga buxheti i shtetit janë lëvruar 2.1 miliardë lekë për kompaninë Gjoka. Disa media të tjera e theksuan këtë faks si një favorizim që qeveria po i bën kompanisë në fjalë.

Por, pavarësisht se informacionet e deritanishme flasin për pagesë pas përfundimit të punimeve, në kontratën zyrtarë të qeverisë shqiptare e kompaninë Gjoka, të botuar në fletoren zyrtare nr.50/2018, në nenin 27, ku flitet për pagesat, thuhet se "pagesat nga Autoriteti Kontraktor kundrejt Koncesionari, do të fillojnë, pasi Koncesionari të këtë kryer 25% të volumit të punimeve të parashikuara në grafikun e punimeve. Pavarësisht përcaktimit në paragrafin e mësipërm, Koncesionari do të paguhet për punimet e kryera në fund të vitit të pare (pasi kontrata të jetë bërë efektive) vetëm nëse ka kryer mbi 20% të volumit të parashikuar të punimeve".

"Pagesa që Autoriteti Kontraktor do të detyrohet të paguajë gjate gjithë kohëzgjatjes së kontratës për realizimin e objektit të saj, është një vlere prej 33,600,000,000 (tridhjete e tre miliardë e gjashtëqind milionë) lekë plus TVSH-ne, e cilado të paguhet sipas Modelit Financiar të rene dakord mes palëve. Autoriteti Kontraktor do të kryejë pagesat vjetore në 4 (katër) këste të barabarta çdo 3 (tre) muaj. Për efekt të llogaritjes së një viti sipas këtij neni, 1 (një) vit do t'i referohet një periudhe kohore prej 365 ditësh nga data e fillimit të zbatimit të kontratës", thuhet mes të tjerash në kontratën e botuar në fletoren zyrtare.

Por gazeta "Shekulli" ka zbulua se kur punimet e ndërtimit të përfundojnë, një tarifë do të zbatohet për kalimin e rrugës.

"Kompania ka kërkuar të aplikohet një tarifë mesatare 4 euro për makinë dhe propozon që të ardhurat të ndahen me qeverinë në nivelin 50 për qind. Fluksi mesatar i mjeteve në rrugë pritet të jetë 3690 makina/ditë. "Duke aplikuar një tarifë mesatare prej 4 eurosh/ makinë të ardhurat nga pagesa e kalimit të rrugës do të jenë rreth 53 milionë euro për një periudhë 10-¬vjeçare. Gjysmën e kësaj shume prej 26.5 milionë eurosh e përfiton kompania dhe kjo vlerë zbritet nga shuma totale e të ardhurave nga shteti" shkruhet në shkrimin e "Shekullit" të datës 18 shkurt 2019.

* * *

Kryeministri Edi Rama mëngjesin e 11 shkurtit përcolli një video nga punimet e deritanishme në Rrugën e Arbrit me shënimin "... me këto pamje që s'kanë nevojë për koment nga kantieri i Rrugës së Arbërit, duke ju siguruar të gjithë se sa më shumë të lehin qentë aq më të frymëzuar e të vendosur jemi për ta bërë Shqipërinë që duam".

Por në një muaj ku situata politike në vend është mjaft e tensionuar, shumë qytetarë janë skeptikë nëse punimet do të vazhdojnë nëse ka ndryshime në qeverisje.

"Ndryshimet politike në vend mund të ndikojnë në vonesë të punimeve në rrugë, por ato nuk do ta cënojnë vazhdimësinë", i tha gazetës një burim nga kompania Gjoka Konstuksion.

Portali "Tesheshi" e cilësoi mesazhin e Kryeministrit si një "sindrom rrahgjoksi si i paraardhësit të tij Berisha me Rrugën e Kombit".

"Ajo po ndërtohet, pritet të jetë dhe e standardeve të larta, por në terma ekonomikë ka pikëpyetjet e veta. Sepse fundi i saj është një asgjëkund. Ajo do afrojë fizikisht afro 20 mijë banorë të Dibrës me Tiranën, por kjo jo domosdoshmërisht përkthehet në impakt ekonomik aq sa për ta përligjur këtë vepër gjigante infrastrukturore", shkruan portali onlinë.

Megjithëse numrit të banorëve i mungon një "zero", duket se shkrimi më shumë se për të përcjellë një të vërtetë synon të bëjë një analizë kundër kryeministrit. Sipas INSTAT, popullsia e qarkut të Dibrës është 119 mijë banorë më 1 janar 2019, dhe duke marrë parasysh dibranët që jetojnë në Tiranë e Durrës, si dhe ata përtej kufijve shtetërore, rruga do të bëjë një lidhje të drejtpërdrejtë të më shumë 500 mijë shqiptarëve. Ndërsa duke pasur parasysh lidhjen e shkurtër me kryeqytetin, ajo do të jetë një urë komunikimi të më shumë se 1 milionë shqiptarëve.

Nisur nga efekte pozitive që do të luajë në ekonomi kjo rrugë, shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë, në bashkëpunim me organizata të tjera joqeveritarë do të mbajë gjatë muajit Maj një konferencë shkencore, ku do të evidentohen rrugët dhe mundësitë e rigjallërimit ekonomik me vënien në funksionim të rrugës së Arbrit.

Korresp. Rr.A.

PROPOZIMI I LID PËR KONFERENCËN SHKENCORE PËR RRUGËN E ARBRIT:

Çfarë duhet të bëjmë për një rigjallërim të ekonomisë në Dibër?

Kryesia e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë"në takimin e organizuar në Nëntor të vitit 2018 ka vendosur që në muajit prill të vitit 2019 të organizojë një ekskursion për të vrojtuar ecurinë e punimeve të Rrugës së Arbrit dhe në fillim të muajit maj, në kuadrin e 12 vjetorit të mbajtjes së Kuvendit Tekniko Shkencor të vitit 2007, të organizojë një Konferencë shkencore ku të referohet për punën e kryer deri në prill 2019 për Rrugën e Arbrit si dhe të shihet mundësia e nxitjes së vazhdimit të rrugës së Arbrit në territorin e Maqedonisë dhe të mbahen disa referate për përmirësimin edhe ndërtimin e rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbrit në të gjithë territorin e Qarkut të Dibrës

Brenda kryesisë së shoqatës është po qarkullon një projekt-programi i Konferencës për të tërhequr mendime, vërejtje e sugjerime.

Gjatë muajit prill do të organizohet një ekskursion gjatë gjithë trasesë së Rrugës së Arbrit për tu njohur me ecurinë e punimeve të ndërtimit të kësaj rruge deri në atë periudhë. Në këtë ekskursion do të marrin pjesë pothuajse të gjithë anëtarët e kryesisë së shoqatës, specialistët e grupeve që do të referojnë në këtë konferencë. Gjithashtu, shoqata ka bërë edhe një njoftim publik për ata qytetarë që kanë dëshirë t'i bashkëngjiten këtij marshimi.

Në referatet që do të mbahen në Konferencë do të përshkruhet gjendja e rrugëve të brendshme brenda njësive përkatëse administrative, përmirësimi dhe ndërtimi i tyre (aty ku nuk ka rrugë) për t'u lidhur me aksin kryesor të Rrugës së Arbrit për t'i shërbyer në të ardhmen zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë duke përshkruar shkurt, pasuritë nën tokësore e mbitokësore (pasuritë minerale, ujore, pyjore, kullotat, tokat arë për prodhimet bujqësore e frutikulturën) dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit historik e malor duke përshkruar shkurt vendet historike të zonës dhe gjeomonumentet, hidromonumentet, biomonumentet dhe bukuritë e tjera natyrore që i ka falur natyra këtyre zonave të begata.

Kryesia e LID është e hapur ndaj mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me këtë konferencë, qoftë me kontribute vullnetare në organizim, qoftë me ofrimin e materialeve për referim. Vendi dhe data e kësaj konference do të njoftohet më vonë përmes gazetës Rruga e Arbërit ose rrjeteve sociale.

Rruga e Arbërit nr. 154

Punimet për ndërtimin e HEC-eve që furnizohen nga një grup liqenesh mes Valikardhës dhe Martaneshit, përfshirë Liqenin e Zi që është monument natyre, kanë krijuar një varg konfliktesh dhe procesesh gjyqësore mes kompanisë, autoriteteve dhe banorëve.

aktualitet

Gjyqe, borxhe dhe shpyllëzim:

Pasojat që lanë pas HEC-t në liqenet e Bulqizës

Nga **HYSEN LIKDISHA**
SAMI CURRI

Në dhjetor 2018, bashkia e Bulqizës paditi kompaninë "Teodori 2003" me pretendimin se i detyrohej 34.5 milionë lekë qira të papaguar dhe kamatëvonesa. Sipas akt-padisë, kompania që ka prej vitit 2003 një kontratë koncesionare me qeverinë për të ndërtuar HEC-e duke shfrytëzuar ujin e disa liqeneve akullnajore, duhej t'i paguante bashkisë qira për shfrytëzimin e fondit pyjor, në bazë të kontratave të lidhura më herët me ish-Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të Bulqizës.

Bashkia pretendon se qiraja nuk është paguar, ndërsa ka refuzuar të lidhë një kontratë të re me kompaninë për pjesë të tjera pylli, që kjo e fundit kërkon të shfrytëzojë. Në një përgjigje për BIRN, bashkia tha se kompania "Teodori 2003" kërkonte ekonomitë pyjore në Luçan dhe Batër dhe se punimet synonin të devijonin ujërat e liqenit të Sopeve.

"Zhvillimi i këtyre punimeve prek zonën e Martaneshit dhe për pasojë sjell një impakt negativ social në këtë krahinë,"tha Bashkia e Bulqizës, duke shtuar se nuk mund të kishte një kontratë të dytë pa paguar detyrimet e së parës.

Refuzimi i bashkisë nuk e pengoi kompaninë të vijonte punimet dhe të shpyllëzonte zonën ku pritet të kalojë tubacioni. Megjithatë, konflikti me bashkinë nuk është i vetmi për të.

Ndërtimi i Hec Tërnovës dhe punimet për devijimin e ujërave të Liqenit të Sopeve kanë sjellë prej vitit 2014 përplasje të ashpra me banorët e fshatrave që preken. Banorët e zonës së Valikardhës dhe Martaneshit kundërshtojnë punimet me argumentin se devijimi i ujit të liqeneve u shkatërron atyre ekosistemin, u cënon mundësitë për vaditje dhe madje edhe furnizimin me ujë të pijshëm.

BIRN mësoi gjithashtu se kompania ka dhe një mori problemesh me nënkontraktorë të saj të cilët pretendojnë se ajo u ka borxh qindra mijëra euro prej punimeve të papaguara.

"Kam punëtorë të papaguar dhe detyrime të prapambetura," tha Ilir Balla, administrator i kompanisë AR=BA 06, i cili shtoi se ndërtuesi i HEC-it i detyrohet atij dhe një kompanie partnere rreth 900 mijë euro.

Teodori 2003 është një biznes shqiptaro-kanadez, me aksionerë Faik Teodorin dhe Shefikat Ngjelën me nga 35 për qind të aksioneve dhe kompaninë kanadeze Albania Hydro Investment Holding me 30 për qind. Kompania ka marrë me koncesion ndërtimin e HEC Tërnovës dhe atë të Zallit të Bulqizës me një investim prej 18.5 milionë eurosh. Kompania ka marrë një finacim nga BERZH me vlerë 6 milionë euro.

Drejtori ekzekutiv i kompanisë Teodori 2003, Erion Komino kundërshtoi pretendimet e bashkisë së Bulqizës, duke e quajtur sulmin e saj të qëllimshëm. Ai tha gjithashtu se kompania ishte në pritje të supervizimeve dhe matjes së volumeve të punës për nënkontraktorët.

"Shteti vendoset në shërbim të privatëve të tjerë, të konkurencës," pretendoi Komino për BIRN.

Edhe njëri prej aksionerëve, Faik Teodori kundërshtoi akuzat dhe mohoi që kompania të kishte shkaktuar dëme në mjedis. Ai e quajti HEC-in e ndërtuar "një mrekulli", ndërsa shtoi se banorët ishin shumë të kënaqur me të.

"Duhet të shkosh të pyesësh tani çfarë mendojnë për HEC-in", tha Teodori. "Pyet ata që organizuan protestat," shtoi ai.



Liqeni i Zi në Valikardhë të Bulqizës, i shpallur monument natyror. Foto: Geri Emiri.

NJË FILLIM ME KONFLIKT

Kompania koncesionare në Bulqizë është vetëm një prej dhjetra të singjashmeve në konflikt me komunitetin dhe pushtetin vendor. Dhënia e qindra licensave për HEC-e të vogla, pa konsultim me banorët u shoqërua me konflikte dhe protesta të dhunshme anekënd vendit.

Dhjetra koncesione të tilla janë dhënë në zona të mbrojtura, përfshirë Luginën e Valbonës apo së fundmi Kanionin e Holtës. Ndërkohë plane për ndërtim HEC-esh ka edhe në Vjosë dhe në një mori përrejsh në të gjithë vendin, pavarësisht kundërshtimit të banorëve dhe ambientalistëve.

Në Bulqizë, banorët e intervistuar nga BIRN nuk ndajnë të njëjtin mendim me Faik Teodorin për efektet e HEC-eve. Miftar Jangulli, banor i Zerqanit tha në një bisedë telefonike se problemet me HEC-in nuk ishin zgjidhur dhe se ndërhyrjet në rrjetin e ujit të pijshëm për nevojat e kompanisë kishin krijuar problem edhe për këtë të fundit.

"Pasi i çon në burg, u pret krahët banorëve... pastaj nuk ka më probleme," tha Jangulli.

Bashkë me 7 persona të tjerë, Jangulli u dënua nga Gjykata e Apelit në Tiranë me gjobë 100 mijë lekë për akuzën e shaktërrimit të pronës, pas disa protestash kundër kompanisë Teodori 2003 dhe projektit të saj për ndërtimin e "HEC Tërnovë" në vitin 2014.

Një studim i Bankwatch, një organizatë e cila monitoron investimet e financuara nga para publike, përfshi ato të kredituara prej Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) në vitin 2017, gjeti se projekti cënonte mjedisin dhe konfliktet me banorët ishin shkaktuar për shkak të mungesës së konsultimit. Sipas raportit të Bankwatch, protesta të dhunshme pati edhe në vitin 2015 dhe 2016.

Raporti thotë se protestat filluan pasi banorët nuk ishin konsultuar më parë dhe nuk kishin informacion se çfarë po ndodhte dhe ishin të frikësuar për humbjen e ujit për vaditje, ujit të pijshëm e tharjen e kullotave që shfrytëzonin për bagëtitë.



Tubacionet e HEC-it që furnizohet me ujin e liqenit. Foto: Geri Emiri.

Bashkia pretendon se qiraja nuk është paguar, ndërsa ka refuzuar të lidhë një kontratë të re me kompaninë për pjesë të tjera pylli, që kjo e fundit kërkon të shfrytëzojë. Bashkia tha se kompania "Teodori 2003" kërkonte ekonomitë pyjore në Luçan dhe Batër dhe se punimet synonin të devijonin ujërat e liqenit të Sopeve. Drejtori ekzekutiv i kompanisë Teodori 2003, Erion Komino kundërshtoi pretendimet e bashkisë së Bulqizës, duke e quajtur sulmin e saj të qëllimshëm.

Sipas raportit, kompania e kishte marrë koncesionin në vitin 2003, kishte nënshkruar një kontratë të dytë me qeverinë shqiptare në vitin 2007, kishte marrë leje nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë [tani KKT] në vitin 2009 dhe lejen mjedisore në gusht 2013, pa kryer asnjë takim me banorët e zonës së prekur.

"Komuniteti mësoi për projektin e planifikuar vetëm kur kompania solli makineritë dhe filloi pastrimin e pyllit në vitin 2013,", thuhet në raportin e titulluar 'Rastet e konflikteve ujore të lidhura me zhvillimin e hidroenergjisë në Shqipëri'.

I pyetur nga BIRN për këto konkluzione, aksioneri Faik Teodori tha se të gjitha problemet ishin sheshuar, ndërsa shtoi se çështjet e ngritura nga Bankwatch për shpyllëzim masiv dhe rrezik nga erozioni nuk ekzistonin.

"Ne bëmë një digë të re që shërben për vaditje. Banorët e fushës së Valikardhës vadisin me ujin e HEC-it," tha Teodori. Ai pretendoi gjithashtu se HEC-i nuk cënonte Liqenin e Zi si monument natyre, pasi ujin e merrte nga një digë e ndërtuar në vitin 1983, që kishte shërbyer për vaditje.

"Kemi pyllëzuar shumë herë më shumë se sa kemi prerë", tha ai duke shtuar se bëhej fjalë për një investim miliona euro të BERZH, që kishte standarde të larta. Ai pretendoi se po te pyeteshin sot banorët që kishin protestuar, ata do të shpreheshin ndryshe.

Rasim Toska, një tjetër banor i dënuar nga gjykata pas protestës së vitit 2014 tha se vetëm një pakicë mund të ishte e kënaqur, të cilën ai e quajti "të blerë".

"Ne jemi njerëz të vuajtur, e ndjejmë frikën dhe presionin," tha Toska, duke shpjeguar se pas arrestimeve, banorët nuk kishin protestuar më.

KONFLIKTI ZBRET NË GJYKATË

Përplasja me banorët nuk qe i vetmi problem i HEC Tërnovës. Një dokument i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, AKBN i vitit 2015 vëren se megjithëse prekte ujërat e dy ujëmbledhësve të mëdhej, kompania kishte marrë miratim vetëm prej Këshillit të Basenit Ujëmbledhës (KBU) të Drinit.

Mungesa e një miratimi nga KBU Mat duhej të krijonte pengesa për devijimin e ujërave nga liqeni i Sopës drejt Liqenit të



Godina e HEC Ternovës në Bulqizë. Foto:Geri Emiri.

Zi, por punimet në këtë pjesë të projektit kanë vijuar. Të dhënat e siguruara nga BIRN tregojnë se kompania vijoi të punonte në zonë, pavarësisht kundërshtimit të banorëve të Martaneshit që humbasin një prej burimeve kryesore të ujit dhe atë të bashkisë Bulqizë për të lidhur kontratë për shfrytëzimin e pyllit.

Shpyllëzimi i disa parcelave pyjore për t'u hapur rrugë makinerive dhe tubacioneve që do të marrin ujin nga liqeni i Sopës u bë shkak për një konflikt gjyqësor mes kompanisë, bashkisë së Bulqizës dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave (ISHMPU) Dibër.

Sipas një vendimi të Gjykatës Administrative të Tiranës të tetorit 2017, bashkia e Bulqizës i kërkoi Inspektoratit Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave të merrte masa për shpyllëzimin. Vendimi i gjykatës tregon se ISHMPU ushtroi kontrolle në parcelat e prekura prej kompanisë dhe konstatoi dëm në vlerën 102 milionë lekë.

ISHMPU Dibër dhe Bashkia Bulqizë si palë e tretë pretenduan se kompania Teodori 2003 kishte prerë dhe dëmtuar pyll për të cilin nuk kishte kontratë "për marrje në përdorim". ISHMPU Dibër vendosi të gjobiste kompaninë me 100 mijë lekë gjobë për dëmin e vlerësuar në mbi 100 milionë. Kompania e ankimoi gjobën në ISHMPU qendrore dhe kërkoi anulimin e saj. Palët përfunduan në gjykatë, pasi Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave vendosi të linte në fuqi gjobën.

Gjykata Administrative në Tiranë i dha të drejtë kompanisë në një vendim të marrë në dhjetor 2018. Në vendimin e arsyetuar thuhet se megjithëse kompania nuk kishte marrëveshje shfrytëzimi me bashkinë Bulqizë për parcelat pyjore, marrëveshja koncesionare ia lejonte asaj të shfrytëzonte edhe atë pjesë të pyllit për të realizuar koncesionin.

"Këto argumente nuk zhvleftësojnë të drejtën e subjektit për të vijuar me përmbushjen e kontratës koncesionare dhe lejen mjedisore, në planimetrinë e së cilës përfshihet edhe ngastrat ku subjekti ka kryer gërmime dhe ka përdorur fondin pyjor," thuhet në vendim.

Gjykata në fund pranoi pjesërisht padinë e kompanisë, duke rrëzuar gjobën modeste. Ajo po ashtu ngarkoi me shpenzime gjyqësore prej 273 mijë lekësh, gati tre herë më të larta se gjoba ISHMPU-në. Bashkia Bulqizë që ishte palë e tretë në këtë gjyq dhe ISHMPU i thanë BIRN se do të apelonin vendimin.

Pak ditë para se të shpallej ky vendim, Bashkia Bulqizë regjistroi një padi civile në gjykatën e Dibrës, në të cilën kërkon pagimin prej kompanisë të 34.5 milionë lekëve. Sipas bashkisë, kjo është vlera e kontratave të mëhershme që ishin lidhur me kompaninë dhe kamatëvonesat. Bekim Topi, jurist i bashkisë, i tha BIRN se kompania nuk kishte paguar asnjëherë që prej vitit

"Ne bëmë një digë të re që shërben për vaditje. Banorët e fushës së Valikardhës vadisin me ujin e HEC-it," tha Teodori. Ai pretendoi gjithashtu se HEC-i nuk cënonte Liqenin e Zi si monument natyre, pasi ujin e merrte nga një digë e ndërtuar në vitin 1983, që kishte shërbyer për vaditje.

2012, kur ishin nënshkruar kontratat me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Bulqizë, që administronte në atë kohë pyllin.

Drejtori ekzekutiv i Teodori 2003, Komini i tha BIRN se pas bashkisë qëndronin interesa të të tjerëve dhe se do të përballeshin me të në gjyq.

BORXHET NDAJ TË TRETËVE

Përveç Bashkisë dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, kompania koncesionare në Bulqizë akuzohet edhe nga nënkontraktorët e saj. Ilir Balla, administrator i AR=BA 06 shpk i tha BIRN se mospagimi i detyrimeve prej Teodori 2003 e kishte vënë në vështirësi serioze kompaninë e tij, ndërsa ai vetë ishte në borxhe ndaj të tretëve, përfshi punëtorët.

Edhe administratori i kompanisë Euraldi shpk, Baudin Rama tha se kompania nuk paguante dot detyrimet ndaj të tretëve.

"Punimet që kemi kryer, i kemi të gjitha me libreza masash e supervizionesh të firmosura nga supervizori. Mospagesa na ka vënë në vështirësi të mëdha, pasi jemi detyruar të hyjmë borxh", tha Rama. Ai thotë se ka paguar punëtorët duke marrë borxh në banka, por nuk mund të paguajë borxhet e tjera të mbledhura për shkak të problemeve.

Drejtori ekzekutiv i kompanisë Teodori 2003, Erion Komino pranoi për BIRN detyrimet ndaj të tretëve, por e konsideroi këtë një situatë normale. Ai tha se detyrimet e kompanisë do të shlyheshin pas supervizimit, që do të përcaktonte edhe koston e punimeve.

"Me dy kompani ne kemi një çështje që ka lidhje me saktësinë e volumeve të punëve të kryera. Janë aktivizuar të gjithë ato mekanizmat që lejon kontrata supervizioni, kontrollet e mundshme dhe në momentin që do bihet dakord me sasinë e volumeve, ata kontraktorë ose do paguhen ose nuk do të paguhen në varësi të sasisë që del," tha Komino.

Persona të tjerë i thanë BIRN se kishin punuar pa kontratë për kompaninë dhe kishin hapur tunele e kanale uji dhe ishin të papaguar. Komino mohoi të kishte raste të tilla. Ai tha se kompania nuk mbante përgjegjësi për borxhet apo mospagimin prej nënkontraktorëve të personave që kishin punuar për ta.

Shkrimi është marrë nga **reporter.al**.
Botohet sipas versionit origjinal

vëzhgim

Bashkitë e Dibrës nën "pushtetin" e qenve endacakë

Nga **SAMI CURRI**

Bashkitë e qarkut të Dibrës nuk kanë asnjë plan për trajtimin e qenve endacakë. Këta të fundit kanë "pushtuar" rrugët e qyteteve dhe janë kthyer në një rrezik për banorët. Përpos Bashkisë së Matit që ka pak ditë që ka nisur nga puna për procesin e sterilizimit të qenve endacakë, Bashkia e Dibrës, Bulqizës dhe Klosit e kanë këtë plan vetëm në letër dhe dita që mund të vihet në zbatim duket shumë e largët.

BASHKIA MAT

Ramadan Hasa, 72 vjeç, del shëtitje çdo ditë në parkun e qytetit. Ku përpos të moshuarve të tjerë që qëndrojnë aty dhe luajnë domino, shoqëri iu bëjnë edhe qentë e shumtë endacakë, që enden nëpër qytet. Ramadani dhe shokët kanë histori të shumta, si nga jeta, por edhe me qentë endacakë, që janë bërë shoqëruesit e përditshëm: "Një shokun tonë desh e grinë para ca muajsh. Doli dhe në internet e televizion se e kishin kapur ato kamerat e një biznesi në rrugë, se si i ishin vërsulur qentë dhe për pak desh e kishin kafshuar", tregon për Portën Vendore Ramadani.

Ai shprehet se i ka ruajtur Zoti deri më sot, që nuk kanë rënë pre e sulmeve të qenve, sidomos kur këta të fundit janë në periudhën e shumimit apo janë të uritur. "Rrinë kope – kope, sa në park e sa përpara bashkisë në shesh. Ka periudha kur janë shumë agresivë dhe të sulmojnë. Por po të kapin këta të bëjnë copash. Po shyqyr thuaj se deri më sot nuk u ka shkuar në mendje të na fusin ndonjë të kafshuar", shton me ironi Ramadani, banor i qytetit të Matit.

Ashtu si Ramadani, edhe Avni Bukaçi e kalon kohën e lirë në parkun e qytetit. Ky i fundit shprehet se qentë janë rrezik për fëmijët e vegjël, të cilët kalojnë kohën e lirë në park: "Më problem këtu është për fëmijët dhe gratë që janë me karrocat e fëmijëve. Po të shkosh te 'Varrezat e Dëshmorëve' është edhe me keq puna, sepse atje hidhen edhe mbeturinat e qytetit dhe e kanë si burim ushqimi. Si natën dhe ditën atje rrëmojnë.", shprehet për Porta Vendore Avni Bukaçi.

Për këtë shqetësim të banorëve, Porta Vendore pyeti pranë Bashkisë Mat, e cila në përgjigje të kërkesës për informacion deklaroi që ka zhvilluar procedurat e prokurimit me objekt: Trajtimi i qenve endacakë, pikërisht për t'i dhënë fund këtij shqetësimi. Këto procedura u finalizuan në fillim të muajit tetor 2018, ku u shpall fituesi dhe u lidh kontrata me një vlerë tenderuese prej 367,000 lekë pa tvsh. "Në bazë të kapacitetit dhe mundësisë financiare të kësaj bashkie, me këtë fond janë planifikuar të trajtohen 80 qen endacakë", deklaroi Bashkia Mat, por pa dhënë më shumë informacion nëse një shifër e tillë për sterilizimin dhe kastrimin e qenve endacakë, plotëson nevojat e kësaj bashkie.

Bashkia Mat ka zhvilluar edhe më parë praktika të tilla sterilizuese për qentë endacakë, por që nuk i kanë dhënë zgjidhje këtij problemi, duke ndjekur një praktikë që për çdo qen që kapej nga banorët për t'u dërguar në qendrën e specializuar të qenve, të bëhej një pagesë si shpërblim monetar prej 3 mijë lekësh të reja, por e cila nuk rezultoi e suksesshme si ide. Por një praktikë e tillë rezultoi e dështuar, pasi problemi për trajtimin e qenve endacakë nuk mori zgjidhje. Kjo sepse trajtimi i qenve endacakë me anë të sterilizimit dhe kastrimit, kërkon një ndjekje të vazhdueshme, një regjistër dhe vendosjen e një çipi identifikues për qentë.

Ndërsa aktualisht sterilizimi i qenve në Mat po bëhet duke përdorur disa kazerma për grumbullimin e qenve, jo në kushte shumë të mira për një proces të tillë. Edhe më parë, OJF të ndryshme që merren me kafshët i kishin kërkuar Bashkisë Mat që të ndalonte sterilizimin, pasi nuk plotësonte kushtet për një proces të tillë.

BASHKIA KLOS

Ndërkohë në Bashkinë Klos janë identifikuar 75 qen endacakë, që kërkojnë trajtimin për sterilizim, por nuk ka ndonjë afat për kryerjen e këtij procesi. "Duke u nisur nga shembujt e mëparshëm të Bashkisë Klos ku procesi i sterilizimit të qenve endacakë ka dështuar,pasi është bllokuar nga OJF-të sepse nuk plotësonin kushtet për një proces të tillë, bashkia e ka shtyrë për një fazë të dytë implementimin e një procesi të tillë", shkruan në përgjigjen me shkrim Bashkia Klos. Kjo e fundit nuk jep asnjë sqarim se kur pritet të ndodhë një proces i tillë apo të ketë ndonjë marrëveshje me bashkitë e tjera të qarkut Dibër për të bërë sterilizimin e qenve endacakë.

BASHKIA BULQIZË

Situata është shqetësuese edhe në Bashkinë Bulqizë. Kimete Gjura, banore në

(Vijon në faqen 6)



Qentë endacak në Bashkinë Klos. Foto: Sami Curri

Bashkitë e Dibrës nën "pushtetin" e qenve endacakë

(Vijon nga faqja 5)

Bulqizë dhe tregtare e rrobave të përdorura i duhet që çdo ditë nga mëngjesi në darkë të mbajë të hapur dyqanin. Por përpos blerësve, përpara dyqanit të saj pushojnë edhe ngrohen në ato pak rreze dielli të dimrit të ftohtë në Bulqizë edhe qentë e shumtë, të cilët enden nëpër Bulqizë."Nga Lagja e Re e deri këtu te rruga e pazarit ke dhjetëra qen që enden rrugës. Këta të vërsulen dhe për të kaluar ndonjëherë duhet të kesh gurë e hunj në dorë se ndryshe të turren, sidomos kur janë në periudhë shumimi dhe apo kur kërkojnë ushqim", shprehet e shqetësuar Kimetja.

Në rrugët e Bulqizës, ka momente që më shumë rrugëve enden qentë endacakë se sa njerëzit, që janë kthyer në një rrezik për qytetarët, të cilët në shumë raste do të duhet të dalin edhe në orët e vona të natës për të shkuar në punë. Qentë në shumë raste janë kthyer në një postbllok në rrugët e qytetit të Bulqizës dhe rrëmojnë në kazanët e mbetjeve.

Deri më sot, Bashkia Bulqizë nuk ka marrë asnjë masë në këtë drejtim. Bashkia Bulqizë, në përgjigje të një kërkesë për informacion të Porta Vendore pranon faktin se nuk ka asnjë plan veprimi për këtë çështje dhe se nuk asnjë projekt se çfarë mund të bëjë në të ardhmen.

BASHKIA DIBËR

Në pedonalen e Peshkopisë, mbushur me qytetarë të shumtë që lëvizin lart e poshtë, mes tyre enden edhe qentë endacakë, që hapësirën para ish-godinës së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Peshkopi, e kanë kthyer një hapësirë pushimi. Por qentë endacakë i gjen të shumtë edhe pranë spitalit rajonal të Dibrës, kthyer në një kërcënim të dyfishtë, përpos problemeve shëndetësore që kanë qytetarët që i drejtohen këtij spitali. Në spitalin Obstetrik–Gjinekologjik, vetëm pak metra larg nga godina qendrore e spitalit, stafi mjekësor tregon për Porta Vendore se ka pasur shumë raste, kur personeli nuk dilte dot nga godina për të shkuar te poliklinika apo banka e gjakut, sepse në hyrje të spitalit gjendeshin me dhjetëra qen.

Muharrem Xhiveshi, banor i Peshkopisë tregon për Portën Vendore se qentë endacakë janë shumë shqetësues dhe se natën kanë frikë të dalin rrugëve sepse mund të të dalin para një grup qensh dhe të të kafshojnë. "Ata kanë një të keqe sepse një të lehë dhe pastaj të vërsulen të gjithë. Unë jam plak, kur i shoh që janë këtej rrotull nuk dal fare nga rrethimi i shtëpisë sepse nuk kam takat që në rast se më vërsulen t'u iki, se po më kapën më bëjnë copash. Ne jemi të vjetër, trupi jonë është i këputur edhe një të kafshuar nga qentë duam edhe atëherë nuk ka ku vete më keq. Kjo gjë duhet të marrë zgjidhje, sepse këta sa vjen edhe shumohen më shumë", shprehet për Porta Vendore Xhiveshi.

Bashkia Dibër, në përgjigje të një kërkesë për informacion të Porta Vendore na vendos në dispozicion programin e punës, por nuk jep informacion se kur do të nisë zbatimi i tij, kjo pasi janë në pritje të fondeve të posaçme për zbatimin e atij programi, por gjithashtu edhe në marrjen e eksperiencës pranë bashkive të tjera që e kanë nisur një proces të tillë.

ÇFARË THOTË LIGJI

Ligji ka parashikuar qartë sesi duhet vepruar me qentë, qofshin me pronar, qofshin pa pronar. Në ligjin nr. 10 465, datë 29. 09.2011 për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, përsa i përket funksioneve të njësive të qeverisjes vendore, bashkitë detyrohen që të marrin masa për të mbajtur nën kontroll dhe të zbatojnë legjislacionin për eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës.



Qentë endacak në Bashkinë Bulqizë. Foto: Sami Curri

Por në bashkitë e qarkut të Dibrës zbatimi i tij është shumë larg, sepse qentë endacakë janë rrugëve, dhe qentë që mbahen nëpër shtëpi janë të pa matrikuluar, ku nëse braktisen nga pronari, kthehen në një kontingjent për shumim.

Erko Prifti, mjek veteriner në spitalin veterinar "Vet Hospital Tirana" shprehet për Porta Vendore se në rastin e bashkive të qarkut të Dibrës, që nuk janë të mëdha dhe nuk kanë një numër shumë të madh qensh, për një periudhë një ose dy muaj i jepet zgjidhje këtij problemi vetëm me sterilizime, çka do të sjellë që qentë endacakë të mos shumohen më. Sipas Priftit, procesi i sterilizimit nuk ka një kosto shumë të lartë, që për një bashki që ka stafin e saj, kostoja është minimale dhe se një proces i tillë duhet të shoqërohet me një regjistër të plotë nga njësitë e qeverisjes vendore, të atyre të cilët kanë në shtëpitë e tyre qen."Kjo duke i regjistruar të gjithë qentë që mbahen në shtëpia me anë të një mikroçipi që vendoset nën lëkurë. Ku në rast se ai humbet herën e parë, identifikohet dhe i dërgohet të zotit. Por në rast se qeni kapet sërish i lirë, ai duhet të kalojë në procedurat sterilizuese dhe i zoti që e ka braktisur duhet të dënohet për një veprim të tillë sepse kjo bëhet shkak për një shumim të qenve endacakë, sidomos atyre që mbajnë qen femra", shprehet Prifti.

RREZIQET NGA QENTË

Mjeku veteriner Erko Prifti shprehet se qeni nuk ka asnjë lloj rreziku për qytetarët, përveçse në periudha të caktuara ku ata bëhen agresivë për shkak të sezonit të shumimit ose kur janë me këlyshë dhe mbrojnë territorin. Këto janë periudhat kur qentë janë rrezik për agresivitet ndaj qytetarëve. "Qentë marrin sëmundje invektive dhe rrallë transmetojnë sëmundje. Në Dibër me aq sa kam unë informacion problem është sëmundja e tërbimit. Ku një qen mund të kafshohet nga një ujk apo dhelpër që ka pasur sëmundjen e tërbimit, dhe ky i fundit kafshon një qytetar, në këtë rast e transmeton sëmundjen e tërbimit. Kemi edhe sëmundjen e leishmanozës. Qeni e merr këtë sëmundje nga mushkonjat, siç mund ta marrë një fëmijë apo një i moshuar." deklaron Prifti për Porta Vendore.

QENTË ENDACAKË, BURIM PËR SËMUNDJE INFEKTIVE

Mjeku Infeksionist Prof. Ass. Pëllumb Pipero, shprehet për Porta Vendore se trajtimi i qenve endacakë është problem thuajse në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, duke u kthyer në burim për shumë sëmundje infektive: "Veçanërisht për leishmaniozën Viscerale, për të cilën ne jemi ende vend endemik. Sëmundja transmetohet nga mushkonjat, që edhe këto i kemi me bollëk, dhe është shumë e rrezikshme për njeriun, madje vdekjeprurëse mbi 95% të rasteve nëse nuk mjekohet në kohë".

Për mjekun Pipero, përveçse burim i sëmundjeve infektive, duke qenë shumë agresivë dhe shpesh në tufa, qentë endacakë janë një rrezik edhe për qytetarët që mund të bien pre e kafshimeve. "Kafshimet e qenve nga ana tjetër mundësojnë transmetimin e virusit të ternimit apo bacilin e Tetanozit. Në të dyja rastet, kosto e trajtimit në institucionet shëndetësore nuk është e vogël", shprehet Pipero për Porta Vendore.

Qentë e pa vaksinuar shumohen çdo ditë edhe më shumë dhe enden të lirë. Bashkitë Dibër, Bulqizë dhe Klos kanë projekte në letër, larg zbatimit. Ndërsa banorët e këtyre bashkive janë çdo ditë nën trysninë dhe rrezikun për të rënë pre e sulmeve prej qenve endacakë.

*Shkrimi është marrë nga **portavendore.al**.*
Botohet sipas versionit origjinal



Qentë endacak në Bashkinë Peshkopi.
Foto: Sami Curri



Nga **OSMAN XHILI**

Periudha e pas viteve nëntëdhjetë e gjeti Veip Salkurtin nga fshati i Rashnapojës, pranë qytetit të Peshkopisë, plot me dëshira dhe energji. A do të dinte ai ti shfrytëzonte ata në mënyrën më efikase në dobi të vetes, familjes dhe shoqërisë. Kjo pyetje i rrinte vazhdimisht në kokë dhe kur dyzohej ndonjëherë se cilën gjë duhej të bënte, nga dy ose tre mundësi që kishte, i lutej Zotit, që e besonte aq shumë, për ta ndihmuar.

Veipi kishte fituar zanatin e këpucarit në fillim. Nuk ndenji gjatë në këtë stacion, jo se nuk i pëlqente, por ishte shumë statik si profesion, si një zog në kafaz. Ai kishte forcën dhe energjinë e shqiponjës dhe i duheshin hapësira për të lëvizur. Për pak vite të tjera provoi tregtinë, duke u endur mes Tiranës dhe Stambollit, duke vënë ca para mënjanë. Ishin vite të hershme dhe mund të kishte blerë një truall, apo një shtëpi në Tiranë, si shumë të tjerë. Një forcë e brendshme e tërhiqte drejt vendlindjes, drejt Dibrës dhe ai u kthye për të investuar atje, në fshatin e tij. Ju përvesh bujqësisë, në fillim me tre katër lopë, me misër, grurë e farë jonxhe.

Në vitin 1996 vjen në Dibër shoqata ADAD, me qendër në Francë dhe sjell farë patatje elitë, për fermerët e Kalasë së Dodës. Veipi bashkohet me idenë e tyre për kooperim dhe zhvillim intensiv të bujqësisë. Vetëm kështu mund të zhvillohej e të ecte përpara bujqësia dibrane. Në vitin 2000, bashkë me një grup fermerësh të tjerë, shkon në Savojë të Francës, për të fituar përvoja të reja. Habitet kur shikon se si e mbarështonin atje lopën Taranteze, në alpet me lartësi 3500 metra, në kufi me Italinë dhe Zvicrën. U mrekullua nga fuqia, rezistenca, vlerat dhe cilësitë e larta, që kishte kjo rracë dhe pa u menduar më tej, vendosi të marrë njëzetë krerë të tilla, ti sjellë në Shqipëri dhe të ngrejë një fermë blektorale.

Një vit më vonë, në vitin 2001, vjen në Shqipëri një grup pune nga Franca, për të parë se si po shkonte projekti i patates me Kalanë e Dodës. Hafuz Domi, koordinator i projektit u tregon për Veipin dhe sipërmarrjen e tij. Grupi prej 17 vetash shpreh dëshirën për ti bërë një vizitë fermerit të pasionuar, që po ngjiste shkallët e para të suksesit. Gati po binte mbrëmja dhe shtëpia bujare e Veipit nuk mund ti linte miqtë e largët me një kafe të vetme, ndaj i ndal për darkë dhe pse qenë aq shumë veta. Ishte një nga ditët e muajit të bekuar të Ramazanit. Miqtë vizituan fermën, u mrekulluan nga puna e Veipit, por u mrekulluan dhe nga bujaria e tij dhe e familjes.

- A dëshiron të ngrejmë pemtarinë në Dibër, mbi bazën e modeleve bashkëkohore? - e pyeti francezi, Zhan Sharli, drejtuesi i

profil

Puna, vizioni, këmbëngulja dhe ndershmëria, janë armët për të arritur suksesin dhe jemi të bindur se Veip Salkurti i posedon këto cilësi.

Veip Salkurti, “shqiponja” që po kërkon lartësi të reja

Në vitin 2005 ferma e Veip Salkurtit regjistronte 25 dynymë të mbjellë me mollë, kurse katër vite të tjera më vonë, kjo sipërfaqe kishte shkuar në 73 dynymë.

Në vitin 2015 linja e lëngut të mollës ishte gati. Ndonëse ka kaluar vetëm pak kohë nga fillimi i punës, shumë sasi molle janë përpunuar aty, ku vetëm këtë vit kanë qenë rreth 200 ton.



grupit. - A je i gatshëm për bashkëpunim?

- Patjetër që po, - përgjigjet Veipi, i sigurtë në vetvete, për atë që po thoshte. Vetëm Zotit i takon dhe i ka hije vetmia, ne njerëzve na ka dërguar në tokë për të bashkëpunuar me njëri tjetrin.

Fill pas kësaj bisede, një projekt tresh, mes qeverisë franceze, asaj shqiptare dhe Madës, hyri në zbatim. Për disa fermerë të përzgjedhur u sollën fidanë falas nga Franca, për të mbjellë nga dy dynym pemëtore, si fillim. Përveç Veipit, përfituan Medin Kryemadhi, Fehmi Zebi dhe disa fermerë të tjerë. Ishin përzgjedhur qershi, tre varitete të mollës Gala, si dhe një pjesë të llojit Pazhan 2.

- Tre vite më vonë, grupi francez i punës, vjen sërish në Dibër për të parë se si po ecte projekti i ri me pemtarinë, Veipi nuk i kishte zbatuar porositë e lëna nga specialistët francezë, por i kishte tejkaluar ata. Ata i kishin thënë ti bënte gropat me përmasa 50 centimetra, ai i kishte bërë me fadromë, me gjerësi 1, 5 metra dhe thellësi një metër, normalisht, pa kursyer plehun organik, që e kishte me shumicë. Rezultatet ishin impresionuese. Francezët u befasuan nga ajo që po shikonin dhe thanë se nuk janë fidanët tanë, aq e madhe ishte rritja e tyre. Kur u bindën plotësisht, i thanë Veipit, se vërtet qenke një njeri shumë punëtor. Ata e këshilluan të reduktonte blektorinë dhe të investohej në frutikulturë dhe Veipi ua dëgjoi fjalën ekspertëve francezë.

HEKTARË TË TJERË ME MOLLË

Veip Salkurti, vendosi të investojë në pemtari dhe kryesisht në kulturën e mollës. Në vitin 2002, si pjesë e një grupi fermerësh, viziton sërish Francën. Këtë rradhë shkuan në rajonin e Azhenit, ku kultivohej molla. Veipi u mrekullua dhe nuk po u besonte syve. Mijëra hektarë të mbjellë me mollë, si në një pikturë mjeshtërore. Ishin vërtet fruta të pjekur, apo një truk dhe punim prej plastike? Veipi afrohet ti prekë dhe ngul gishtin



në tulin gjithë lëng, për ta besuar plotësisht. Sytë ju mbushën me lot, kur e krahasonte pamjen e këtushme me realitetin shqiptar, ku shiteshin fidanë të paCertifikuar, kur e merrje për dardhë e dilte ftua, kur e mbillje për qershi e dilte vishnje. A thua mund ta konkurronim ne shqiptarët një perandori të tillë të prodhimit të mollës, atë të Bolzanos në Itali dhe të tjera si këto? Duhej “vrarë” mendja dhe duhej të përvisheshin mëngët. Shumë e shumë vizita bëri Veipi pas kësaj radhe, në Francë, por dhe në shtete të tjera. Ai kurrë nuk shkoi për të ngrënë, apo për të fituar ca dieta në shkëmbim. Ai donte të fitojë njohuri, eksperienca të reja, “të vidhte teknika e teknologji”, për ti sjellë në Shqipëri, për ti aplikuar në fermën e tij dhe të kolegëve dibranë.

Në vitin 2005 ferma e tij regjistronte 25 dynymë të mbjellë me mollë, kurse katër vite të tjera më vonë, kjo sipërfaqe kishte shkuar në 73 dynymë. Të gjitha ishin me mbështetje dhe në distanca 4 x 3 metra. Gjashtë dynymë ishin mbjellë me qershi, kryesisht të llojit Burlat.

Sërish e sërish Veipi dëshiron ti zgjerojë kufijtë e fermës së tij. Ndoshta synon ta plotësojë atë me dhjetë hektarë të mbjellë me pemëtore. Vetëm brenda një viti ai po shton gati një hektar të mbjellë me Arronia, me manaferra dhe lajthi italiane të tipit “Tondo Romano”.

PANAIRE TE SHUMTË, NJOHJE TË REJA

Franca ka qenë vetëm një nga stacionet e shumtë në rrugëtimin e gjatë të Veip Salkurtit. Dy herë ka qenë në panaire që janë zhvilluar në Berlin të Gjermanisë. Tre herë të tjera ka qenë në Bolzano të Italisë, në kufi me Austrinë. Dora e njeriut e ka hijeshuar atë vend, që nuk ka asgjë më tepër nga klima dhe kushtet e vendit tonë. Investime strategjike, një mekanikë supermoderne, vaditje tërësisht me pika dhe rrjeta antibreshër. Fare

Dyqanet e Big Market, të Sparit dhe shumë kompani të tjera prestigjoze kanë hapur dyert për këto produkte shumë cilësore. Këtë vit synohet që lëngjet e prodhuara prej tij të shtrihen drejt jugut të Shqipërisë dhe plazheve të këtij rajoni.

Nga një produkt, siç qe në fillim lëngu i mollës, tani janë shtuar dhe disa të tjerë. Uthulla e mollës është një prej tyre, që po pëlqehet shumë nga konsumatori për vlerat e saj të shumta, pse jo dhe kurative. Lëng molle i kombinuar me ftua, me boronicë, me qershi, me manaferra, apo lëng dardhe në vete, janë produktet e reja që “Kop.Frut.Dibër” ka hedhur në treg për konsumatorët.

mirë mund ta kthejmë Dibrën në një Bolzano të dytë, thotë Veipi. Para dy vitesh erdhi në Dibër një kompani italiane për mollën, që operonte në Bolzano. Donin të bënin një plantacion prej 30 hektarësh në Moranicë të Maqëllarës. Analizat e tokës që kishin bërë në Itali kishin pasuar me rezultate fantastike. Nuk e dimë çfarë e pengoi projektin, por sigurisht, paaftësia jonë për ti thithur investimet e huaja.

Vitin e kaluar Veip Salkurti shkoi në Londër të Anglisë, ku paraqiti lëngun e mollës dibrane, të prodhuar prej tij. Lëngu i



mollës së tij është dërguar dhe në Ëashington, apo në Hong Kong, duke kapërcyer tashmë dhe kontinente të reja. Të tjera panaire pret të vizitojë Veipi ynë i palodhur. Pas atij të Novi Sadit, në Serbi, në muajin mars, të këtij viti, është i ftuar në Stamboll nga dhoma tregtare e Turqisë, ku do të ekspozojë gjashtë produkte, me siglën e tij: “Koop.Frut.Dibër”.

“KOOP. FRUT.DIBËR” - REALIZIME DHE PERSPEKTIVA

Në një nga vizitat e shumta, që pati bërë në Francë, para viteve 2006, Veip Salkurti takon një të moshuar 83 vjeçar, që prodhonte një lëng molle të shkëlqyer dhe që i ruante për gjatë kohë vlerat organo leptike të produktit fillestar. I gjithë sekreti ishte temperatura në të cilën bëhej pasterizimi, në mënyrë që të ruheshin vlerat e lëngut, që përmendëm më sipër. Kur pa këmbënguljen e Veipit, i moshuari u dorëzua dhe i dha kodin sekret. Veipi bleu në Francë një pasterizator, një mulli bloje dhe një presë për të shtypur mollën e coptuar. Të gjitha këto i montoi në një dhomë te shtëpia e tij dhe për disa vite prodhoi një lëng molle me cilësi e vlera shumë të mira, mjaft i pëlqyer nga njerëzit.

Në vitin 2007, tregon Veipi, ishim në një veprimtari në Hotel Tirana, ku promovohej bujqësia shqiptare dhe skemat e subvencionit të atij viti. Mes shumë të ftuarish ishte dhe ambasadori francez i asaj kohe. Gjatë koktejit të organizuar, ambasadori provoi lëngun e mollës, që kishte sjellë Veipi dhe i pëlqeu mjaft. I premtoi se do ta vizitonte fermën e tij dhe do të shihte nga afër punën dhe përpjekjet e tij, por dhe të fermerëve të tjerë të Dibrës.

Punishtja e vogël e shtëpisë, po i ngjizte në mendje idenë për një projekt të madh. Të hapte një linjë për përpunimin e lëngut të mollës, ku të përfitonte jo vetëm ai, por dhe shumë fermerë të tjerë të Dibrës, që do ta sillnin aty prodhimet e tyre. Ai aplikoi në skemat e “Ipard like”. Kishte shumë punë, shumë lodhje, shumë procedura, për të plotësuar dokumentacionin, por në fund u shpall fitues. Linja u vendos në një objekt, jo larg qytetit të Peshkopisë. Përveç linjës së instaluar, aty ndodhen dhe katër dhoma frigoriferike, me një kapacitet mbajtës prej 500 ton mollësh.

Në vitin 2015 linja ishte gati, por ajo u vendos në punë një vit më vonë, në vitin 2016. Ndonëse ka kaluar vetëm pak kohë nga fillimi i punës, shumë sasi molle janë përpunuar aty, ku vetëm këtë vit kanë qenë rreth 200 ton. Sa ton mollë do të ishin kalbur, po të mos kishte qenë linja, duke u zgjatur jetën me 18 muaj, falë përpunimit!

Nga një produkt, siç qe në fillim lëngu i mollës, tani janë shtuar dhe disa të tjerë. Uthulla e mollës është një prej tyre, që po pëlqehet shumë nga konsumatori për vlerat e saj të shumta, pse jo dhe kurative. Lëng molle i kombinuar me ftua, me boronicë, me qershi, me manaferra, apo lëng dardhe në vete, janë produktet e reja që “Kop.Frut. Dibër” ka hedhur në treg për konsumatorët. Dyqanet e Big Market, të Sparit dhe shumë kompani të tjera prestigjoze kanë hapur dyert për këto produkte shumë cilësore. Këtë vit synohet që lëngjet e prodhuara prej tij të shtrihen drejt jugut të Shqipërisë dhe plazheve të këtij rajoni.

Veipi e di që gjërat e mira e të bukura nuk bëhen kollaj, ai e di se konkurrenca është e fortë, por ka besim se do t’ja dalë mbanë me ndihmën e Zotit. Puna, vizioni, këmbëngulja dhe ndershmëria, janë armët për të arritur suksesin dhe jemi të bindur se Veip Salkurti i posedon këto cilësi.

Rruga e Arbërit nr. 154

shënime

Me rastin e përvjetorit
të hapjes së minierës së Bulqizës

Bulqiza ndërtoi vendin, por vendi e harroi atë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Një historian i huaj shkroi se "Po të digjej Stambolli Dibra e ngre nga themelet, por po të digjet Dibra Stambolli kthen kokën pas ..."

Kështu ka ndodhë edhe me Bulqizën, masivin më të madh krommbajtës që bashkë me Batrën (një trung kromi) i jepte Shqipërisë një milionë tonë krom në vit, por Shqipëria nuk i dha asnjë kacidhe që jeta atje, jetë mbi flori, tu jepte banorëve të saj zhvillimin më të begatë në vend.

Një fotografi nga arkivi im me njerëz që me ta e kam jetuar Bulqizën në nëntokën e saj të begatë dhe në malet ku kërkohej krom, më ktheu shtatëdhjetë vjet të shkuara, atëherë kur një ditë shkurti të vitit 1948 mori rrugë miniera e kromit dhe u ngrit me baraka druri mbi truall të gurtë ai që do të njihej në botë si qyteti i Bulqizës...

Kërkova dhe midis blloqeve që "aksidentalisht" më kanë shoqëruar në mërgim, gjeta disa faqe shënimesh për Bulqizën në kurbën e rritjes vit pas viti, asaj kohe kur kromi i saj përcillej për tu kthyer në flori, valutë që ndërtoi Shqipërinë, por nuk ndërtoi kurrë Bulqizën...

Hapa e përcolla fletë pas flete një libër të Ymer Ketës, shkrimtar e publicist, studiues e historian, "Heronjtë e nëntokës", një enciklopedi ku lëvrijnë galerive të minierës e sondave të kërkimit të kromit heronj të mëdhenj të një kohe që nuk është larg në vite, porlënë larg në kujtesë...

XhavitHatibi dhe Todo Manço, njeri drejtues minierash e ndërmarrjesh nafte të mëdha e tjetri inxhinier i talentuar i minierës së Bulqizës, Hero i Punës Socialiste, shpirti binjak i kromit, në krye të tridhjetë minatorëve të ardhur nga Rubiku e Dibra, ndezën më 18 shkurt 1948 fitilat e parë, e mali i Duriçit u zgjua për të mos bërë gjumë kurrë, ditë e natë.

E poeti popullor këndoi ndër dhjetëravjeçarë mbi telat e çiftelisë...

Guri i kromit, gurë me xixa,
Vrapoi bota tek Bulqiza.
Guri i kromit, gurë i Zi,
Gjithë bota na ka Zili,
Gur e shkrepa
Të Zi me xixa,
Mbretëresha jonë,
Është Bulqiza...

Po, Bulqiza me të vërtetë do të bëhej Mbretëreshë, pioniere e madhe e nxjerrjes së kromit, nënë që do të hapte krahët e do të shtrihej në vite drejt Batrës, Krastës, Theknës, Selishtës, Cerujës, Tërnovës...

Atë vit të parë nga galeritë që u hapën



Bulqiza i dha vendit, eksportit shqiptar, floririn e 10.432 tonëve krom për tu ngjitur gradualisht në 40 mijë tonë në vitin 1950, në 122 mijë në vitin 1955, në 220 mijë tonë në vitin 1960, në 420 mijë tonë në vitin 1985... *(Nga blloku i shënimeve)*

E gjithë kjo vlerë e krijuar me mend, djersë e gjak shërbeu për tharjen e kënetave nga Buna në Bistricë për të përfituar dhjetëra mijëra hektarë tokë që u bënë hambar i Shqipërisë, për ndërtimin e veprave të mëdha hidroenergjetike, të bonifikimit e ujitjes, uzinave e fabrikave në të katër anët e Shqipërisë. Nuk ka vepër e pëllëmbë të tokës shqiptare pa floririn e nxjerrë me sakrificat ekstreme të minatorëve të kromit...

Në vitin 1955 në Bulqizë erdhi për të drejtuar minierën inxhinieri i talentuar Todo Manço, njeriu që shkriu jetën për kromin e markës shqiptare, e në respekt për të miniera mori emrin, "Miniera e Kromit Todo Manço"-Bulqizë.

Vitet '60-'70-të ishin vitet e zhvillimit intensiv në thellësi e gjerësi të Bulqizës e të masivit krommbajtës, pjesë e një trungu. Zona D, Pusi 2, Batra, Krasta, Thekna, Tërnova, Shkallë-Cëruja, Selishta... bashkë do ta ngjisnin nxjerrjen e mineralit të kromit nga 289 mijë tonë në vitin 1960, në një milionë tonë në vitin 1980 e në një milionë e dyqind mijë tonë në vitin 1989. (vjetari statistikor 1991).

Bashkë do ta radhitnin Shqipërinë në vendin e tretë në botë për nxjerrjen e mineralit dhe në vendin e parë për frymë të popullsisë...

Gjeologët e Bulqizës, pas ikjes së rusëve, u bënë zëri i së ardhmes së Bulqizës, kërkimi dhe zbulimi i kromit drejt thellësive dhe gjerësive. Miniera e re e Batrës do të merrte emrin e "11 heronjve" të gjeologjisë që humbën jetën në kërkim të kromit. Dy herë Çmimi i Shkallës së Parë të Republikës (Sefedin Qorlaze) do të festohej midis gjeologëve të Bulqizës për zërin e veçantë që dha gjeologjia jonë për të ardhmen e kërkimit dhe shfrytëzimit të kromit.

Bulqiza në vitet tetëdhjetë do të shtrihej në punime të mëdha kapitale. Dy traverbankët e Klosit dhe Rampa e Qafës së Buallit nisën udhën drejt Nivelit të Pestë, i pari me sistem transporti elektrik, kurse i dyti me zbritje e ngjitje me kamionë. Në dalje të traverbankëve u ngrit fabrika e pasurimit të kromit ndërsa, poshtë, në Klos mori formë stacioni i fundit i trenit dhe hekurudha po shtrinte shinat e saj. Në të njëjtën kohë nga Bulqiza, drejt Selishtës një traverbank tjetër ndërtohej për të marrë kromin e Balgjajt dhe të Selishtës...

Në Burrel u ngrit uzina për shkrirjen e kromit...

A duhej gjithë ky investim në kushtet kur ekonomia e vendit ishte e sëmurë?

Mbase po...

Mbase jo...

Një debat që duhet ta bluajnë imët në mullirin e gjykimit specialistët.

Nuk u gjykua atëherë, mbase nga "uji në gojë" hedhur nga regjimi i kohës.

Nuk u gjykua as kur "goja u hap një pashë" e specialistët, ata që e kishin ngritë me duar e me dhëmbë minierën mbetën në këndin që formon rruga që bashkon Bulqizën e Vjetër dhe të Renë me rrugën paralel me Pallatin e Kulturës. E kam në sy e në shpirt pamjen dhe gjendjen shpirtërore të Jorgo Kolës, inxhinierit gjeolog të minierës së Bulqizës, njeriun që i njihte thellësitë e kromit më mirë se kushdo, njeriun që i dha jetë (dhe i jep edhe sot me testamentin profesional që ka lënë) nxjerrjes së mineralit të kromit. Diçka në biografi do ta shuante meritën e tij të ishte Hero i kohës. Në pleqërinë e tij Jorgo Kolën, nga mëngjesi në mbrëmje, në ditë me diell e me acar, do ta gjeje në atë kënd rruge, me shpinë kthyer nga miniera tek shiste paqeta cigaresh, çamçakëzë...për të përballuar vitet e pleqërisë.

Bulqiza në vitet tetëdhjetë do të shtrihej në punime të mëdha kapitale. Dy traverbankët e Klosit dhe Rampa e Qafës së Buallit nisën udhën drejt Nivelit të Pestë, i pari me sistem transporti elektrik, kurse i dyti me zbritje e ngjitje me kamionë. Në dalje të traverbankëve u ngrit fabrika e pasurimit të kromit ndërsa, poshtë, në Klos mori formë stacioni i fundit i trenit dhe hekurudha po shtrinte shinat e saj.

Këtë portret do të kishte edhe miniera, edhe nxjerrja e kromit, edhe qyteti i Bulqizës, që ndonëse me themele në flori ishte dhe është qytet gjallë - vdek.

Kur u ndamë minatori i kromit mbeti me duar në xhepa të grisur. Bulqizaku as tokë kishte për të punuar, as punë kishte për të nxjerrë bukën e ditës, as përkrahje për ta mbajte jetën gjallë...

Minatori që dilte në pension me 10 vjet punë nëntokë, në moshën 50 vjeç, me pensionin më të madh për kohën, përjetoi tragjedinë e njerëzve të harruar, ashtu siç përjetoi edhe qyteti tashmë në duar ujqish të pangopur.

Dua të shkruaj shumë për minatorët dhe gjeologët e Bulqizës, këta heronj të mëdhenj të kombit...

Shënimet e mija në këtë përvjetor të rrugës shqiptare të kromit do të desha që të vijonin me kujtime e vlerësime të asaj dhe kësaj kohe, nga njerëz emrat e të cilëve i kam në mendje dhe u ulem në gjunjë me respekt për vlerat e mëdha që dhanë.

Nuk e di se çfarë do të ketë më 18 shkurt në Bulqizë...

Festë (?) apo protestë (?) !

Mbase më 18 shkurt Kuvendarët e Shqipërisë do të ngrenë dorën lart njëzëri për të miratuar "Statusin e Minatorit".

Ua kanë borxh, një borxh që ndjek borxhin e s'paguhet dot kurrë...

Shënim: Nga arkivi im prej qindra fotosh me gjeologë e minatorë të kromit po shkëpus katër fotografi, njëra midis minatorëve të Pusit 2, njëra fiksuar në 40 vjetorin e minierës me veteranët e saj, njëra në një meditim të gëzueshëm të njerëzve të kromit dhe njëra në gëzimin e gjeologëve kur sonda takon në krom...



Bë j një abonim
online ose në print...

**Në vlerësim të heronjve të nëntokës,
në përvjetorin e Minierës së Kromit Bulqizë.**

Gjakhumburit e jetëharruarit në kërkim të floririt...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Gjakhumbur e jetëharruar, mbledhur në një libër që tash pesë vjet askush, nga ata "kushët" lart, nuk e ka marrë në dorë, pa le ta shfletojë, të lexojë jetët e të kërkojë gjakun pikuar e rrjedhë honeve të errëta të nëntokës. Mbase ky libër duhet të ishte (dhe të jetë) në tryezën e atyre që "shkruajnë e shuajnë germa e fjalë" në tepër të përfolurin "projekt-ligj" në këto vite... "Statusin e minatorit"!

Ymer Keta, minator, shkrimtar, publicist NJERI me germa kapitale, duke iu drejtuar gjashtë vjet të shkuara, në 65 vjetorin e Minierës së Kromit të Bulqizës, lexuesve (mirë do të ishte t'i drejtohej Kuvendit) shënon:... ***"Në ato ditë të vështira, kur pushka me gjalmë kërciste në male për çlirimin e vatanit e gjaku i derdhur mbushte lumenj, nuk pati më shumë viktima se sa në Minierat e Kromit Bulqizë e Batër, apo edhe në ato të bakrit e të qymyrit, pas çlirimit, lubi e pangopur në jetë njerëzish varrosën minatorë në galeritë e nëntokës, por edhe në sektorë të mbitokës jo pak djem nënash nga zonat e Dibrës, të Matit, të Mirditës dhe nga e gjithë Shqipëria".***

Gazetar e publicisti Sali Ymeri, njohës i minierës së Bulqizës si punonjës i "Avari shpëtimit" duke pyetur se si lindën këto kujtime shkruan... ***"E marr me mend se ç'ka përjetuar ky ish minator, sot shkrimtar, në moshën më të bukur, kur ka punuar në galeritë e minierës në vitet 1969-1975, në ato mëngjese, pasdite apo turne nate në ato galeri të frikshme. Autori kujton ato shokë, miq e të afërm, me të cilët përshëndetej në fillim të turnit: "dalshim shëndoshë"!...."***

Dalshim shëndoshë!

Një fjali që edhe legjendat dridhen e ngrijnë qelizash rrëfimore.

Dalshim shëndoshë!...



Edhe në luftë, në ato beteja që e kanë shkatërruar shoqërinë njerëzore, kjo fjali nuk është shkruar e dëgjuar të dilte nga kordat zanore njerëzore. Këto 434 faqe libri, me qindra fotografi e skica, afro 500 portrete e emra heronjsh të nëntokës, nuk mund t'i shkruante askush, nuk mund t'i dokumentonte njeri i gjallë pa një shpirt të madh, pa sy që shpërthejnë liqenin e lotëve brazdave të pleqërisë, nuk mund t'i dokumentonte askush që nuk e ka përjetuar në shpirt fjalinë "dalshim shëndoshë" sa Ymer Keta. Nuk do t'i bënte vetëm, por me miq e me shokë jetuar honesh të errëta të nëntokës së Bulqizës, Batrës, Shkallës, Cërujës, Selishtës, Tërnovës, Rubikut, Kurbneshit...

E lotët përsëri do të mbushnin fjalët e tregimeve, si në një krua që rrjedh me shkumë... Shfletoj librin dhe në sy më vijnë heronj të nëntokës, nga ata që i dhanë jetë e zhvillim dhe nga ata që dhanë gjak të pastër rinor...

Njerëz të lirë që dhanë jetën galerive të kromit...

Njerëz të burgosur që dolën në "liri" në një mënyrë që askujt mos i ndodhtë...

Ymer Keta i ka bërë bashkë me të njëjtin respekt dhe përkushtim...

Dhe vijnë e radhiten një nga një... Xhavit Hatibi dhe Todo Maço që një ditë të ftohtë të 18 shkurtit 1948, në krye të 30 minatorëve nga Mirdita, Mati e Dibra, ndezën fitilat dhe bënë që Mali i Duriçit të jehojë... Ferit Alla, Bujar Pata, Kamber Duriçi, Kujtim Gjoka, Bukurosh Koçi... e të tjerë që i vunë shpatullat ndërtimit të minierës së Bulqizës, fabrikës së pasurimit të kromit e ndërtimeve të mëdha kapitale që çuan në deri NJË milionë e dyqind mijë tonë krom në vit për eksportet shqiptare, flori që ndërtoi Shqipërinë, por nuk arriti kurrë të ndërtojë Bulqizën, Batrën, Krastën, Klosin, Burrelin... Ymeri, në 434 faqe të "Heronjve të nëntokës", siç i quan ai, hap një faqe që duhet lexuar germë për germë.

Nga të gjithë, por në veçanti nga ata që kanë në dorë dhe në mendje t'i venë ata në piedestalin e lavdisë dhe ta venë veten në hulli të mirësisë...

Pa vështrimin mbi këtë "germë", të vënët përjetësisht nën tokë dhe pasardhësit e tyre në dy breza...

Pa barazinë e tyre njëlloj me ata që u persekutuan nga diktatura...

Pa një vlerësim në "Nenin 1" të Statusit të Minatorit si heronj që dhanë e nuk morën asgjë...

Demokracia për të cilën pushtetarët e lartë të të dy krahëve dhe pjella e tyre Kuvendi nuk do të jetë kurrë demokraci, kurrë barazi në të drejtën themelore të njeriut. Ministri i financave doli disa ditë më parë dhe deklaroi njohjen e vjetërsisë së të burgosurve për efekt pensioni (nuk e specifikoi në ordinerë e politikë) "dy vjet për një vit" ?! Faqeve të gazetave, "lajm të parë" e "listë në vijim" jepen çdo ditë miliarda lekë dëmshpërblime për nipër e stërnipër të të persekutuarve të regjimit të kaluar a thua se edhe ata kanë qenë në punë të detyruar galerive të kromit e bakrit apo të internuar fushave të Myzeqesë. Kjo, deri në atë masë të shkronjës sa njeriu i thjeshtë ka filluar të thotë hapur "Deri kur do të paguaj unë për to?". Dhe për "kë do të paguaj?" sepse në listat publike marrin dëmshpërblim edhe ata që kanë vrarë, kanë vjedhë, përdhunuar e shkelur ligjet e kohës. Dhe ndonëse tash një çerek shekulli kërkohen të hapen "dosjet e sigurimit", asnjëherë nuk është kërkuar të hapen "dosjet e gjyqit", dosje që me siguri atë që qëlloi policin në kokë për ti marrë jetën nuk do ta cilësonte kush hero e martir të demokracisë...

Nuk e di pse sot, 18 shkurt 2018, mora heronjtë e nëntokës, mallin dhe brengën që lanë pas, vendin e tyre në një kohë pa vend, udhëtova në shkronjë të Ymerit thellësive të nëntokës e majave të maleve, aty ku nxirret flori e atje ku kërkohet flori, atje ku jepet jetë e atje ku humbet jetë... Nuk e di pse brodha me këto shpirtra që flasin fshatrave të Dibrës me lot në sy në shkronjë të Ymer Ketës që qanë për të gjithë por kthehet e qanë edhe për vete, për pesë njerëzit e gjakut të tij: Ademin, Bujarin, Mehmetin, Izetin dhe Limanin... që i ka përcjellë me lot e dhimbje në botën pa botë. Nuk e di pse u ndala më shumë Grykës së Madhe e Grykës së Vogël, Fushë Bulqizës e Vajkalit që kanë derdhë mbi gurit e kromit aq gjak sa nuk ka derdhë asnjë fshat i Shqipërisë këto vite lufte pa armë e pa armik...

Nuk e di pse e fiksova shikimin në rrëfenjën për Isuf Sulën që la pas shtatë fëmijë. Pyeta veten ku janë dhe si u rritën ashtu siç pyeta veten për më të riun e nëntorit 2017, Liman Ketën, që iku duke lënë një vocërrak 3 vjeç e një nuse të re në dilemën "Të rrosh apo të mos rrosh"! I thashë vetes se ai fëmijë, ajo nënë e re duhet të ketë status të plotë me të paktën të barabartë me fëmijën e familjen e një polici rënë në krye të detyrës.

Me pension e hapësirë për studime përballuar nga shoqëria...

Pse jo? Kryeministri të bëhet "Plak i Vitit të Ri" me "thesin e dhuratave" në krah grykave të galerive...

I thashë vetes se boll kemi ngrit grumbuj floriri e derdhë lot mbi bare varresh të harruar e të freskët...

Qeveria, e harruara qeveri, të hartojë sa më shpejt ligjin për "Statusin e Minatorit", dhe Kuvendi ta dekretojë: "Hynë në fuqi menjëherë".

Dhe Presidenti ta dekretojë pa pritur ditën e fundit të "kompetencave të tij... Kështu mbase ua lehtësojnë paksa barrën e jetës atyre që u dogjën në shpirt për ata që ikën e nuk do të kthehen kurrë.

Shënuar një vit më parë, më 18 shkurt 2018, 70 vjet nga dita kur nisi "beteja e nëndheshme" në zemër të Malit të Duriçit, Bulqizë...Përditësuar sot me një dhimbje për viktimën më të re, Allaman Allushin. Qoftë i fundit!

Kushton vetëm
600 lekë në vit...
Email: rrugaearberit@gmail.com

Njerëz të lirë që dhanë jetën galerive të kromit...
Njerëz të burgosur që dolën në "liri" në një mënyrë që askujt mos i ndodhtë...
Njerëz që kur hynin galerive uronin: "Dalshim shëndoshë"...

Nuk e di pse sot, 18 shkurt 2018, mora heronjtë e nëntokës, mallin dhe brengën që lanë pas, vendin e tyre në një kohë pa vend, udhëtova në shkronjë të Ymerit thellësive të nëntokës e majave të maleve, aty ku nxirret flori e atje ku kërkohet flori, atje ku jepet jetë e atje ku humbet jetë...

Rruga e Arbërit nr. 154
kujtime

70 hektarë vresht,
blloku më i madh në Dibër...

Kur pikonte rakia “NB-Dibra”



Ndërmarrja bujqësore e Dibrës po shkonte drejt pesëqind mijë pemë frutore në blloqe: kumbulla, dardha, mollë, kajsi, qershi, vishnje...mbetjet e të cilave shndërroheshin në raki.

Atë ditë, më 16 shkurt 1966, në një ceremoni të bukur mora publikisht diplomën e agronomit...

Fola përpara pedagogëve dhe studentëve...

Thashë se adresa jonë tash e tutje është “Mali dhe fusha, atje ku mbillet dhe korret”...

Më 1 mars 1966 më dhanë adresën e punës:

Ndërmarrja Bujqësore Dibër, përgjegjës sektori në Sektorin e Qendrës...

Ishte kohë mbjelljesh...

Mbjellje pemësh frutore...

Qenoku po merrte formën e plotë me kumbulla, arra, gështenja...

Pesëdhjetë e tre mijë rrënjë në një pamje mbresëlënëse...

Ravnat ku së bashku me Xhavit Hysën, (njeri në njërën anë të telit me gunga kallaji e tjetri në anën tjetër) në mars të vitit 1960 shënjonim vendet ku do të hapeshin gropat e mbilleshin fidanët e hardhive ardhur aso kohe nga Bullgaria...

70 hektarë vresht, blloku më i madh në Dibër...

Midis rreshtave të vreshtit, mars 1966, përsëri me Xhavit Hysën, tash agronom sektori, një risi e re, fidanë qershish e vishnjesh. Një bllok që do të pushtonte të 70 hektarët me mendimin shkencor që kur të plakesh hardhia të lulëzojë e jap fryte vishnja e qershia...

Dhe kështu ndodhi...

Vite më vonë blloku tashmë i qershive dhe vishnjeve i Ravnave ishte më i madhi, më i bukuri dhe më prodhimtari...

E mbani mend?

Qershi më të mira nuk i gjeje kund...

Për tu ngjitur më vonë Kodrave të Kabeve e Kuplonit të Begjunecit...

Kohë punësh të mëdha...

Mbjelljesh, krasitjesh, spërkatjesh...

I kujtoj me mall e dashuri, me respekt për ata njerëz që duke punuar u bënë mjeshtër në një profesion të ri, shkollë e shkollarë në pemëtari...

Atë pranverë kodrat mbi Kallavere u punuan qilizmë për tu mbjellë me patate, aksion kombëtar i bimës së arave që në tekstet universitare fillonte me fjalinë: “Patatja është bukë dhe gjellë”...

E njihja vendin ndër të tjera sepse verës, kur isha nxënës e student isha pjesë në “skuadrën e shartimit” me mjeshtër Sadik Papulin, Dilaver Kabën...

Mijëra filiza “të mi” që kanë dalë nga sythet puthitur në “T-në” e nënshartesës, tash lulëzonin e jepnin fruta diku blloqeve frutore me mollë, dardhë, qershi, kumbulla...

Çelën lulet e degëve të pemëve,u varën kokrrat...

“Llogoret”, kodra që sheh Peshkopinë prej ku kam fiksuar sa e sa fotografi të qytetit, ishte blloku më i madh i kumbullave të ndërmarrjes bujqësore asokohe.

Sapo kishte hyrë në prodhim të plotë.

“Roza Gjigande” sa një grusht fëmije motak ishte ngjyer me ngjyrën e vet që i jepte emrin...

Duhej velur...

Tregu i Peshkopisë ishte i vogël, shumë i vogël për prodhimin që erdhi e atë që do të vinte.

Shefi i planit Hysni Gjoka lidhi një kontratë me Ndërmarrjen Tregtare Ushqimore në Tiranë. U hartua një grafik me ditë dhe data se kur do të vinte kamioni për të marrë kumbullat.

Në letra gjithçka bukur.

Në praktikë filluan vonesat me ditë.

Kumbullat në vapën e gushtit filluan të zbuten në atë masë sa dolën jashtë standardit.

Nisën të kalben...

Nuk dinim ku ti çonim....

Ndërmarrja ushqimore kthente kokën mënjanë...

Letrat në adresë të prokurorisë dhe degës së brendshme u shpeshtuan.

Erdhën edhe prokurorët...

Në një mbledhje urgjente në drejtorinë e ndërmarrjes bujqësore kërkova që frutat e dala jashtë standardit të futeshin në fuçi dhe të distiloheshin për raki.

U prita me këmbët e para nga drejtori.

I mirë ishte Xhetani, shpirt njeriu, por i druhej shumë rakisë. Nuk ulej kurrë në klube e kurrë nuk vinte përpara gotë rakie.

Ishte edhe mentaliteti ende me rrënjë fetare që e mbante alkoolin larg sofrës dibrane.

Mos harrojmë se në ato vite nuk shtrohej raki në asnjë dasmë.

Vonë pas afro njëzet vjetësh u pranua të shtrohej raki në një odë për kuadrot e kooperativës...

Mbledhja u prish...

Prisheshin edhe kumbullat...

Unë nga përvoja e praktikave në prodhim si student në ndërmarrjet bujqësore të vendit kisha vënë re që mbetjet frutore i fermentonin dhe distilonin.Ngula përsëri këmbë. I thashë drejtorit që të shkojë në Kamzë apo në ndonjë ndërmarrje tjetër bujqësore dhe të mësojë nga përvoja e tyre.

Me vështirësi më në fund u bind.

Na dha leje, por me kusht që mos i afrohemi kazanit.

Në mes të sektorit ishte një ndërtesë e vjetër. Në njërën dhomë banoja unë dhe në tjetrën punonte kovaçi.

Kovaçhanën e transferuam. Gjetëm disa fuçi dyqind kilëshe dhe i mbushëm me kumbulla që pikonin lëng nga të çarat e arkave...

Na duhej një teknik që t’ia dinte punës në fermentim e zierje.

Erdhi një njeri i mirë, teknik shumë i zoti, Nefail Kryemadhi nga Greva...

Një kazan i vogël, sa ata familjarët, ishte distilatori i parë i rakisë.

Ndodhi çudia, ajo që se imagjinonim dhe nuk e prisnim. Rakia, veçanërisht ajo e zier dy herë, 22 gradë, shkoi e gjitha për eksport...

Verës tjetër e lirova dhomën, punishtja u zgjerua. Fuçiat u zëvendësuar me parafabrikate betoni e distilimi nisi në impiante të mëdhenj.

Dhe jo vetëm në sektorin e Qendrës por në të gjithë sektorët: në Zdojan, Kastriot, Sllovë, Zall Sinë...

Ndërmarrja bujqësore e Dibrës po shkonte drejt pesëqind mijë pemë frutore në blloqe: kumbulla, dardha, mollë, kajsi, qershi, vishnje...mbetjet e të cilave shndërroheshin në raki.

Dhe rakia e NBSH Dibra u bë më e preferuar se e Ushqimores në tryezën familjare të Dibrës...

Dhe jo vetë atje...

Edhe për eksport ishte më e kërkuara...

“Na sillni një shishe raki NB Dibra” vinin thirrjet familjare në telefon...

* * *

E solla në kujtesë se mbase ngjit diku.

Jo në individë, sepse ata ia dinë mirë zanatit.

Në adresë të shtetit, atij ligjor dhe atij ekzekutiv.

Bujqësia pa industri prapa, pa fabrika e komplekse përpunimi të prodhimeve bujqësore, në “krye të arës”, nuk ka të ardhme.

Është një bujqësi e “kalbur” në rrënjët të fidanit të mbjellë...

ABDURAHIM ASHIKU
Agronom

16 shkurt 2019



Diploma e agronomit, 16 shkurt 1966



Plantacione rrushi.

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri, Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

- ***S'ka me krue dhamin:*** *S'ka as për të kruajtur dhëmbin*. Thuhet për dikë që është shumë i varfër, që nuk ka asgjë.
- ***Berr':*** *Barrë kripe*. Thuhet për një njeri që është shumë i bezdisshëm, të ngjitet pas.
- ***U ba kamë e dër':*** *U bë këmbë e dorë*: u fejua apo u martua.
- ***Un' e kërcun':*** *Urë e kërcu*. Ndajf. Rrinte i mërzitur.
- ***Kraje palare:*** *Krye palare. Doli kraje-palare*, me kryet sa një palare (*lloj tabakaje prej druri, me një bisht, për të shërbyer drekën a darkën për një person, pa shtruar sofër*) - *doli i humbur, i trullosur, budalla*.
- ***Xhek e sapun:*** *Gjak e sapun*. Përdoret për të treguar një situatë shumë të trishtueshme. *S'ke parë gjak e sapun - nuk ke parë luftë, njerëz të vrarë*.
- ***Muer er':*** *Mori erë* - u zbulua gjithçka.
- ***S'gre kraje:*** *S'ngre krye. Nuk sheh ditë të mira, s'ke për t'ia parë hajrin*.
- ***T'jet' n'pupla:*** *Të ngelet në pupla*. Thuhet për dikë që është mjaft i ngjitur e i rrëmbyer.
- ***Ku lef çen e del tajm:*** *Ku leh qen e del tym. Që gjendet kudo*.
- ***Si peni, g'zofi:*** *Si peri gëzofi. Që janë njëlloj, si qeni - i zoti, si njëri-tjetri*.
- ***M'ka cof' kau n'maj:*** *Më ka ngordhë kau në maj*. Thuhet për dikë që detyrohet të marrë ndonjë vendim jashtë kohe. *Kur të cof kau në maj kërkon e ble çdolloj kau tjetër*. Kur dikujt i vdes gruaja dhe ai kërkon një tjetër thuhet: *M'ka cofë kau n'maj*.
- ***A ba*** për ***maj'll n'kraje:*** Është bërë për miell në krye. Thuhet për dikë që vjen rrallë herë, që s'e ke parë prej kohësh. Në të folmen etnografike me miell në kokë përfytyrohet *lugati*. *Eshtë* bërë si lugat.
- ***Pajëll mushka:*** *Pjell mushka*. Thuhen aq shumë fjalë, sa të bëjnë të mendosh e të pranosh se pjell edhe mushka.
- ***Pulaçërras:*** *Pulaqorras*. Ecën si pulë qorre, që shkon apo ecën kuturu.

FJALË TË RRALLA

- ***apllag:*** Quhet pjesa e parme dhe e pasme e samarit, në të cilën mbështillen edhe litarët e barrës. Samari ka dy *opllangje*. Opllangu i parë shërben për të mbledhur litarët, ndërsa i dyti ka veshët ku kapen litarët për të mbajtur barrën. *Ia lshoi dorën opllag e m'opllag:* e ledhatoi kalin duke e prekur nga kreu në fund, në *opllang* dhe jo në trup.
- ***abresh / abrésh-i:*** Quhen kështu ata njerëz, kryesisht të rinj, që krijojnë gjithnjë probleme, që zihen me këdo, që janë trazovaçë. Çabej *abrash* quan *një njeri me flokë të verdhë në të bardhë, për kafshë që janë me lara*. Njeri *abresh*. Miku *abresh* në shtëpi është si druri garravesh në barrë.
- ***agërllajk / agërllájk-u:*** I ftohtë i madh, njësoj me *acar*. Kur vdiq, ka qenë një *agërllajk* i madh.
- ***alem-kalem:*** Kuptimisht i njëjtë me: *menduam dhe vendosëm*. Bëmë *alem-kalem* dhe u nisëm.
- ***amel:*** Me kuptimin *shpirt*. Nga fjala *amêl* vjen edhe emri *amêlkeq*. Ka *amêlin* e keq. *Amêlkeq e i patakatë*, thuhet për dikë që ka shpirt të keq, por që nuk ka mundësi të bëjë dëm. Nuk ka lidhe me *amêl* të Çabejt: *bar për të dalë jashtë*.
- ***alleshtajs:*** Nuk ka lidhje me çfarë shkruan Çabej për këtë fjalë: *mësoj një njeri në një gjendje a një punë*". Vjen nga turq. hallall, hallallshtisem, ia bëj hallall dikujt, i jap ose i marr bekimin dikujt, sidomos atij që po vdes, por dhe një njeriu me të cilin ndahesh: *U ndamë, u allshtajsëm*, *ia bëmë hallall njëri-tjetrit*, ia bekuam mundin.
- ***ap e morr:*** *Përpiqem, mundohem, bëj të pamundurën* për të kryer një punë. Përdoret në të gjitha vetat si një kompozitë foljore. Në qasjen që Çabej u bën fjalëve *ap* dhe *jap*, nuk përfshihen format që u përmendën më lart. Thuhet dhe për njeriun që po jep shpirt, por në mohore: *as jepte as merrte*.
- ***ajn:*** E njëjtë me foljen *fryj*. *Ajet, enjtet. I është ajun faqja*. Por dhe: *u ajna* me qershia. Ishte *ajnë* e ba lodër.

ANEKDOTA E MUAJIT

Zyberi u flet të vdekurve



Të parët e një katundi u grindën se cili do të bëhej kryeplak. Njëri kërceu e tha:

Më mirë të bëjmë kryeplak Zyberin, se kështu nuk i ngelet hatri asnjërit.

Zyberi ishte më i humburi i katundit. E thirrën dhe i thanë:

Zyber, prej sot je kryeplak.

Unë nuk mund të drejtoj shtëpinë time, jo më katundin me treqind shtëpi.

Po paria e katundit nxori vulën e ia dha, duke mos pranuar asnjë kundërshtim nga Zyberi. Ky nuk pati ç'të bënte, por një kusht ua vuri: të kishte të drejtën që çdo njeriu që vdiste, para se ta futnin në dhé, t'i çuçuriste në vesh nja një minutë.

Të vdekurve folu sa të duash, - i thanë ata dhe kjo punë mori fund.

Vazhdoi Zyberi të ishte kryeplak dhe t'u fliste te veshi atyre që shkonin në atë dynja. Kjo gjë u bënte përshtypje njerëzve, por Zyberi nuk u tregonte çfarë u thoshte. Paria e thirri prapë dhe ca me lutje, ca me dredhi, ia nxori Zyberit sekretin. Zyberi u tha:

- Ata që kanë shkue me kohë në botën tjetër, duan të dinë për këtë botën tonë. I porosis ata që vdesin t'u thonë se Zyberi është bërë kryeplak, të tjerat i marrin vesh vetë...

(Marrë nga libri "Tregime alegorike" i Xhafer Martinit, Botimet M&B, Tiranë, 2019)

TREGIMI ALEGORIK

Tre Hasanët

Nga **MUNIR SHEHU**



Për bujarinë dhe "bukën e Zajmit", në gojën e popullit kemi edhe nji ankdotë:

"Hasan beg Zajmi, shquhej në Dibër për mikpritjen e tij. Si e shembi në dajak Jashar Gazi Toçin, kajmekamin turk në Peshkopi, i doli nami në nëndë malet e Dibrës. Pikërisht për këtë gjë e kapi cmira Hasan beg Xhilagën. Një natë, ky ndodhej për darkë tek Hasan beg Karahasani. Krejt rastësisht, erdhi edhe Hasan beg Zajmi. U bënë tre Hasanë: Hasan beg Karahasani, Hasan beg Xhilaga e Hasan beg Zajmi. Mbasi iku Has beg Zajmi, Xhilaga i drejtohet Karahasanit:

- Or Hasan, unë jam oxhaku ma i vjetër në Dibër, Has Zajmi nuk asht' oxhak. As pasuri nuk ka sa kemi ne. Pse ta ketë namin ma të madh se timin?!

- Has Zajmi ka sofër, or Has beg. Has Zajmit ja ka qitë namin sofra!

Ia priti Hasan beg Xhilaga:

- Hasan Zajmi u qet miqve në sofër përshesh me dhallë, kurse ne....

- Po, por sofra e Hasan Zajmit asht' ma e madhe. Kur sofra asht' ma e madhe edhe namin e ka ma të madh.

- Unë do t'ia marr të gjithë miqtë Has beg Zajmit. Do të bëj që sofra e tij të mbetet bosh. Do t'ia thyej sofrën e bashkë me sofrën, do të thyej edhe namin e tij!

- Provoje! – i tha Has beg Karahasani.

Si u kthye në shtëpi, Has Xhilaga filloi menjëherë përgatitjet. Porositi në Lurë që t'i bëjnë shtatë sofra të mira dhe më të mëdha se ajo e Has beg Zajmit. Pastaj, pa pasur as dasëm, as ndonjë shyqyrllëk që njerëzit të gjenin ndonjë sebep për ta uruar, grishi në një gosti të madhe parinë e gjithë Dibrës, pa harruar asnjë. I erdhën gjithë bejlerët, agallarët, shehlerët, hoxhallarët, bajraktarët, paritë e fshatrave dhe çdo njeri që kishte sadopak nam e njihej si burrë i mirë. Kjo festë e padëgjuar, zgjati shtatë ditë e shtatë net. U therën 18 krerë qe, 40 berra. Drekë e darkë, sofrat u shtruan me çorbë, mish, pilaf e hallvë. Shtatë ditë e shtatë net, miqtë hëngrën, pinë, kërcyen, kënduan dhe mbetën shumë të kënaqur. Pastaj ikën të gëzuar, duke i uruar shëndet të zotit të konakut.

Hasan beg Xhilaga, priti që t'i dalë nami në Dibër, por prapë se prapë s'u ba gja. Nami i Has beg Zajmit, ma i madh. Pas nji viti, Hasan beg Xhilaga i thotë Hasan beg Karahasanit:

- Më shkuen gjithë ato shpenzime kot! Prapë njerëz më shumë shkojnë ke Hasan Zajmi. Prapë ai përmendet ma shumë se unë. Si e harruen njerëzit kaq shpejt gjithë atë ziafet të madh dhe nuk e përfillin fare oxhakun tim të vjetër? Lene këtë, po edhe më tallin e më shajnë. Disa thonë hëngrëm e u ngopëm, kërcyem e kënduem, por nuk e morëm vesh përse; disa thonë, jo po natën e parë mishi ishte i pa zier, jo po natën e dytë pilafi pa gjalpë, jo po natën e tretë hallva e papjekun...!

- Or zotnoj, ti ja kalon Has beg Zajmit me pasuni, po jo me bujari! Has beg Zajmi nuk na thërret, po na shkojmë vetë, shkojmë me bisedue me të për gjithfarë punësh se kemi nevojë për këshillën e tij. Shumë herë Has Zajmi qet në sofër veç bukë e krypë e dhallë, sepse atje, populli shkon orë e pa orë. Or Hasan, nuk asht e madhe sofra e drunit, po sofra e bujarit ne e mentarit. Ti na thirre, na gostite, hangrëm e u kënaqëm, të faleminderit...!

(Marrë nga libri "Shtek më shtek e skutë më skutë" i Munir Shehut, Botimet M&B, Tiranë, 2018)

Edlira, vajzë dibrane, që në fëmijëri e ka ndjerë dhe përjetuar ndjenjën e fortë të dashurisë që vetë prindërit i kanë ushqyer për vendlindjen.

Edlira Haxhiymeri

PEDAGOGIA

e përkushtuar për arsimin dhe shoqërinë



Këdo që takon dhe ka pak lidhje me Dibrën, (e pranon dhe vetë se është pak lokaliste), fillon ta shikojë pozitivisht dhe me ndjesi të veçantë.
Është përpjekur dhe vazhdon të përpiqet që këtë ndjenjë të bukur për Dibrën dhe dibranët ta përcjellë sadopak edhe tek djali i saj.

Nga **SHAQIR SKARRA**

Edhe pak ditë na ndajnë nga 7 Marsi, Dita e Mësuesit dhe nuk mund të kalojë pa shkruar për një prej emrave më të njohur, më të dashur dhe më të respektuar në fushën e mësimdhënies, prof. Edlira Haxhiymerin. Mbi tridhjetë vite në mësimdhënie si pedagoge, studiuese e sot pedagoge me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale nuk është pak. Për mua nuk është hera e parë që shkruaj për prof.Edlira Haxhiymeri. Para dhjetë vitesh kam bërë një intervistë me të, të cilën e botova në gazetën "Rruga e Arbërit" si dhe në librin"Trokitje në portat e Dibrës". Tani shoh se ky portret rri ngushtë brenda kësaj kornize. Them rri ngushtë, sepse shenja ma e madhe e suksesit për një mësues është kur ai guxon për t'i zgjeruar kufijtë e tij të dijes dhe të mësimdhënies, për të kontribuar ca më shumë sesa në hapësirën e një shkolle. Profesoreshë Edlira i ka kaluar me kohë tashmë këto kufij.

Në të gjitha udhëtimet që bënte jashtë vendit, profesoreshë Edlira kthehej që andej e ngarkuar plot me libra. Ajo flet, shkruan, diskuton, është unike dhe nuk do të mbajë asgjë për vete. Ajo është tepër e revoltuar nga ajo që ndien dhe shikon, prandaj dhe proteston.

Po kush është Edlira Haxhiymeri? Ka lindur në Tiranë nga dy prindër dibranë, Tahir dhe Nustrete Haxhiymeri. Tahiri, si një pasardhës i familjes së Iljaz Pashë Dibrës (Qokut) ishte dhe mbeti si pedagogu që bëri më shumë për ato studentë dibranë që u shkolluan në ato vite në Tiranë. Ndërsa nëna e saj, Nustretja, ishte bijë në fisin e njohur të Shehlerëve.

Edlira, si një cucë dibrane, që në fëmijëri e ka ndjerë dhe përjetuar ndjenjën e fortë të dashurisë që vetë prindërit i kanë ushqyer për vendlindjen. Përfytyrimi i saj për Dibrën është si qyteti më i bukur, më i pastër, më mikpritës dhe më me traditë se çdo qytet tjetër. Fati, puna, detyra e saj ia krijuan mundësitë që Edlira të vizitonte qytete vërtet të bukur dhe madhështorë të botës, si në lindje, ashtu edhe në perëndim, por kur kujton Dibrën, rruga e kthimit i bëhej edhe më e shkurtër se sa ajo që kishte vajtur. Ky lloj vlerësimi shkonte deri atje saqë nuk e mendonte që jetonte në kryeqytet, por kryeqendra e vendit për të duhej pa dyshim që të ishte vendlindja e prindërve të saj, Dibra.

Edlira është shkolluar në Tiranë. Studimet universitare i ka kryer për Gjuhë Angleze dhe është specializuar për Psikologji. Që nga viti 1987 është pedagoge në fushën e Psikologjisë. Ka mbrojtur gradën "Doktore e Shkencave" dhe ka fituar titullin "Profesore e Asocuar".

Sa më shumë inteligjent që të jesh, aq më shumë duhet të mësosh. Për Edlira Haxhiymerin, të arsimoheshe do të thoshte të ishe e aftë për ta kuptuar sa më mirë jetën, për të qenë e gatshme në përballjen me sfidat që ajo të afron, në rrugët që shpesh s'kanë vetëm lule por edhe gjemba.

Dhe jeta e saj mori një rrjedhë krejt ndryshe, - se siç shprehet vetë Edlira, - ishte një ëndërr e kahershme e prindërve të saj që të shkollohej e të bëhej mjeke. Me gjithë dëshirën e madhe që kishin prindërit, Edlira u rrit me ndjesinë e madhe për të qenë mësuese.

Sot, kur ka mbi tridhjetë vite në fushën e mësimdhënies, thotë me humor:

"Sidoqoftë, mjeke apo mësuese, i lidh bashkë të dyja profesionet puna me njerëzit. Arrita që në fund të kisha një profesion që i bashkon të dyja, ëndrrën e prindërve të mi dhe ëndrrën time. Kjo nuk ishte zgjedhja ime, por fati e deshi kështu. Jam e kënaqur dhe ndjehem krejtësisht e plotësuar në profesionin tim. Nuk jam ndjerë asnjëherë keq. I jam përkushtuar profesionit. Jam përpjekur të bëj më të mirën dhe ky profesion më ka shpërblyer".

Edlira kujton vitet e bukura të gjimnazit, shoqërinë, aktivitetet si dhe një dëshirë në rritje për të lexuar, në mënyrë të veçantë libra të ndaluar. Ka qenë kjo periudha që më ka mundësuar njohjen me të gjitha kryeveprat e letërsisë dhe që, për fatin tim të mirë, u thellua më tej me studimet universitare në gjuhën angleze.

E lindur dhe e rritur në Tiranë, në metropolin shqiptar, por e lidhur shumë ngushtë me Dibrën, me vendlindjen e prindërve të saj, me origjinën e bukur, për të cilën ajo ndjehet krenare. Fëmijëria e saj ka qenë e bukur dhe e qetë, e rritur dhe e mbushur me dashurinë dhe kujdesin e prindërve e sot nga fëmijëria e dikurshme ende kujton gjithë nostalgji vizitat e përvitshme që bënin në Dibër. Kalonte atje pjesën më të madhe të pushimeve verore. Kujdesi i gjysheve, njohjet dhe rrethi i gjerë i njerëzve që e rrethonin, vizitat tek llixhat, në Dri, por edhe në fshatrat përqark për të takuar miq e të afërm të të dy familjeve, i bënin pushimet verore të veçanta dhe i jepnin mundësinë të preknin nga afër realitetin për të cilin prindërit i flisnin vazhdimisht.

Në fakt, ndjen mall dhe është nostalgjike për Dibrën. Sa herë ka mundësi, shkon pa asnjë mëdyshje. Megjithëse të afërmit dhe familjarët e saj janë larguar prej kohësh nga Dibra dhe pak të njohur i kanë mbetur ende atje, ajo gjithmonë e shikon atë si një qytet shumë të afërt dhe domethënës në konstitucionin e saj personal. Ka shumë mall për rrugët, për bulevardin me blirë, për pazarin, llixhat dhe gjithçka që i kujton fëmijërinë, prindërit dhe gjyshërit e saj. Përpiqet të frekuentojë të gjitha aktivitetet dibrane, pasi është edhe kryetare e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe është e pranishme në të gjitha ndryshimet që pëson qyteti i Peshkopisë.

Këdo që takon dhe ka pak lidhje me Dibrën, (e pranon dhe vetë se është pak lokaliste), fillon ta shikojë pozitivisht dhe me ndjesi të veçantë. Është përpjekur dhe vazhdon të përpiqet vazhdimisht që këtë ndjenjë të bukur për Dibrën dhe dibranët ta përcjellë sadopak edhe tek djali i saj.

Një mësues i mirë i respekton nxënësit e tij. Në një klasë të një mësuesi të mirë, idetë dhe mendimet e secilit person vlerësohen. Nxënësit ndjehen të sigurt për të shprehur ndjenjat e tyre dhe mësojnë të respektojnë dhe të dëgjojnë të tjerët. Ky mësues krijon një mjedis mikpritës për të gjithë studentët. Sot, ish studentët e saj, që janë bërë vetë pedagogë, Edlirën e marrin si model.

Prej vitesh punon si aktiviste e shoqërisë civile për të drejtat e grave dhe fëmijëve. Është autore e shumë teksteve dhe studimeve mbi probleme sociale që shqetësojnë shoqërinë shqiptare. Ka drejtuar shërbime në komunitet për grupe sociale në nevojë dhe është hartuese e disa projekteve për shërbime sociale. Jep vazhdimisht kontribut në median e shkruar dhe atë elektronike për çështje të ndryshme sociale. Është njëkohësisht bashkëpunëtore pranë dy universiteteve të huaja, universitetit "Clemson" në shtetin e Karolinës së Jugut, në Amerikë dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Maqedoni. Më gëzon sinqerisht dhe më le pa mend energjia e madhe e prof. Edlirës.

Ka plot njerëz të zgjuar ky vend i bërë me kujdes nga Zoti, por si shpjegohet që qeveritë, radhë-radhë, bëjnë sikur nuk i shikojnë? Prof. Edlira Haxhiymeri nuk ka nevojë për qeveritë, por vetë qeveritë kanë nevojë për të. Ky personalitet i shkencave shqiptare është i pazëvendësueshëm. Ajo ka diçka nga të parët e saj. Shqipëria ka shumë zanafilla dhe njëra prej tyre është atje në Dibër, tek i madhi Skënderbe, tek Iljaz Pashë Qoku, paraardhës i vetë Edlirës, te Vehbi Dibra e plot të tjerë.

Profesoresha ka punuar si pedagoge vizitore në GVSU, Michigan, SHBA (1997-1998). Ajo është pedagoge në distancë në Universitetin "Clemson, SC", SHBA. Ka kontribuar për krijimin e Programit Bachelor në Punë dhe Politikë Sociale në UEJL Maqedoni dhe vazhdon të kontribuojë në zbatimin dhe fuqizimin e këtij programi.

Gjatë 15 viteve të fundit zonja Edlira Haxhiymeri ka mbajtur pozicione të rëndësishme në arsimin e lartë, si përgjegjëse e Departamentit të Punës Sociale, anëtare e Senatit të Universitetit, zv. Rektore e Universitetit të Tiranës dhe zv. Ministre e Arsimit në Shqipëri.

Ka marrë pjesë në mbi 100 konferenca shkencore në bashkëpunim me bashkëpunëtorë të huaj dhe vendas. Në pamje të parë profesoreshë Edlira Haxhiymeri dukej shumë e rëndë, por studentët, sapo e shikonin se po futej në oborrin e fakultetit, nuk fshiheshin pas pemëve e gjelbërimit, përkundrazi i afroheshin pranë, bisedonin shtruar dhe komunikonin lirshëm si me një mike të njohur prej vitesh.

Ekspertiza e profesore Edlira Haxhiymerit përfshin punën me grupet sociale, kryesisht viktima të pambrojtura të dhunës në familje dhe trafikimit; çështjet gjinore; praktikë e avancuar e punës me fëmijët dhe grupet e të rinjve; sjellja njerëzore dhe mjedisi social, trajnimi i profesionistëve që kontribuojnë për çështjet sociale; monitorimi dhe vlerësimi i shërbime sociale dhe kërkimi për çështje të ndryshme sociale.

Ajo ka një përvojë të pasur në aktivizimin e shoqërisë civile, kryesisht për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e grave. Është drejtore Ekzekutive e "Strehëzës për Gra dhe Vajza të Dhunuara në Tiranë".

Ajo është autore dhe bashkautore e disa teksteve universitare, e shumë artikujve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, drejtuese

cyan magenta yelloë black

profil

Edlira Haxhiymeri: “Po ta ilustronim gërshetimin midis tradicionales dhe modernes te shqiptari, do të thosha se tradicionalja na bën të ndjehemi shqiptarë, modernia na afrohen me Europën. E meqë ne duam të jemi shqiptarë në Europë, na duhen të dyja këto paradigma”.

I lumtur është ai njeri që gjatë jetës së tij bën më të mirën e mundshme dhe mbetet i nderuar e i kërkuar nga ata që e njohën. Edlira Haxhiymeri është një e tillë, intelektuale emërmirë dhe pa dyshim e përmasave kombëtare. Dhe për këtë nuk pret vlerësime e nderime nga qeveritë, nga institucionet. Vlerësimin ia kanë dhënë ata mijëra e mijëra studentë të saj që sot punojnë e drejtojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, brenda e jashtë vendit, dhe vlerësime të tilla nuk janë pak.



e projekteve kërkimore në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Ka botuar “Dhuna në familjen shqiptare”, “Sjellja njerëzore dhe mjedisi social”, “Rolet dhe steriotipet gjinore”, “Mitet dhe realitetet e dhunës në familje”, “Dhuna ndaj fëmijëve dhe pasojat në zhvillimin e tyre”.

Ajo ecën në këmbë dhe bën intervalin e përditshëm, shtëpi-fakultet, por edhe ndalon gjatë rrugës dhe i takon të gjithë miq, shokë, studentë e ish studentë të saj. Ndien kënaqësi dhe vlerësim kur e ndalojnë dhe e përshëndesin të gjithë. Prof.Edlira është gjithmonë vetvetja, nuk lëviz nga e saj. Çfarë mendon? Një Zot e di, përgjigjet një proverb gjerman. Ajo kurrë nuk mendon të vjedhë, siç bëjnë shumë elitarë ulur në bangot majtas apo djathtas.

I lumtur është ai njeri që gjatë jetës së tij bën më të mirën e mundshme dhe mbetet i nderuar e i kërkuar nga ata që e njohën. Edlira Haxhiymeri është një e tillë, intelektuale emërmirë dhe pa dyshim e përmasave kombëtare. Dhe për këtë nuk pret vlerësime e nderime nga qeveritë, nga institucionet. Vlerësimin ia kanë dhënë ata mijëra e mijëra studentë të saj që sot punojnë e drejtojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, brenda e jashtë vendit, dhe vlerësime të tilla nuk janë pak.

FAMILJA

Edlira është e martuar dhe ka një djalë. Bashkëshorti i saj është pedagog në fakultetin ku Edlira ishte vetë studente. U njohën që në vitin e parë të studimeve. Ka qenë një zgjedhje e tij, që e tërhoqi Edlirën pas. Si në ditët e para të njohjes, vazhdon të vlerësojë dashurinë pa kufi, sinqeritetin, guximin, drejtësinë, që në fakt është edhe refreni i jetës së tij. E siç thotë me shaka Edlira “ka një fije nervi prej tosku, që është i lexueshëm në karakterin e tij dhe që e bën të veçantë, të paktën për mua. Ai ka qenë dhe është një mbështetje dhe nxitje për arritjet e mia. Ndonjëherë vlerësoj se mbështetja e tij ka qenë domethënëse për mua. Ne debatojmë vazhdimisht. Asnjëri prej nesh nuk hap rrugë lehtë. Biem dakord me njëri-tjetrin, vetëm kur kemi argumente të mjaftueshme. Kjo e bën jetën tonë vërtet interesante dhe na ka ndihmuar të mësojmë shumë nga njëri-tjetri. Im shoq është rritur në një familje me shumë fëmijë dhe me një rreth të gjerë familjar. Babi i tij është ndarë herët nga jeta dhe atij i është dashur të kujdesej edhe për vëllezërit dhe motrat më të vogla. Kjo e ka pjekur para kohe, por edhe e ka ndihmuar ta njohë më mirë jetën. Në këtë pikëpamje, argumenti me të më ka ndihmuar të jem gjithmonë me këmbë në tokë. Përgjithësisht, nuk mbajmë inate me njëri-tjetrin. Debati mbaron, kur njëri prej nesh ka dhënë më shumë argumente. Pas kësaj fillon mirëkuptimi. Më besoni, debatojmë shumë kur vjen puna për të mbrojtur vlerat e krahinave nga vijmë. Këtu mua më duhet të jem më luftarake, pasi ndjej që Dibra nuk ka marrë asnjëherë atë që ka merituar dhe mua më pëlqen që im shoq, pas debateve të gjata, të pranojë që unë kam të drejtë. Në pozicion më të vështirë në këto raste më duket se është djali ynë, që nuk di nga t’ia mbajë dhe gjen zgjidhjen: të dy keni të drejtë”.

Profesoreshë Edlira përgjithësisht është tip i qetë, shumë e vëmendshme dhe e kujdesshme. I do dhe respekton njerëzit. Nuk lëndon askënd. I merr gjithmonë seriozisht punët dhe përgjegjësitë e ngarkuara dhe vlerëson çdo arritje. Ajo flet për të tjerët, për njerëzit me vlera që ka njohur në rrugën e jetës, flet për të gjithë, por kurrë për vete.

Edlira ka shumë dëshirë dhe vullnet të fortë për të bërë shumë gjëra. Edhe kur gabon, gjë që ndodh rrallë, gjen forcë për të vazhduar. Di të thotë më fal. Vlerëson njerëzit që bëjnë të njëjtën gjë. Nuk bindet lehtë. Është gjithmonë e papërtuar për të bërë më të mirën. Është mjaft tolerante. Pëlqen dhe vlerëson shumë sinqeritetin. Është mjaft këmbëngulëse në gjërat e mira. Shquhet për profesionalizëm, personalitet, thjeshtësi, bashkëpunim, korrektesë. Ka shumë cilësi të tjera dhe virtyte të larta që spikatin në portretin e prof.Edlirës, por një vend të rëndësishëm zë pa dyshim përkushtimi i madh i saj karshi profesionit, të cilit si pedagoge i ka kushtuar mbi tridhjetë vite.



Prof.Edlira Haxhiymeri me bashkëshortin, prof.Eqerem Yzeiri.

ANGAZHIMI NË POLITIKË

Angazhimi në politikë për prof.Edlirën erdhi krejt natyrshëm, së bashku me rritjen e saj profesionale. Avancimi në karrierën profesionale e bëri më të ndjeshme ndaj problemeve dhe realiteteve të vështira në shoqërinë tonë. Me dëshirën për të kontribuar në përmirësimin e realitetit social në shoqërinë shqiptare u afrua në politikë. Besonte dhe ende vazhdon të besojë se në fakt profesionistët e mirë janë dhe politikanë të mirë. Edlira e ka ndjerë si përgjegjësi, për të dhënë kontributin e saj në fushat që i njeh mirë.

Fillimisht ka qenë e angazhuar si eksperte e më pas si kandidate për deputete në një nga zonat e Tiranës, si zv.ministre e Arsimit, si prefekte e Tiranës dhe më pas si sekretare për Shoqërinë Civile dhe Shanset e Barabarta në Partinë Socialiste.

Pavarësisht nga problemet që krijohen nga politika, nuk është penduar asnjëherë për angazhimin e saj në politikë. Madje, pikërisht ky angazhim e ka bërë më të fortë dhe më këmbëngulëse, në mendimin se është përgjegjësi qytetare për të kontribuar sot në politikë.

Si grua, beson se i ka shërbyer dhe do të vazhdojë t’i shërbejë politikës, edhe për të zbutur maskilitetin ekstrem që e karakterizon politikën.

Prof. Edlira u njoh mirë me jetën, me uljet e ngritjet e saj, duke e filluar atë nga hiçi për të arritur më vonë shumë në formimin e tij, do t’i falnin “mëvetësinë” për të ndërmarrë më pas veprime që në fund të fundit do të ishin si një shtrëngatë për t’i dhënë vetë jetës drejtimin e duhur.

Je i virtytshëm kur ndërmarrjen e guximshme e bën vetiu e jo kur ta kërkojnë të tjerët. Në jetën me plot ngjarje të lakmueshme të Edlira Haxhiymerit, gjen njeriun e bindur për të kryer veprime të guximshme, pa e ditur se ajo ato i bën nën trysninë e ndërgjegjes së pastër dhe të njeriut idealist.

Prof.Edlira Haxhiymeri i bëri të gjitha punët me shpirt dhe zemër. Ajo u tregua kaq e aftë sa investoi që të ishte jo vetëm një sukses, por të mbetej edhe një vlerë, për vete dhe shoqërinë.

Janë vetë sfidat ata që e bëjnë jetën interesante e këto sfida nuk munguan as në jetën e Edlirës.

Ajo nuk është vetëm një ëndërrimtare për t’i kryer punët ashtu siç duhet. Ka edhe bindjen se brenda vetes fshihet forcë, durim dhe pasion për të gjetur fjalën me të gjithë, si me të rinjtë, ashtu edhe me të moshuarit, si me studentët, ashtu edhe me kolegët.

FAMILJA SHQIPTARE MES MODERNES DHE TRADICIONALES

Prof.Edlira Haxhiymeri kur shikon një realitet krejt ndryshe me atë që po ndodh me familjen shqiptare, ka një mesazh për të gjithë:

“Familja shqiptare ashtu sikurse e gjithë shoqëria jonë ka përjetuar një ndryshim të madh që lidhet me nevojën për t’ju përshtatur një mënyre të re të jetesës dhe të mbijetesës. Në këto kushte shumë norma dhe vlera të konsoliduara prej vitesh u rrëzuan, u lëkundën ose e humbën përkohësisht ndikimin e tyre në jetën e familjes. Ajo që dikur njihej dhe vlerësohej si vlerë u shndërrua në antivlerë. Normat u zhbënë. Njerëzit e kishin të vështirë t’ju përmbaheshin vlerave dhe normave të mëparshme. Në kushtet e një vakumi vlerash dhe normash, familja shqiptare përjetoi disa probleme. Emigracioni, ndarja e familjes, më pas divorci, kanë ushqyer xhelozinë, dhunën, krimin, krimin ndaj vetes, prostitucionin dhe trafikimin e detyruar të vajzave dhe fëmijëve etj.

Mungesa e informacionit për problemet e shfaqura; mungesa e politikave sociale në ndihmë të familjeve, nënave dhe individëve në nevojë; mungesa e një ekonomie të stabilizuar që krijon hapësira punësimi për shumë individë; ekzistenca e tregut të zi të punës; mungesa e shërbimeve sociale që i japin jetë politikave sociale në shërbim të shtresave në nevojë; politika tejet agresive mohuese dhe aspak pohuese e gjithë këtyre viteve; mungesa e një politike arsimore që bën prioritet edukimin qytetar të fëmijëve; tradita tejet patriarkale, jo tolerante dhe jofleksibël e shumë të faktorë të tjerë janë arsyet e kësaj situate të trazuar në familjen shqiptare.

Unë besoj se tradicionalja dhe modernia bashkëjetojnë në familjen dhe shoqërinë tonë. Ato mbartin aspekte pozitive si dhe aspekte delikate, që unë nuk do t’i quaja negative. Çështja është se si ne i përdorim dhe i shfrytëzojmë të dy këto paradigma të jetës sonë. Ajo që vërehet jo rrallë sot, është frika se mos etiketohemi si tradicionalë. Për këtë arsye rendim pas modernes, që nuk e njohim, nuk e kemi për edukatë dhe e bastardojmë atë. Në fakt, ne mund të përfitojnë si nga të qenit tradicionalë, ashtu edhe nga të qenit modernë. Problemi është sa dhe si të jemi tradicionalë dhe modernë. Ku dhe kur të jemi të tillë? Për fat të keq, nuk ka receta që të na mësojnë për sjelljet tona tradicionale dhe moderne. Njeriu duhet të bëjë atë që ndjen dhe di të bëjë, pa qenë ekstremistë dhe militantë të njërës apo tjetrës paradigmë.

Gjithsecili duhet të ndërtojë një balancë të tijën për të dy paradigmat. Mënyra se si ndërtohet balanca varet shumë nga edukimi, emancipimi dhe mençuria e gjithsecilit. Sa më të arsimuar të jemi, aq më të lehtë e kemi për të ndërtuar balanca të ekuilibruara që nuk ushqejnë ekstremizmi dhe absurditete, por nxisin dhe ushqejnë vlera të shëndetshme që sigurojnë jetesë harmonike.

Mesazhi im për adoleshentët dhe të rinjtë është i lidhur me arsimimin e tyre. Njerëzit e arsimuar i zgjidhin shumë më lehtë dhe pa kosto problemet e tyre. Sa më shumë shkollë e dije, aq më të fuqishëm bëhen ata në jetë. Njerëzit e arsimuar i vendosin lehtë ekuilibrat dhe kjo nuk ju merr kohë e energji pafund. Të paarsimuarit humbasin edhe gjithë jetën e tyre dhe nuk e gjejnë dot ekuilibrin e duhur. E përsëris, nuk ka recetë për përzgjedhjen midis tradicionales dhe modernes. Të dyja janë të rëndësishme. Ne nuk mund të bëjmë pa to. Tradicionalja përbën shtratin ku lind e rritet modernia. Modernia është tradicionalja e ditëve tona. Gjithsecili prej nesh jeton në një gërshetim të të dyjave. Masa e secilës prej tyre, tek individi përbën individualitetin e njeriut. Ne dallojmë nga njëri tjetri edhe sepse kemi pesha të ndryshme të tradicionales dhe modernes brenda vetes.

Po ta ilustronim gërshetimin midis tradicionales dhe modernes tek shqiptari do të thosha se tradicionalja na bën të ndjehemi shqiptar, modernia na afrohen me Europën. E meqë ne duam të jemi shqiptarë në Europë, na duhen të dyja këto paradigma”.

Rruga e Arbërit nr. 154

Dr. Qemal Çadri,
thjeshtë një mendje brilante.

portret

Dr. Qemal Çadri, *mjeku legjendë* **i Dibrës**

Nga Prof. As. **NAZMI KOÇI**

I ka kaluar të 70-tat dhe si rrjedhojë e një problemi të koklavitur shëndetësor duket rrallë udhëve të Tiranës e ambienteve shëndetësore të saj, që vite më parë i ndriçonte me sharmin dhe mençurinë e tij. Herë pas here takohemi e çmallemi, kryesisht në shtëpinë e tij në Rrugën "Sitki Ciço" në Tiranë, ku kalon kohën midis përkujdesjeve të bashkëshortes, mjekes së mirënjohur Avije Çadri, e dashurisë së fëmijëve dhe të afërmve që e vizitojnë shpesh e marrin nga ai nektarin e mençurisë, që i buron pashterrur nga truri i tij aq pjellor dhe goja e tij fort e ëmbël. E kam edhe unë hera-herë këtë shans, si një nga miqtë e tij të vegjëlisë, të rinisë e të gjithë jetës.

Me doktor Qemalin u njohëm në shtatorin e vitit 1960, në bankat e Politeknikumit Mjekësor të Tiranës, ku të dy kishim vajtur për të studiuar për Mjekësi. Ai atë vit fillonte vitin e tretë, ndërsa unë vitin e parë. Të dy ishim nga Dibra, nga një krahinë dhe të dy i kishim baballarët mësues, të cilët jo për rastësi ishin dhe ata miq të mirë. Nga Dibra në atë kohë ishin dhe dy nxënës më të rritur se ne, më vonë mjekët e mirënjohur të Dibrës, Xhavit Miftari dhe Shefqet Domi. Ishte dhe Kadri Puca dhe Nazif Koltraka, që studionte paralel me mua , por ishte më i rritur në moshë, pasi e kishte kryer shërbimin ushtarak, ndërsa unë isha vetëm 13 vjeç. Natyrshëm, u lidha shumë me Qemalin jo vetëm pse ishte nxënës i shkëlqyer, por dhe pak më i madh nga unë, nga ana ime dhe një shembull në çdo drejtim, ndaj mik më të mirë as kërkova dhe as mund të gjeja.

Pas shkollës së mesme ai u pranua menjëherë në Universitet në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë, ndërsa dy vjet më vonë, pas ca peripecive u pranova e studiova edhe unë. Në vitin 1967 ai i përfundoi me sukses të jashtëzakonshëm studimet e larta dhe u dërgua të punonte në Dibër. Dy vjet më vonë pata edhe unë po atë fat. Gjithmonë ai ishte një hap përpara dhe në kuptimin më njerëzor të fjalës ishte udhërrëfyesi im. Nga lartësitë e kodrës ku jemi ngjitur e me gjasë, si të gjithë të tjerët ndonjë ditë do të kalojmë prapa saj, u yshta të shkruaj disa radhë për të, për këtë mjek të jashtëzakonshëm e mik të papërsëritshëm, Qemal Çadrin. Pena ime është e pafuqishme për të portretizuar karaktere të tilla, përtej normales siç qe e është ai, por gjithsesi do të provoj, edhe pse jam i bindur se do të mund të them vetëm një pjesë të vogël të asaj që ai është. Së paku do të trokas një herë në memorien e të gjithë dibranëve që e njohën dhe patën fatin të marrin shërbimin e tij , të shokëve e miqve në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë dhe që jam krejt i bindur se mendojnë tërësisht si unë.

Po kush është Dr. Qemali? Ai ka lindur në fshatin Trebisht, me 23.10.1944. Është i biri i Mehmetit, mësuesit fort të nderuar që pat studiuar në shkollën normale të Elbasanit së bashku me mikun e tij, Mësuesin e Popullit Selim Alliun. Se ç'nivele ishin ata, Dibra e di, por është kuptimplotë fakti se kur ishin rrethet e vogla që të dy ishin shefa të arsimit, Selimi në rrethin e Peshkopisë e Mehmeti në atë të Shupenzës. Prindërit e Qemalit, Mehmeti dhe bashkëshortja, lindën dhe rritën 7 fëmijë, 6 djem dhe një vajzë, Agimi, Qemali, Ramazani, Iliri, Dilaveri, Bujari dhe motra e tyre e vetme, që ishte si të thuash Hirushja e familjes. Sa herë do të shkoja me ndonjë shërbim në Trebisht, do më priste së bashku me bashkëshortin e saj në familje, tamam sikur të isha vëllai i saj, pasi e dinte që ne ishim miq të mirë. Ajo nuk do të harronte asnjëherë të më thoshte se qe e kënaqur dhe i dukej se i kishte ardhur Qemali në shtëpi. Të gjithë ata studiuan e u bënë jo vetëm me shkollë të lartë, por ekspertë shumë të spikatur secili në fushën e vet. Por ndoshta edhe pse kam njohje më të plotë, Qemali për mua ishte një univers me vete.



Gjithmonë ai ishte një hap përpara dhe në kuptimin më njerëzor të fjalës ishte udhërrëfyesi im. Nga lartësitë e kodrës ku jemi ngjitur e me gjasë, si të gjithë të tjerët ndonjë ditë do të kalojmë prapa saj, u yshta të shkruaj disa radhë për të, për këtë mjek të jashtëzakonshëm e mik të papërsëritshëm, Qemal Çadrin.

Kur ne studionim në shkollë të mesme, ai nuk qe as ndonjë sportist i niveleve të larta dhe as ndonjë fizik nga ata për të cilët populli thotë: "Shtati pyll e mendja fyll". Ai qe thjeshtë një mendje brilante. Në shkollë tregohej me gisht si më i miri dhe që i tepronte çdo ditë së paku 3/4 e kohës së studimit tonë të detyruar dhe prandaj merrej me gjuhë të huaja a letërsi artistike. Pedagogët, të shkolluar të gjithë jashtë siç ishin në atë kohë, e shikonin me admirim e përpiqeshin kush e kush ta aktivizonte më parë në specialitetin e vet. Ai ishte jo vetëm kujdestari i klasës, por epiqendra e saj. I dëgjoja gjithmonë shokët e tij kur thonin, jo se kështu e tha Qemali. Në klasë kishte shokë e shoqe, nxënës shumë të mirë, që më vonë bënë studimet e larta dhe u bënë personalitete në jetë. Pati prej tyre shkrimtarë, aktorë, politikanë dhe sigurisht mjekë titullarë, që drejtuan spitale e klinika në nivel rrethi e në shkallë Republike. E kam ende të freskët një episod që i përket shkurtit të vitit 1961, shpresoj që t'i kujtohet edhe Doktorit. Nxënësit që dalloheshin shumë në mësime, shkolla i shpërblente duke ju dhënë bursë dhe kishin të drejtë t'i vazhdonin studimet falas. Në atë ditë, na nxorën para shkollës, në oborrin e saj aty ku sot është shkolla "Skënder Caci", tre nxënës që na kishin përzgjedhur për të na dhënë bursë. Në mes tyre isha unë si më i vogli që kisha mbaruar vetëm semestrin e parë të vitit të parë. Anash meje ishin dy nxënës të tjerë që kishin mbaruar semestrin e parë të vitit të tretë. Nga njëra anë ishte ai, Qemali, që tregohej me gisht për mirë dhe për një inteligjencë të rrallë natyrore. Nga ana tjetër ishte shoku i tij i klasës në shkollë të mesme e në të lartën, Sali Berisha. Ata ishin dhe mbeten miq të mirë së paku sa ishin të dy kontribues në shëndetësi, pastaj drejtimet e tyre u ndanë. Edhe pse ishin miq ata ndryshonin nga njëri-tjetri. Dr. Berisha, njeri këmbëngulës, që studionte vazhdimisht deri në orët e para të mëngjesit, padyshim që arrinte rezultate të mira. Dr. Qemali qe një natyrë tjetër, pasi dëgjonte me vëmendje shpjegimin e pedagogëve, regjistronte gjithçka në hardiskun e tij dhe i mjaftonte një përsëritje 15-30 minuta e mësimeve në ditë dhe ato mbeteshin aty si të skalitura në gurë e që koha nuk i fshinte dot. Me admirim e ndjek edhe sot kur tregon për interpretime teorike të shkencës mjeksore, a thua se këto mund t'i ketë dëgjuar dje. Ai kurrë s'e hoqi librin nga dora, por bazat e vërteta të shkencës i mori që në shkollë, i kultivoi e konsolidoi në praktikë.

Në Fakultetin e Mjekësisë ishte pa asnjë diskutim një student i shkëlqyer, në të gjitha vitet, në të gjitha lëndët. Dibra asokohe ka patur studentë të mirë në mjekësi. Por nëse ne të tjerët studionim dhe natyrshëm do të kishte dhe rezultate, Qemali ishte një rast i llojit të vet. Më kujtohet thënia e një pedagogu autoritar të mjekësisë në atë kohë, që i kishte dhënë mësim dy vite më parë. Kur erdhi fjala për Qemalin, na tha: "Ai është tjetër rast. Tipa të tillë, me inteligjencë karakteristike vinë në Fakultetin tonë një rast në 20 apo 30 vjet".

Gjatë gjithë kohës së studimeve ishte ai përgjegjësi i grupit të tij, starost grupa, siç i thonin atëherë. Të gjithë pedagogët e mëdhenj të asaj periudhe: Bajram Preza, Josif Adhami, Fejzi Hoxha, Ylli Popa, Petrit Gace etj., të gjithë kur ngrinin grupet shkencore me studentët e kërkonin kush e kush ta merrte Qemalin në lëndën e tij. E do të referonte në aktivitete shkencore të fakultetit sa nuk merrej vesh nëse ishte mjek i ri apo specializant, kur mësohej se qe student, do t'i habiste të gjithë. Preza e donte neurolog, Ylli Popa kardiolog, ndërsa Petrit Gaçe bëri çmos që ta bënte kirurg. Ai nuk e pati shansin të bëhej specialist në të gjitha fushat e mjekësisë, sepse një praktikë e tillë edhe nuk ekzistonte. Por ai nuk zhgënjeu askënd. Ishte si një oficer gjitharmësh, që i njeh shkëlqyeshëm të gjitha disiplinat e fushës së vet. Kur ishte student dhe përgjigjej në provime, qe aq i veçantë si rast, sa nga Radio Tirana do të vinin t'i regjistronin përgjigjet e tij në provime. Mbrëmjeve në darkë në Radio jepej një emision shëndetësor dhe aty do të dëgjoje shpesh zërin e Hamdi Sulçebes duke dhënë këshilla për mirëritjen e fëmijëve, por jo rrallë edhe zërin e një studenti të shkëlqyer që përgjigjej në provime, të Dr. Qemalit Çadrit. E përfundoi me sukses të jashtëzakonshëm Fakultetin e Mjekësisë në vitin 1967.

Nuk e pati rastin as të rrinte në Tiranë e as të dërgohej për specializim jashtë shtetit. Nëse kjo do të kishte ndodhur, jam krejt i bindur se Shqipëria do të kishte në strukturat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë një përfaqësues të denjë që do të na bënte nder të gjithëve. Ai u dërgua në Dibër dhe shpejt ju komunikua emërimi si mjek në lokalitetin e Klenjës. Me humorin e tij mjaft të hollë Doktori e kujton me detaje ditën e parë të punës në spitalin e Klenjës. "Ajo ka qenë një ditë dimri e ftohtë dhe me shumë borë, - kujton ai. - Pasi i zbrita makinës te Ura e Çerenecit afër Shupenzës, rrugën deri në Klenjë e bëra me disa fshatarë që udhëtonin andej më këmbë dhe na zgjati disa orë. Më në fund arrita në qendrën e fshatit dhe mezi prisja që të shkoja në spital. U paraqita në zyrën e Lokalitetit dhe sekretari thirri Ramën që të më shoqëronte. Rama ishte magazinier, qe një burrë i imët, mjaft i sjellshëm dhe më vonë mora vesh se do të kisha punë me të. Disa herë i thashë të më dërgonte në spital, por ai nuk bënte krye dhe më ftoi që të shkonim në klubin e fshatit. Nuk i njihja ato ambiente atëherë dhe prandaj hezitova, por ai vazhdonte: Do të shkojmë edhe në spital, o Doktor, por hajde një herë ndalojmë këtu. Më në fund u binda dhe u futëm në atë që quhej klub. Tymi i duhanit dhe era e alkoolit dhe zhurma që bëhej aty nuk të linin të shikoje e as të dëgjoje njeri. Në mes ishte vendosur një fuçi e madhe që mbushej nga sipër me dru dhe shërbente për të na ngrohur. Duke qenë se atëherë nuk pija duhan dhe alkoolin nuk e kisha provuar, u pështjellova fort keq dhe dola me vrap jashtë. Pasi volla nja 2-3 herë dhe i lodhur e ngrirë siç isha, u futa përsëri, nuk kishte rrugë tjetër. Më vonë mësova nga Rama se spitali qe nja 5 minuta larg, vendosur në një kodër. Por si ndërtesë njëkatëshe që ishte, e kishte mbuluar plotësisht dëbora dhe ata që punonin aty kishte nja 2-3 javë që nuk kishin vajtur fare në punë. Kuptohet, nuk kishte asnjë të sëmurë të shtruar. Nga qendra e fshatit, ditën e parë pashë vetëm një grumbull dëborë në majë të një kodre dhe kjo do të ishte më vonë qendra ime e punës. Atë natë përfundova mik te Rama".

E filloi me zell të madh punën në zonën e Klenjës dhe në fshatrat përreth, sidomos duke u kujdesur për shëndetin e nënave e të fëmijëve 0-3 vjeç, por dhe të gjithë popullsisë së zonës.



Qemal Çadri (i pari), në Klenjë.

Respektoni ata që e deshën Dibrën dhe punuan aq fort për emrin dhe nderin e saj.
Nëse nuk mund t'i nderoni, shajini. Shajini, por mos i harroni.



Në vitin 1970 u dërgua për specializim në Kirurgji të përgjithshme në Tiranë, por synimi i profesorëve që e njihnin ishte Kardiokirurgjia. Pasi kishte bërë një vit specializim, nuk u miratua nga rrethi specializimi në Kirurgji dhe u rikthye përsëri në Klenjë, ku punoi si mjek i përgjithshëm deri në vitin 1973. Në janar të vitit 1973 u dërgua për specializim në patologjinë e përgjithshme, të cilin e kreu me sukses të plotë. U rikthye në Dibër dhe u emërua shef i shërbimit të patologjisë të rrethit Dibër, në spitalin e Peshkopisë e këtë detyrë e kreu për 14 vjet me radhë me shumë dinjitet e profesionalizëm si rrallëkush. Gjatë kësaj periudhe kreu disa kualifikime e specializime afatshkurtra. Për një periudhë kohe mbulonte edhe shërbimin e neurologjisë para se ai të ndahej më vete dhe kryente me sukses punksionet lumbare e procedura të tjera të ndërlikuara. Në periudhën 16 janar deri 16 prill të vitit 1979 ishte në patologji të përgjithshme. U dërgua për profilizim në shërbimin e nefrologjisë me 16 mars deri 16 qershor 1988 dhe pas kësaj periudhe shërbeu kryesisht si nefrolog. Me shumë specializime dhe profilizime e mbi të gjitha me një intuitë profesionale të jashtëzakonshme, ai do të ishte mjeku i kompletuar që do të pyetej në çdo rast e do të thirrej në konsulta në të gjitha rastet e ndërlikuara edhe jashtë profilit të tij. E pata dëgjuar personalisht mjekun Femi Agolli, që ishte një drejtor autoritar i kohës së vet, duke u thënë disa mjekëve: "Le të flasë Qemali një herë, pastaj diskutojmë ne të tjerët".

Për meritat e padiskutueshme që kishte, me 15 qershor 1982 emërohet si drejtor i spitalit të rrethit, që atëherë quhej Drejtor i Institucioneve të Mjekimit të rrethit Dibër.

Me 1 qershor të vitit 1983, Qemal Çadri u emërua përgjegjës i seksionit të shëndetësisë të rrethit, detyrë të cilën e kreu me dinjitet deri me 31 tetor të vitit 1986 dhe më pas u rikthye përsëri në detyrën e patologut të përgjithshëm në spitalin e Peshkopisë. Më pas ai kërkoi që për arsye familjare të transferohej në rrethin e Tiranës dhe kjo kërkesë ju plotësua në shkurt të vitit 1991. Në Tiranë u emërua si patolog pranë urgjencës së spitalit Nr.1, ndërsa më 1 janar 1993 u dërgua si përgjegjës i Poliklinikës nr.10 në Tiranë. Aty vazhdoi të punojë derisa doli në pension si një mjek me aftësi të rralla diagnostikuese e mjekuese. Zotëronte në nivel mjaft të mirë gjuhët ruse dhe angleze.

Dr. Qemali është erudit. Lexonte dhe ishte i azhurnuar në çdo kohë. Koha nuk e la dot prapa se ai ishte në garë me të dhe do ia kalonte gjithmonë. Hokatar në jetë dhe jashtëzakonisht serioz në punë. Asnjë kompromis nuk mund të bëhej me të në këtë drejtim. Edhe miqtë e tij më të mirë, do të ishin pré e kritikës së tij të hollë e të rreptë, kur ishte fjala për shërbim ndaj të sëmurit, vlerësimin e jetës së njeriut.

Si çdo njeri i ditur është mjaft modest. Kam përpara një karakteristikë të tij të marrë nga zyra e kuadrit të asaj kohe dhe ku ai fare thjeshtë shkruan: "Njoh gjuhët rusisht dhe anglisht. Nuk kam gradë shkencore". E ç'vlerë do të kishte grada shkencore përballë asaj eksperience të rrallë, atij kontributi të madh në shërbim të njerëzve, të atyre mijëra e dhjetëra mijëra vizitave e konsultave dhe qindra, ndoshta mijëra jetëve të shpëtuara. Asnjë titull, asnjë medalje a dekoratë nuk do ta kishte vlerën e atyre që një njeri modest e i ditur si ai, ka mundur të bëjë në jetë.

Ka qenë një rast i ngjashëm si ai në spitalin nr.1 të Tiranës dhe pedagog në mjekësi. Ai ishte mjeku Skënder Dauti, pa tituj e grada shkencore, por të gjithë të tjerët dhe ata që kishin titujt më të lartë, kur ndodheshin para ndonjë rasti të vështirë që nuk i jepnin drejtim, shpreheshin: "Ta pyesim Skënderin një herë". Kështu, ai ishte i zakonshëm dhe i jashtëzakonshëm. Nuk ishte mjek i udhëheqjes, por për të vënë diagnoza të vështira e me përgjegjësi do të thirrej dhe duke qenë i aftë e kurajoz thoshte i pari: "Për mua është kjo ose ajo diagnozë" - dhe jeta e konfirmonte saktësinë e mendimit të tij. I tillë ishte e është edhe kolegu ynë legjendë, Dr. Qemali.

Para disa kohësh, i dërguar nga Ministria e Arsimit, u ndodha në një Universitet privat në Vlorë. Rasti e solli që ta përmendja profesorin tonë, Dr. Skënder Dautin. Pas përfundimit të takimit më bëri përshtypje të madhe, pasi nja 20-25 mjekë vlonjatë ishin rreshtuar për të më përshëndetur. Na nderove shumë, - më thanë, - na përmende Skënder Dautin dhe ai ishte joni dhe ka punuar edhe me ne këtu në Vlorë. Kam qenë disa herë në Dibër, sidomos për të nderuar figura mjekësh të brezit tim, por nuk kam dëgjuar aty të më thonë se kam punuar me Qemal Çadrin, Vebi Ketën, Hysen Pashën, Xhavit Miftarin, Muhamet Kodrën apo ndonjë tjetër të atij brezi.

Dikur, kur bëja detyrën e përgjegjësit të shëndetësisë të rrethit, puna e kërkonte që të shkoja në çdo zonë të Dibrës. Më pat bërë përshtypje modestia e atyre mjekëve shembullorë, një pjesë e të cilëve ishin të ardhur me shërbim në Dibër. Kur uleshim të bisedonim të gjithë më patën thënë se Dibra ishte e vështirë, por shumë mikpritëse dhe ata ishin të lumtur që i kishin sjellë te ne. Një pjesë e tyre ishin studentë të shkëlqyer dhe sot janë ngjitur në majat e shkencës mjekësore shqiptare, por të gjithë më patën thënë: "Ka qenë fat i madh për ne që erdhëm në Dibër dhe kemi bërë stazhin në Peshkopi e punuam me Qemal Çadrin. Ne mësuam prej tij shumë më tepër seç kishim mësuar në Fakultet. Dibra dhe Qemali kanë qenë një Fakultet i dytë për ne". Kështu më thoshte Arben Ademi, që shërbente në Tuçep, Pëllumb Tafili në Reç, Ali Ceni në Lurë apo Aleksandër Hoxha në Selishtë dhe Kita Sallabanda në Maqellarë.

Unë do të sjell nja dy raste nga ato që i kam jetuar personalisht në atë kohë. Në ato vite, kur isha ende mjek në Shupenzë, na u sëmur një shok dhe nga shenjat e jashtme dukej si një insult cerebral. E dërguam në spitalin e zonës dhe kërkova të lidhem me mjekun e rojes në spitalin e Peshkopisë, që për fat ishte Dr. Qemali. Më bëri disa pyetje dhe unë i verifikova te pacienti sipas porosisë së tij. Në fund më tha se: "Mendoj se është hemorragji e cipave të turit dhe pacienti mund të transportohet, prandaj po të nis ambulancën. Unë do të kisha ardhur vetë, por jam roje dhe kam shumë të sëmurë në spital". I sëmuri shkoi në spital dhe filloi të mjekohet aty nën kujdesin e tij direkt, filluan dhe përmirësimet e para. Diagnoza e vënë me telefon nuk u ndryshua as atë ditë dhe as më vonë. Pas disa ditësh në spitalin e Peshkopisë erdhi konsulta eprore e spitalit nr.1 të Tiranës për të vlerësuar shëndetin e një ushtari. E konsultoi edhe rastin që përmenda dhe tha vetëm dy fjalë: "Është diagnostikuar e trajtuar me kompetencë të lartë profesionale nga mjeku kurues".

Në një rast të dytë jemi ndodhur të dy në Tiranë. Na kishte ardhur një i njohur që ishte sorollatur shumë me një patologji të gjakut që i bënte mjekët të dyshonin për keq. Unë isha marrë me atë rast dhe e kisha shoqëruar edhe në klinikën e hematologjisë, ku as atje nuk u shpjegua dot se ç'ishte. Ju bënë lloj-lloj analizash, bile edhe punksion lumbal, por problemi mbetej enigmë. Ne atëherë punonim të dy në Poliklinikën nr. 10 në Tiranë. Ia referova rastin Dr.Qemalit. Qeshi dhe më tha se për mua kjo është një gjë fort e thjeshtë. Është një pararazit që jep ndryshime të tilla të formulës së gjakut dhe i konfondon mjekët. E dërguam të bënte një analizë të thjeshtë dhe dyshimi u konfirmua. "DR. Adhamudhi" - siç thoshte shpesh me shaka, shkroi një recetë që kushtoi vetëm 200 lekë dhe i sëmuri me nja 7-8 tableta u shërua. Kohë më vonë e takova shefin e Hematologjisë të asaj kohe, të cilit i kishte mbetur merak ai rast dhe më pyeti se ç'bëhej me fatin e atij të sëmuri. I thashë se i sëmuri është shëndoshë e mirë dhe se atë e kuroi Qemal Çadri me një recetë fare të thjeshtë. Shefi i klinikës e njihte Doktorin që nga shkolla e mesme. E kam parasysh mimikën e tij edhe sot, kur më tha: "Eh, ai Qemali, ç'mendje është!". Sikur desh të më thotë se ai është më i madhi ndër të gjithë ne.

Kohë më parë kam intervistuar mjekun e parë dibran të shkollës shqiptare, Dr. Ahmet Alliun. Duke e pyetur për kolegët, kur erdhi radha te Qemali, më tha: "I jashtëzakonshëm!" Dhe më tregoi një rast. "Të gjithë ishim mbledhur në një konsultë dhe po analizonim një rast të vështirë. E thirrëm edhe Dr.Qemalin. Ai i hodhi një sy analizave dhe e kqyri të sëmurin dhe tha vetëm një fjalë: mononukleozë dhe u largua. I sëmuri u dërgua dhe në Tiranë e kush nuk u mor me të, por diagnoza mbeti ajo që tha Qemali. Në jetën e tij ka me mijëra raste të tilla, sepse ai ishte i tillë jo një herë, apo rastësisht, por në çdo ditë të punës e të jetës së tij.

Qemal Çadri është edhe një bashkëshort i mirë e prind shembullor, mikpritës dhe që di të nderojë e respektojë të tjerët. Me bashkëshorten e tij, Dr. Avijen, kanë lindur e rritur 3 fëmijë, dy vajza dhe një djalë. Ata janë edukuar më së miri dhe kanë kryer të gjithë arsimin e lartë. Rovena është juriste dhe ka punuar në institucionet e administratës qendrore. Ndërsa Vilma është mjeke nefrologe në QSUT dhe ecën me dinjitet në rrugën e prindërve, ndërsa Ledi ka studiuar për fizioterapi dhe ushtron me pasion profesionin e tij. E kam parasysh Doktorin sa i merakosur ishte kur bëhej fjalë për shkollimin e fëmijëve. Edhe në këtë fushë ai ia ka dalë me sukses. Qemali është krenar dhe trim, por fort i butë e i ndjeshëm me njerëzit që kanë nevojë për të, veçanërisht me të sëmurët. Madhështinë e Everestit e dinë vetëm ata që kanë tentuar ta ngjisin atë. Unë pata fatin për gati 60 vjet të jem pranë tij, këtij Everesti njerëzor. Unë jam krenar për miqësinë që pata dhe që kam me të. Kam besim se krenar duhet të jenë edhe të gjithë mjekët e Dibrës, të sëmurët që morën shërbimin e tij dhe popullí i saj për djem si ai. Figura të tilla duhet të nderohen fort dhe në meritë. Jo vetëm ai, por dhe të tjerë si miku i tij Xhafer Martini, apo studiuesi Iljaz Kaca e ndonjë tjetër.

Kam lexuar një herë një shkrim ku e kishin pyetur shkrimtarin e respektuar të Dibrës Xhafer Martinin: A jeni ju Qytetar Nderi i Peshkopisë apo i qarkut të Dibrës? Dhe ai, duke qeshur, qe përgjigjur: "Jo, nuk më ka ardhur radha akoma". Xhafer Martini ka ngritur lapidarë me penën e tij jo vetëm për krahinën nga është, por për gjithë Dibrën e më gjerë. Këto lapidarë do të jetojnë në shekuj dhe do ta lartësojnë Dibrën dhe historinë e saj edhe kur ne të mos jemi më. Po kush janë ato figura që mund të vlerësohen para këtyre personaliteteve e që kanë fuqi t'i vënë ata në radhë. Nuk më duket se ka vërtet të tilla.

Ka një shembull mjaft domethënës me një intelektual tjetër shumë të nderuar të Dibrës, zotin Abdurahim Ashiku, i cili aktualisht jeton në Athinë e duket rrallë këtyre anëve. E kam njohur nga afër në ato vite kur të dy punonim në fshat dhe në zona afër njëra-tjetrës. Ishte punëtor, serioz dhe një penë e fuqishme që shkroi për Dibrën e dibranët pa u lodhur asnjëherë. I fuqishëm kur ishte në Dibër, i paarritshëm sot që është larguar. Ai sot boton gati çdo vit nga një libër, shkrime e artikuj pa fund, kryesisht për Dibrën, historinë dhe kulturën e saj. Janë të pafuqishme fjalët e mia përballë veprës së tij, ndoshta të papërsëritshme. Po më të ç'bën shoqëria e sotme dhe institucionet që ne kemi. Ai flet e shkruan përditë, ndërsa ne heshtim gjithnjë. Nuk kanë vetëm ata detyrime për Dibrën, ka dhe Dibra e dibranët dhe institucionet e kohës detyrime për ta. Nuk është mirë të ndodhë siç ka ndodhur me Elez Isufin, që e propozuan për Hero të Popullit, pas vitit 1985. Kjo e kishte habitur edhe udhëheqësin komunist të kohës, Ramiz Alinë, i cili kishte pyetur: "Po përse, për tani e keni lënë ju Elez Isufin që luftoi e u vra me serbët për mbrojtjen e territoreve shqiptare që në vitet para Luftës së Pare Botërore?" Prandaj Qemal Çadri dhe takëmi si ai duhen nderuar sot e jo mot.

Kujtoj dhe një rast që më duket domethënës. Atë, kur një shkolle në Tiranë ju vendos emri "Dritëro Agolli". Shkrimtari i madh që asokohe ishte gjallë, e vlerësoi shumë këtë dhe e shprehu në fjalën e tij. "Bëtë mirë që më ftuat edhe mua, - ju tha, - se disa vite më vonë nuk do të ju vinja", duke shprehur me ironinë e tij të hollë se më vonë për të nuk do të kishte më kuptim. Prandaj po thërras me zë plot, respektojini djemtë tuaj. Respektoni ata që e deshën Dibrën dhe punuan aq fort për emrin dhe nderin e saj. Nëse nuk mund t'i nderoni, shajini. Shajini, por mos i harroni!

Tiranë, shkurt 2019



Nga e djathta në të majtë: Hysen Pasha, Ajli Alushani - ish minister, Qemal Çadri dhe Preng Doçi.

Profesor Egriu lindi në Maqëllarë të Dibrës, në vitin 1939, vit që përkon me pushtimin fashist të Shqipërisë. Ishte ky një mesazh i qartë, se jeta e tij do të ishte përherë e trazuar e ai si një skaf i shpejtë, do të kapërcente në shpinë të dallgëve, për të arritur bregun.

Profesor **Egriu**, "ambasadori" dibran në Suedi

Nga **OSMAN XHILI**

Të shkruash për profesorin e nderuar, Ibrahim Egriu, është sa e lehtë, aq dhe e vështirë. E lehtë, sepse jeta e tij është e ngjeshur me një aktivitet të begatë arsimdashës e patriotik. E vështirë, sepse nuk mundesh të pasqyrosh gjithë këtë material, brenda kornizave të një shkrimi, apo emisioni televiziv.

Profesor Egriu lindi në Maqëllarë të Dibrës, në vitin 1939, vit që përkon me pushtimin fashist të Shqipërisë. Ishte ky një mesazh i qartë, se jeta e tij do të ishte përherë e trazuar e ai si një skaf i shpejtë, do të kapërcente në shpinë të dallgëve, për të arritur bregun.

Kombi i tij rënkonte. I ndarë e i copëtuar në disa shtete, zemra në Tiranë, gjymtyrët në Prishtinë e deri në Shkup, degë të tjera në Europë e botë. Ibrahimi i ri e kuptonte se për të kryer misionin e tij duhej të ishe i ditur e më pas t'ua përcillje të tjerëve këtë dituri. Mbaroi arsimin e mesëm e më pas shkollimin e lartë për gjuhë letërsi. Jo më kot e zgjodhi këtë degë, pasi gjuha e leximi ishin më të rëndësishmit për momentin. Ky komb duhej të kultivonte e të mbante gjallë gjuhën e tij dhe vetëm përmes saj të mbijetonte. Profesori, atëherë i ri u dashurua me dramën. Kjo gjini e artit mund ti jepte mundësi për ti dhënë popullit të tij mesazhe për revoltë, mesazhe se makina e vjetër luftarake po jepte shpirt.

Viti 1979. Katër drama të vëna në skenë me ndjenjë, art dhe emocion. Katër drama që tronditën dhe pështjelluan jetën intelektuale të Shkupit. Kishte në to fllad, kishte revoltë, jetë, lotë e shpresë. Të tilla ndjenja provokuan dramat e Ibrahimit, që tashmë kishte filluar të piqej. Por makina luftarake nuk mund të lejonte gjëra të tilla të rrezikshme ti kalonin nën hundë. Ato do të ishin një shkatërrim për të. Profesori e nuhat atë që po gatuhej për fatin e tij dhe të intelektualve të tjerë shqiptarë, furtunën që pritej të kosiste kokat e tyre. Ai nuk do t'ja lejonte vetes të plasej sërish në burg. Nata e tmerrshme e vitit të ri 1969, ishte akoma e freskët në kujtesën e tij.

Iku në Zvicër e më pas në Suedi, bashkë me familjen. Iku atje ku fjala është e lirë, ku fjalën nuk e prangosin, ku buzët që e shqiptojnë atë nuk i mbyllin, ku duart që e shkruajnë atë nuk i lidhin. Iku me një brengë në zemër, por dhe me një shpresë, me një përkushtim. Ndoshta akoma më shumë do ti jepte çeshtjes shqiptare, do ti jepte trupin





dhe shpirtin e tij.

Më 5 maj 1986, hapet në Suedi radioja e parë shqiptare, ku Ibrahimi ishte truri i saj. Ai ishte redaktori, regjizori, gazetari, ndërlidhësi. Net të tëra, kujton profesori, e gdhinim në një divan të thjeshtë, aty në studjo. Pinim kafe të shpeshta dhe harronim ndonjëherë të hanim dhe bukë. Sidoqoftë, pas viteve nëntëdhjetë, çeshtja shqiptare do të diskutohej në shumë media e tryeza të politikës botërore. Ishin vite të vështirë, por shpresëdhënës. Dhuna e represioni ndaj shqiptarëve, bënë që të largohen 60 mijë veta vetëm në Suedi. Kush do ti dallonte këta njerëz më pas se janë shqiptarë, po të mos ishte gjuha? Kjo pyetje vërtitej papushim në kokën e profesor Ibrahimit dhe të kolegëve të tjerë. Përpjekjet e tyre spontane duheshin bërë më efektive dhe ngritur në një shkallë më të lartë.

Më 30 maj 1992, krijohet L.A.SH, Lidhja e arsimtarëve shqiptarë. Nuk ishte thjeshtë një emër, një organizatë fantazëm, një shoqatë si të sotmet, që gëlojnë gjithandej për të vjedhur në mënyrë moderne. Ishte një staf pune me 266 pedagogë, që mësuan pa fare shpërblim 7200 nxënës, në 72 kampe, anëembanë Suedisë. Madje, si të mos mjaftonte kjo dhe tekstet shkollore duhej ti hartonte vetë. Shumë shpejt, nxënësit mbanin në duar gramatikën shqip – suedisht, antologji, histori, gjeografi e plot tekste të tjerë. A mund ti harrojnë këta nxënës, vite më vonë, mësuesit e tyre, këta heronj, që ditën tu sjellin dritën, kur ajo po mekej, që u mbollën krenarinë e të qenit shqiptar, kur ajo po hidhej si një maskë pa vlerë? Me siguri, jo. Emrat e tyre janë gdhendur në botën e të gjallëve, por besojmë dhe Zoti i Gjithësisë, do tu afrojë vende të këndshme në xhenet, ku rrjedhin lumenj të mrekullueshëm.

Shtatë mijë shqiptarë mbaheshin në burgjet serbe. Ata kërkonin për avokat mbrojtës popullin shqiptar, dheun që i lindi dhe i rriti këta trima. Zëri i Ibrahimit bashkohet me atë të shqiptarëve të tjerë, për të sensibilizuar organizma vendimmarrës kudo në botë, deri në kongresin amerikan. Ai bashkon, jo thjeshtë zërin, jo thjeshtë pendën e tij të mprehtë, por shumë më tepër. Bëhet organizator i dy grevave të urisë në Malmoe. Natën e vitit të ri 2000, kur njerëzit hanin e pinin gjëra të zgjedhura, profesori me shokë luftonte mes jetës dhe vdekjes. E çfarë mund të jepte profesor Egriu më shumë se jetën e tij? Por jeta i duhej akoma, se punë të tjera, të mëdha e prisnin përpara.

Profesor Egriu tani po u drejtohet të tetëdhjetave. Ndër urimet e shumta që i kanë ardhur nga të katër anët e botës, do të veçonim atë të patriotit shqiptar, Beqir Elshani. " Ti je një lumë dibran, që kurrë nuk ndalesh dhe fare nuk do t'ia dish për stuhinë dhe rrebeshet. Sa më shumë që ka furtunë, aq më shumë shkruan dhe ti, meqë në zjarr njihet ari dhe në erë valon flamuri kuq e zi. Atje ku ka revoltë, atje je dhe ti. Atje ku ka fitore, atje je dhe ti. Të lumtë dhe dalsh faqebardhë!

26 – 27 Nëntor2001. Në Prizrenin historik, në Prizrenin e kongreseve të mëdha, mblidhet Lidhja shqiptare botërore. 1600 delegatë, që nga Australia e largët, Amerika, Europa dhe padyshim nga trojet amtare, miratuan njëzëri platformën e bashkimit kombëtar, " në paqe e për paqe". Më tej platforma vazhdonte me kërkesën për forcimin e unitetit kombëtar dhe të kërkohen të drejtat e liritë e nëpërkëmbura shqiptare. Fjala e kryetarit Kuzhnini pasohet nga shumë të tjera. Profesor Egriu vinte në cilësinë e kryetarit të Lidhjes shqiptare botrore, për vendet skandinave, si dhe ishte në kryesinë e punës për organizimin e Kongresit. Fjala e tij pritet me nderim e respekt të veçantë. Pjesmarrësit mendojnë se është koha për një Institut shqiptar të studimeve gjeostrategjike, abetare dhe histori të përgjithshme kombëtare. Ishin këto delegatë, përfaqsues të rreth 15 milionë shqiptarëve, kudo në botë, që duket se po rizgjohen nga koma.

Në krah të profesor Egriut, e shoqja e tij, Mensurja, një grua me tipare të bukura dhe pse mosha bën të sajën. Një miku im teolog, emrin e saj e përkthen si ndihmëtare. Vërtet, e tillë ka qenë zonja e tij fisnike, duke mbështetur për gjysëm shekulli punën titanike të profesorit. Ata janë gjithnjë bashkë, në krah të njëri tjetrit. Kanë katër djem të mrekullueshëm, që punojnë me biznese serioze e të ndershme, duke u përpjekur ta çojnë më tej punën e babait të tyre.

Në fillim të viteve nëntëdhjetë, me ardhjen e demokracisë, Ibrahimi shkon në Maqëllarë të Dibrës, të çmallet me vendlindjen. Njerëzit që banonin në trojet e tij u trembën se do tu merrte tokën dhe shtëpinë, por ai i qetësoi. O vëllezër, nuk kam ardhur për t' ju flakur në rrugë, porse isha mallëzuar. Mori një grusht dhe te pragu i shtëpisë, e puthi, e lagu me lot dhe nuk fliste dot nga ngashërimi.

Profesor Egriu tani po u drejtohet të tetëdhjetave. Ndër urimet e shumta që i kanë ardhur nga të katër anët e botës, do të veçonim atë të patriotit shqiptar, Beqir Elshani. " Ti je një lumë dibran, që kurrë nuk ndalesh dhe fare nuk do t'ia dish për stuhinë dhe rrebeshet. Sa më shumë që ka furtunë, aq më shumë shkruan dhe ti, meqë në zjarr njihet ari dhe në erë valon flamuri kuq e zi. Atje ku ka revoltë, atje je dhe ti. Atje ku ka fitore, atje je dhe ti. Të lumtë dhe dalsh faqebardhë!

Skicë

Pse jo dhe varret...

Nga SELMAN MËZIU

Ndarje! Ikje e trishtueme! Vargonj në shpirtrat e mësonjëtoreve. Balta, qelizat e saja të kalbëzueme prej përbindëshave njerëz. Nga afshi i poreve të saj, shteroi vlaga e jetës. U tha. U mpiks. Ngriu në akull të qelqtë. Rinimi i gjallesës njeri u mavijos. Dikush i mëshonte varfërisë. Të tjerë, shkretimit. Varrmihësit e vetvetes. Me shumë ngadalë. Por e mbushur me lëngëzimin e helmt, të idhët, të neveritshëm. Shpresa nga hyjni, u struk diku thellë në shpirtrat e cfilitur. Xixëllonjat që herë-herë lindnin nga trupi i saj, ishin të mekta, të zbehta. Harkun ylberor s'mund ta kalonin.

Qyteti verilindor po humbte shkëlqimin. Rrezatime dijenish e shpresash kishin mbjellë dy mësonjëtorët. Jo pak por, katër dhjetë vjetshash. Ardhun prej dhenave të përtej Drinit. Aty ku kishte vlue shkulma - shkulma, heroizmi. Aty ku mençuria ishte ngulun si parmenda e drujt në larvat e kohërave. Urtësia, maturia e zgjuarsia ishin vllaznuem, motërzue e plazmue në shpirtin e Emries e Adrianit.

Mekuan për më se dyzete vjet, bijë e bija dibranësh. Me gjuhën e shqiptueme bukur. Me historinë e penestëve, romakëve, turqëve.... Me vullkanet e heroizmave të breznive. Me poezinë e Naimit, Veqilharxhit, Nolit, Bulkës, Arapit, Gjetës, Paplekajve, Agollit, Mitkos, Çajupit, Migjenit, Spahiut ushqyen vogëlushet e të rriturit si me ujë burimesh të freskëta. E ato nxanësit e tyre ngjitën shkallaret e dijeve. Të univesiteteve. Të piramidës së drejtësisë e letërsisë. Respekti, mirënjohja, urimet gurgullonin si ujët e kristalte të burimeve korabiane. E zemra pushtohej tërsisht nga ujvare gëzimesh. Krenaria rritej si mali me borë. Dy mësuesit shtonin ortekun e dijetarëve të ushqyer me zanin e tyre, me shkronjat e fjalët shkruar në dërrasën e zezë.

Rinia e pjekuria udhëtonin sëbashku. Ato ushqenin njëra-tjetrën në shkrimin e ditareve. Në studimin e librave të temave të ndryshme. Rriteshin dëshirat. Merrte krah pasioni. Fluturonte mendimi. Por puna me nxënësit ishte arti pedagogjik në përsosje. Gjithmonë i ndjeshëm. Po i prekshëm. Pse jo i ndjeshëm si telat e ndjenjave njerëzore. Vete Emria gërmonte, shkruante në netët pa gjumë histori të shkollës, të vendlindjes, Luznisë. Ndërsa Adriani ndiqte zhvillimin etnografik dibran. Kullat, karakollet, odat dibrane, oxhaqet, filluan t'i ushqejnë me plotë shkëlqim punën e pasionuar në muzeun e Peshkopisë. Pas një barbarizmi të hutuem, ai me atë qetësinë, maturinë, këmbënguljen e dëshirën, filloi sistemim, rivlerësim, krijime pamjesh e rifreskime mjedisesh e paraqitjesh. Një kënaqësi shpirtërore lulëzoi. Profesioni i historianit po merrte trajta të gjalla. Çifti Skuka udhëtonte në kthinat e kapërdredhura të kohës.

Por diçka përbrenda shoqërisë po kalbëzohej. Me eshtrat luanin fëmijët. Me barëra mali që ushqeheshin me gjak, dehesh rinia. Në foltoren e kuvendit njolloseshin ministrat e shaheshin të zgjedhurit e popullit. Në konin e shtetit kishte hyrë krokodili i krimit. Në popullin e varfër, gjarpri lëshonte helmin e arratisjes. Njerëzit kërkonin shpëtim. E kjo ishte udha e vetme. Ikje nga kjo makinë shtypëse. Që vetëm dhunonte fizikisht. Që vetëm përgojon. Që vetëm gjak kriminelësh e të pafajshmish mpikste në qeliza antinjerëzore.

Atëherë, po ndjekim udhën e mbretit Gent. Por jo të shoqëruar nga mijëra skllevër ilir. Ndërsa sot! Vetëm, po të dy të vetëm. Kështu pika-pika, larg e më larg nga vendlindja që s'të ushqen. Që s'të mëkon me asgjë. Por, prodhon veç helm shpirtëror vdekës.

Por, ja që malli do të na marr. E ai shpon gurin. Ai të përgjëron. Për plisin me bar. Për dashin e këmborës që iu prinë tufës. Për njeriun e mirë. Për ish-nxanësin profesor që përdor shkumsin akoma në shpjegim. Për melodinë me fyell të bariut. Për aromën e bukurinë e lule zonjës në bjeshkët e nalta. Por, ne të dy, nuk po ndalemi. Diku pranë mazoleut të Gentit do ngremë folezën e re. Po prej hallit. Me një dritëz shprese në beben e syrit. Me një vegim dielli në kreshtën shkëmbore të Korabit.

recensë

Vëllimi poetik "Qesh e qaj me lot" dëshmon se ky poet gjithnjë e më tepër po e rrit peshën e krijimtarisë së vet, ai po bëhet më aktiv në kapjen e temave të mprehta politike e sociologjike

Sinoret e Luznisë

Nga **MEVLUD BUCI**



Studiuesja Emrie Skuka ka shkruar me përkushtim e kompetencë për Luzninë,tradita, etnografinë, folklorin,frazeologji dhe ligje popullore,historinë në periudha të caktuara përballë turkut, luftën përballë serbit, po edhe kohën e Monarkisë, luftën partizane si dhe periudhën e monizmit. Është pra, një pasqyrimi gjerë i një realitetit të gjallë të kësaj krahine. Në hyrje të librit, shkrimtari i shquar AgronTufa e përcakton atë si një libër të shquar monografik, filozofik e publicistik, studimor, kronikal e enciklopedik. Treva e Luznisë, njëra nga Nëntë Malet e Dibrës, është treva e mençurisë, satirës dhe humorit therës e filozofik. Skuka, një mësuese gjurmuese, është ndalur pikërisht në këto, duke sjellë në fokus luftërat, figurat e shquara të udhëheqësve popullorë, kullat e qëndresës, etnokulturën, ç`kanë thënë e ç`kanë shkruar për Luzninë, prejardhjen e fiseve; ajo shkruan me drejtësi, argumenton me realizëm, jep tablotë e pashembullta të jetës, vetëmohimin popullor. "Krahina e Luznisë - shkruan Agron Tufa, - i mbijetoi një diktature ekstreme siç dihet, të pashembullt në gjithë kampin socialist të Europës Qendrore e Lindore"(fq.11).

Duke lexuar këtë libër e ndjen peshën e rëndë të viteve sikur je para Korabit apo Runjës. Në studimin "Amaneti i kujt është Luznia"?, fq.515-519, autorja shkruan:" Është amaneti i atyre që zgjodhën për herë të parë të jetonin aty, të atyre që banojnë aty, të atyre që u ndeshën me vështirësi si nga terreni e nga dimri i gjatë dhe i egër... Është amaneti i asaj djerse të derdhur për të gjetur rrugë e shtigje dhe për të siguruar mbijetesën".

Libri hapet me "Vendbanime të hershme", "Koha parahistorike", "Në antikitet", "Lusnja", "Mesjeta", "Në kohën e Skënderbeut", "Ligje zakonore, Kanuni,""Kararet e Dheut" "Oda dhe Kanuni" e plot kapituj të tjerë që vijnë radhë pas radhe në një qasje ndërtimore konceptuale.

Studiuesja Skuka ka argumentuar dhe zgjeruar studimet e dr.Adem Bungurit, Iliaz Kacës, Kristo Frashërit, Munir Shehut, Bajram Xhafës, Mevlud Bucit etj. Ajo përshkruan martirët e ndritur: Ali Lik Damzi, Elez Murrën, Isuf Murron, Hazis Manukën, trima të rrallë luznakë në betejën kundër turkut apo serbit, flet për zogistët, për luftëtarët partizanë, Luznia me kufijtë, sinoret, me filozofinë, gjenezën, toponimet dhe realitetet historike bëhet kështu një krahinë mjaft e veçantë që rrezaton vlera të rralla. Asnjë lexuesi nuk do t`i shqitej lehtë nga mendja shkrimi studimor: "Në kullën e Lam Dacit", "Isuf Murrja" etj. Dhe për epikën popullore që thur vargjet:

Isuf Murrja paska thanë
Pesë djem mbrapa i kam lanë,
Kam Dautin dhe Abdullanë
Pa pagu gjakun s`e lane.
Ka nis dita me zbardhue,
Ndal yzbash s`ke ku me shkue..
(fq.123).

Shkrimet "Kaçakët e Luznisë", eseja filozofike "Deri kur? Dikush, diku? Do të majmet me tokat e Shqipërisë?" (Vladimir Majakovski), argumenton qëndresën e patriotit Ali Likë Damzi. Kur printe Ali Damzi, i pushkatuar me pabesi nga monistat gjaksorë, që u preu dashin dhe i dhanë plumba, koha dridhej e rritej burrnia. Studiuesja shkruan për kullën e Manukës në Arap të Poshtëm, duke dhënë saktësisht epikën historike:

Një luan atje te kulla,
Qenkan mbledh do trajma burra,
Hazis Manuka ç`po thërret
O mor burra bani gajret
Krajsi topi e krajsi pushka
Jo s`dorëzohet Hazis Manuka
U drodh toka,u tund mali
Mu ke kuylla u vra gjenerali..
(fq.150).

I veçantë dhe me vlera mbetet kapitulli "Kanë thënë për Luzninë".

Studiuesja na jep materiale burimore të sakta nga studiuesit e tjerë si: Xhetan Prençi, Beqir Mata, Zija Skuka, Faslli Mera, Xhafer Martini, Xheladin Tollja, Dukagjin Hata, Halil Vani, Mevlud Buci, Mensur Murrja, Arif Mata, Bajram Krrashi, Dilaver Deda, Hasan LLeshi, Ram Hasani, Hysen Uka, Adrian Skuka, Sadik Damzi, Harjrie Ramadan Uka, Banush Skuka, Bashkim Dedja, Hajrulla Nikolli, Behar Mera, Genc Lleshi, Bilbil Mera, Jashar Uka, Haki Përnezha, Haxhi Damzi, Rahim Koleci, Bari Konesha e të tjerë...

Me një punë përkushtuese ajo pasqyron prijësin popullor Likë Damzi, shkrimet "Në vitet e regjimit të Zogut", "Lufta partizane", "Vendosja e pushtetit popullor" mbeten për t`u lexuar e rilexuar për vlerat që kanë; po kështu përshkrimet e saj për Maliq Skukën, Abdulla Murrën, Mal Merën, Isuf Merën, Vesel Shqutin, Nazif Ruçin, Emin Kurtin, Hajdar Murrën, Bajram Nezirin, Arif Matën, bëhen mjaft interesante për shkak të rrjedhshmërisë së tyre. Po kështu, në shkrimet për gjuhën shqipe ajo pasqyron portrete mësuesish të nderuar si: Sali Nezziri apo të drejtuesve të talentuar si: Mensur Dalip Murrja, Harjdar R.Poliçi, Xhelil Qerimi, Adrian Skuka, Likë Berisha etj. Po kështu, interesante mbeten shkrimet për vitet nëntëdhjetë si vite kapërcell.

Në shkrime të ndryshme si: "Etnokultura", Shprehjet frazeologjike, fjala e rrallë, Gjakmarrja, Fjalori, Veshja, Veshja e Grave, Dasma, Grishja, Ceremoniali i dasmës me këngët dhe vallet e Luznisë, Tre sahanët e mikut, Kryet e vendit dhe kryet e berrit, Gruaja, vendi dhe roli i saj, Gatimi tradicional, Vulat e Luznisë, Banesat, Ceremonia mortore, Rrugët e vjetra dhe urat, Lojërat popullore dhe festat, Pyjet kullotat blegtoria, Mjeksia popullore etj., etj., dëshmojnë për një vështrim tërësor dhe të thelluar të Luznisë.

Emrie Skuka ka dhuruar një monografi mjaft të çmuar dhe me vlerë që lexohet për vështrimin e saj dhe dritën që hedh në mjaft fusha të jetës nga historia në aktualitet...

"Qesh e qaj me lot", dëshmi e pjekurisë krijuese të Mevlud Bucit

Nga **QAZIM D. SHEHU**

Në poemën e vet madhore "Gomari i Babatasit", poeti ynë i dashur Gjergj Fishta pasqyron një moment. Një deputet vjen me gomar në parlament dhe e lidh zinxhirin e kapistrës tek kangjellat e godinës. Sot deputetët tanë nuk shkojnë me gomar në parlament, por me makina të shtrenjta, po gomarllëqet e tyre nuk kanë fund ndaj, po të rilexonin poemën e Fishtës, do ta kuptonin se po të shkonin me gomerë në parlament do të ishin më afër të vërtetës së tyre.

Them po të lexonin poemën e Fishtës, ndërsa duhet të lexojnë edhe këtë vëllim të Mevlud Bucit që i ka bërë fërtele dhe i demaskon poetikisht me gjuhën e humorit dhe satirës. Shpesh pyes veten: Nga vjen kjo racë mediokrish që, nga njerëz të zakonshëm, shndërrohen në "njerëz të rëndësishëm", bëjnë një shkëputje si me magji, sikur kanë pirë barin e harresës, nga e djeshmja e tyre; dhe nuk e gjej. Shumë analistë ia vënë fajin të djeshmes diktatoriale, kohërave të shkuara, faktorëve të një të shkuare më të hershme, po nuk e besoj, lëkundem. Si ka mundësi që njerëz të zgjedhur nga vota e popullit, vjen një ditë që i kthejnë krahët atij. Çfarë nuk shkon? Mos zgjedhjet e popullit janë të gabuara?

Një varg pyetjesh, që largojnë përgjigjet deri në pamundësi, të vijnë, ndërsa lexon vëllimin poetik të Bucit, një vëllim me vlera të veçanta për sa i përket thumbimit dhe tonit gjallërues që stigmatizon kastën e politikanëve shqiptarë të të gjitha ngjyrave.

Një nga veçoritë ideore të strukturimit të vëllimit është se autori nuk e shikon këtë kastë si të shkëputur nga fenomeni psikosocial i shoqërisë. Ata gjejnë në radhët e shoqërisë edhe njerëz të posaçëm që u shërbejnë, që i miklojnë, që i idhujtarojnë dhe kështu bëhen të "paprekshëm", kodoshë të lezetshëm dhe agresivë, njerëz që molepsin edhe shoqërinë...

Buci ka kohë që merret me satirën dhe fabulën; satira e tij rreh dhe trajton temën politike e, në këtë fushë, ai shpreh një aftësi të madhe, ndoshta shënon të vetmin poet satirik që e zbërthen këtë temë më mirë...

Të zhytur në "parajsën" e pasurisë "ata kanë "të drejtë" të sillen kështu, por populli duhet ta gjejë të drejtën e vet të mos i durojë, ndaj zemërimi i poetit është i ligjshëm, ai shpreh zërin dhe intuitën e çdo njeriu të drejtë, të moralshëm, që e do jetën të ndërtohet përmes drejtësisë, punës dhe kulturës, jo përmes egërsisë, padrejtësisë, përdhosjes së vlerave... Janë vlerat ato që ngrenë lart një shoqëri, së pari, vlerat morale, që e inkurajojnë një popull të ngrihet edhe nga hiçi. Por vlerat morale e japin rezultatin me vonesë, ndërsa amoraliteti shpejt. Kjo është tragjedia e ngutjes dhe e moskuptimit, e horizontit të ngushtë dhe e përfitimit të çastit. Këtë, poeti e sendërton përmes vargjeve lakonike. Lakonizmi i tij vjen përmes gjuhës së thjeshtë, në saj të ligjërimit oratorik dhe tribunal; ai me një duf të sinqertë të përçmimit jep dhimbjen dhe padurimin e njeriut të sotëm që shikon si nëpërkëmbet nga kjo klikë pushtetmbajtëse, e cila vjen si mallkim dhe çdo mallkim duhet nënçmuar...

Poezia e Bucit është e angazhuar, me nerv qytetar, ajo shpreh në tërësinë e saj pikërisht këtë, çka do të thotë se ky angazhim e bën atë të jetë sa më afër të vërtetës social-politike dhe kjo e vërtetë duhet kuptuar si e tillë kur sillet nga pena të stërvitura që, më herët, e kanë lëvruar atë...

Poezia e Bucit është poezi që i thur himne lirisë, të drejtës së njeriut që kërkon mos ia marrin atë që i takon, ajo ngrihet me vetëdije kundër padrejtësive dhe shushunjave politike që kërkojnë të mbijetojnë përmes mashtrimit, intrigës dhe llafollogjisë...

Buci është poet i epitetit dhe i krahasimit, dy figura që rrinë afër e afër dhe shpesh ndërrojnë pozicionet dhe bëhen komplementare. Ai identifikon tiparin shpejt, me vrull, me zemërim, mallkim, me keqardhje e përçmim ndaj të shëmtuarës që e gjen tek njerëzit e politikës, të cilët i shikon në bllok të këqij, mafiozë, të zbrazët e të mbushur me ethet e pasurimit. I vjen të qeshë me këto lolo, se vërtet janë për të qeshur, po i vjen edhe të qajë se ata janë lolo të rrezikshëm, përderisa aktrojnë të keqen në kurriz të gjithë shoqërisë.

Prandaj kemi një tragjikomedi, një ndërthurje zhanresh që ndihmojnë dhe elipsojnë njëra-tjetrën sipas rastit dhe tendencës ideore. Kjo tragjikomedi nuk luhet në ajër, as në shkreti; ajo luhet në përditshmërinë tonë, ka lidhje me jetën tonë, me fatin e kombit, prandaj mesazhi i poetit vjen natyrshëm duke sugjeruar kundërshtim, syçeltësi dhe vëmendje ndaj kamuflimit të së keqes.

Si poet satirist, Buci mëson nga mjeshtrit e mëdhenj, po krijon edhe stilin dhe mënyrën e tij të veçantë, origjinale. Vëzhgimi dhe nxjerrja e fenomenit si i veçantë brenda rëndomtësisë së tij, është tipari kryesor i shqetësimit të poetit satirist.

Shumë poezi të thurura në trajtën e një strofe kanë vlerën e një epigrami, ku fjala e ngjeshur nuk ka nevojë për shumë shoqe të saj. Edhe me katër vargje mund të japësh një realitet urban, kaotik dhe problematik, dhe, duhet thënë se Buci, përmes vëzhgimeve të tij, arrin ta bëjë këtë dhe të na sjellë herë pas here befasira të zbulimit dhe të mendimit poetik satirik....

Fryma dhe kuptimi që përftohet nga ky libër shtjellohet përmes mendimit dhe ndjesisë që na japin këto poezi të hovshme plot tonalitete që ziejnë nga atakimi që u bën autori mjaft problemeve dhe të ndodhurave në realitetin sureal dhe absurd shqiptar; ai pasqyron karaktere të deformuara që i gjen me lehtësi tek aradha dhe skota e politikanëve, por edhe në nivelet më poshtë të shoqërisë; deformimi i karakterit në periudhën postdiktatoriale erdhi si shkas prej mundësive që dha demokracia, të cilat u shfrytëzuan me një pangopësi të tmerrshme.

Janë një tufë tregimesh satirike që lexohen me ëndje, shkruar rrjedhshëm, si një rrëfim i dhimbshëm mbi njeriun që bëhet me lehtësi pre e vesit, që i ndodhur në situata të pakëndshme u dorëzohet atyre në



mënyrë të lehtë. Tregimet e Bucit janë në vijën e shtjellës satirike dhe krijojnë me penelata të shpejta tipa dhe karaktere që vizatohen përmes mundësisë dhe pamundësisë, e këtu krijohet konflikti i brendshëm psikologjik, humori që mpreh tehun e satirës.

Buci ka shkruar edhe një numër aforizmash si krijime të vetat, po edhe të sjella përmes mençurisë së popujve të ndryshëm. Edhe në libra të tjerë paraardhës ai ka shkruar aforizma, të cilat tregojnë për prirjen e tij në këtë fushë, për gjurmimet që i bën ai mençurisë, përvojës dhe diturisë.

Edhe në anekdotat, Buci tregohet i hollë, ata japin momente nga njerëzit e mëdhenj, Njutoni, Uollter Rilei, Bethoven, Dante, janë anekdota me kripë dhe humor, të veçanta dhe, ndoshta të padëgjuara e që jepen për herë parë. Ato vijnë në trajtën e konceptimit të librit dhe të strukturës së tij polizhanrore, politematike dhe me një fluks motivor. Si të tilla, kur duhet t`i lexosh ato, gjithnjë të shkon mendja se humori shkaktohet edhe nga gjëra të zakonshme, madje ai është humori më i mirëfilltë.

Buci shkruan edhe fabula të bukura, të cilat shprehin një aspekt tjetër të talentit të tij. Në fabul ai ndihet mirë, komod, zotëron me mjeshtëri teknikën e saj, madje shumë fabula të mbeten në mendje për mprehtësinë e gjykimit dhe moralin e shëndoshë.

Vëllimi poetik "Qesh e qaj me lot" dëshmon se ky poet gjithnjë e më tepër po e rrit peshën e krijimtarisë së vet, ai po bëhet më aktiv në kapjen e temave të mprehta politike, sociologjike, duke ia nënshtruar ato një gjykimi filozofik më të thellë. I dhënë pas poezisë lirike, e më së shumti asaj satirike, ai shfaq interes dhe motivim krijues edhe në fushën e tregimit, anekdotës dhe sentencës që e krijon vetë, por edhe e mbledh nga kontaktet që ka me njerëz të ndryshëm dhe nga leximet e literaturës artistike, historike, folklorike e sociologjike.

Vëllimi është një pasqyrë e gjerë e realitetit absurd shqiptar, i dëmtimeve që i kanë ardhur këtij realiteti nga elitat pushtetmbajtëse, të cilat të vëna në shënjestër të satirës së Bucit duken më lolo seç janë.

(Botohet me shkurtime. Shkrimin e plotë e lexoni në versionin online në faqen www.rrugaearberit.com)

Rruga e Arbërit nr. 154

histori

Për aftësitë e tij, Hafiz Xhemali u emërua Profesor në Universitetin Teologjik të Stambollit dhe anëtar i Gjykatës së Lartë.

Hafiz Xhemal Dibra, intelektual, teolog dhe patriot i shquar

Nga **ASTRIT DACI**

Në vitet e lavdishme të Lidhjes së Prizrenit, në mars të vitit 1881, lindi në Dibër të Madhe Hafiz Xhemal Mullai (Dibra), që me veprimtarinë e tij patriotike u rradhit ndër figurat e shquara të Dibrës dhe të Shqipërisë. Ishte bir i një familje të mesme qytetare, i jati Haxhi Shaqiri, sikundër gjyshi dhe stërgjyshi i tij kishin qenë hoxhallarë.

Ai ishte një fëmijë trim dhe i zgjuar, në moshë fare të re kreu hafizllëkun, që me mbarimin e shkollës fillore. Më tej vazhdoi edhe shkollën e mesme fetare në gjuhën turke. Gjatë kësaj kohe, ai u njoh me patriotë të shquar, siç ishte Ismail Pashë Saraçi, i cili duke çmuar inteligjencën dhe karakterin e tij e mori me vete në Stamboll (viti 1900) dhe e ndihmoi të kryente studimet e larta në teologji dhe më vonë në drejtësi.

Për aftësitë e tij, Hafiz Xhemali u emërua Profesor në Universitetin Teologjik të Stambollit dhe anëtar i Gjykatës së Lartë. Në Stamboll, në kryeqytetin e Perandorisë Osmane, që ka hyrë edhe në kryeqytetin e veprimtarisë patriotike të shqiptarëve, ai u njoh me veprën e Pashko Vasës, vëllezërve Frashëri, Hoxha Tahsinit, Ibrahim Temos, Jani Vretos, Hasan Prishtinës, Dervish Himës, Faik Konicës e shumë e shumë patriotëve të tjerë që ia kushtuan jetën dhe pasurinë e tyre çështjes kombëtare shqipare.

Në Stamboll, në ilegalitet, Hafiz Xhemali mësoi të shkruajë gjuhën shqipe me alfabetin e Stambollit. Me shpalljen e lirisë që premtuan xhonturqit, veprimtaria e tij u gjallërua më tej.

Në shumë qytete shqiptare, në Manastir, Shkup, Elbasan, etj., ashtu edhe në Stamboll, u formuan shoqëritë "Bashkimi" (1908), rreth të cilave u bashkuan patriotët shqiptarë, të cilët, duke ndjerë rrezikun që i vinte Shqipërisë nga shembja e pashmangshme e Perandorisë Osmane, shtrënguan fort rradhët dhe u përpoqën të ndriçojnë mendjen dhe zemrat e shqiptarëve, për t'i bërë ata të ndërgjegjshëm për synimet e armiqve të Shqipërisë dhe për përgjegjësinë e secilit ndaj Atdheut.

Më në fund, pas shumë përpjekjesh, në Manastir u miratua alfabeti i gjuhës shqipe, filluan nga botimi gazeta, revista, libra shkollorë dhe u hapën mjaft shkolla në gjuhën shqipe. Shoqëria "Bashkimi" e Stambollit, që në themelimin e saj miratoi statutin e shoqatës me 22 nyje (nene). Në nyjën 1 thuhet : Shoqëria "Bashkimi" e krijuar në Stamboll ka qëllim përhapjen e gjuhës shqipe ndërmjet shqiptarëve të Turqisë.

Shoqata do të drejtohet me kanunin e saj dhe kurdoherë do të përpiqet për forcimin e lidhjeve të shqiptarëve të Turqisë me Atdheun.

Të 200 aktivistët e shoqatës "Bashkimi", të mbledhur në klubin e tyre në Stamboll, me votim të fshehtë zgjodhën pleqësinë, e cila, nga ana e saj, zgjodhi Hafiz Xhemalun kryetar dhe At Jul Bonatin nënkryetar.

Për këtë periudhë Hafiz Xhemali tregonte: *"Pasi mbaroja punën zyrtare në gjykatë apo mësimdhënjen në Universitet, shpesh pa ngrënë fare, shkonim shtëpi në shtëpi të shqiptarëve në Stamboll dhe në fshatrat ppër rreth për të mbledhur ndihma për Shqipërinë. Kjo qe një punë raskapitëse, dhe jo rrallë në shtëpi përfundonim pas mesit të natës"*.

Komisioni u ndodh shpesh në pozita të vështira dhe thellësisht i prekur nga ndjenjat e bujarisë e të solidaritetit vëllazëror të shumicës së shqiptarëve. Ndihmat e mbledhura dërgoheshin në Shqipëri për paisjen e kryengritësve shqiptarë me armë dhe sende



të tjera të nevojshme, duke dhënë kështu një kontribut me vlerë për realizimin e pavarësisë më 28 nëntor 1912.

Më 28 nëntor 1912, Hafiz Xhemali dhe Patër Bonati, hoxha dhe prifti, të përqafuar kryetari dhe nënkryetari i shoqatës ngritën flamurin kombëtar në ballkonin e klubit, në mes të Stambollit. Atë ditë, fëmijët e shqiptarëve të Stambollit të veshur me uniforma kuq e zi mbushnin tramvajet e Perandorisë.

Por, pavarësia e Shqipërisë, për të cilën ishin bërë aq sakrifica e ishin derdhur lumenj gjaku, nuk zgjati shumë. Ajo i nxiti edhe më shumë fqinjët grabitqarë, që, pasi krijuan trazira, u sulën si hijena mbi Shqipërinë e sapolindur e që kërkonte të ngrihej në këmbë, për t'a shqyer përfundimisht. Luftërat Ballkanike u pasuan nga Lufta Botërore, mjerimet dhe vuajtjet e shqiptarëve ishin të jashtëzakonëshme. Zija ishte pllakosur në çdo vatër shqiptare. E gjithë hapësira shqiptare ishte pushtuar, e çdo pushtues, veçanërisht sllavët dhe grekët, po ushtronin një terror të paparë mbi çdo gjë shqiptare, një gjenocid i vërtetë, në zbatim të programeve famëkeqe të pansllavizmit e megallidhesë.

Me që fqinjët tanë u ndodhën në anën e fituesve, kërkonin shpërblim e shpërblimi duhej të jepej në kurriz të Shqipërisë. Fatet e Shqipërisë dhe këtë herë ishin në rrezik. Prandaj periudha 1918 dhe sidomos 1919, për shoqatën "Bashkimi' ka qenë shumë intensive.

Përveç ndihmave që i shkonin Shqipërisë të mbledhura me shumë vështirësi nga një popullatë e varfëruar, shoqata caktoi dhe ndihmoi financiarisht edhe delegacionin shqiptar që shkoi në Paris për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë. Financuesi kryesor i delegacionit tonë si dhe i ndihmave të dërguara në Shqipëri ishte Fuat Bej Dibra, i biri i Ismail Pashë Saraçit, organizatorit dhe kryetarit të Kongresit të Dibrës më 1909.

Shoqata "Bashkimi" dhe një kontribut të madh në organizimin e Kongresit historik të Lushnjes, ku kolonia dërgoi delegatët e saj, ndërmjet të cilëve qenë Sulejman Delvina dhe Fuat Dibra.

Në vitin 1923, me ringjalljen e Turqisë, filloi dhe rigjallërimi i aktiviteteve shqiptare. Kështu, shoqata "Bashkimi" filloi të botojë një gazetë të përjavshme të quatur "Paqja". Nr. 1 i kësaj gazete daton 12 nëntor 1923, me drejtor përgjegjës z. Hafiz Xhemalin (në origjinal Xhemal Dibra) dhe redaktor përgjegjës z. Nastas Frashëri.

Kryeartikulli thekson se gazeta nuk është politike... dhe se kurdoherë do përpiqet për mbarëvajtjen e miqësisë ndërmjet popullit turk dhe shqiptar që banojnë në Turqi, do të mbrojë interesat e shqiptarëve në Turqi, do të punojë për zgjimin e popullit shqiptar, zbukurimin dhe ndriçimin e mendjes së shqiptarëve me shkrime arsimore, shkencore, letrare, enciklopedike për me ju dhanë shqiptarëve të Turqisë lajme nga Shqipëria, nga bota si dhe nga bursa e nga tregëtia.

Në një artikull redaksional, ku ndjehet stili i Hazizit me titull "Armëpushimi dhe Shqipëria" bëhet një historik i shkurtër i gjendjes politike në Shqipëri në vitet e vrullshme 1920-1923 dhe shkrimi mbyllet me këtë thirrje: *"Shumë shpejt Kuvendi Kushtetues do të mblidhet dhe çështja e qeverisjes do të marrë fund ashtu siç e mendon shpirti shqiptar dhe koha e sotme, prandaj shqiptarët duhet t'i çmojnë njerëzit nga punët dhe jo nga fjalët, sepse kemi nevojë për njerëz të punës, që kanë punuar e dinë të punojnë. Perëndia qoftë ndihmës për të gjithë ata që përpiqen për lumturinë e Atdheut"*.

Rubrika tepër të ndjera janë ato që flasin për gjendjen e shqiptarëve të Greqisë dhe të Kosovës. Aty jepen fakte rrënqethëse se ç'farë krimesh kryejnë bandat e kriminelëve të liruar nga burgjet greko-serbe mbi kurrizin e shqiptarëve, që t'i detyrojnë ata të braktisin vatrat e tyre stërgjyshore dhe të shpërngulen në Turqi, si shkëmbim me grekët e Anadollit, në një kohë që qeveria greke betohej në Lidhjen e Kombeve se shqiptarët nuk do t'i përfshinte në shkëmbim.

Në një artikull "Fati i shqiptarëve të Kosovës', jepet një skenë në parlamentin serb të asaj kohe. Deputeti shqiptar Ahmeti, midis të tjerash shtonte: *"Në Serbinë jugore nuk ka fare siguri, vrasësit enden të lirë, shqiptarëve u mungon e drejta për të jetuar, ju merret gjaja, toka, buka e këto ju dhurohen serbve, varfëria sundon ndër shqiptarë që vdesin urie, ndonëse janë nënshtetas serbë... a duhet t'i vijë keq dikujt për këta njerëz?"*

Reagimi ishte i ashpër : Jeni tradhëtarë u dëgjua një zë : Largohuni sa më parë nga Serbia ose do t'ju zhdukim – u përgjigj një zë tjetër.

Por koha tregoi, madje shekuj se shqiptari nuk zhduket kollaj. Redaksia e gazetës "Paqja" ndiqte me kujdes edhe shtypin e kohës që botohej në Shqipëri dhe reagonte ndaj shkrimeve me frymë antishqiptare. I tillë ishte një artikull replikues ndaj një shkrimi të një shqipatri me emrin Vasil Kondi në një gazetë në Korçë, që merr në mbrojtje bëmat e grekëve ndaj shqiptarëve që pretendonin se grekët iishin marrë vesh me sebbët për ndarjen e Shqipërisë, por vetë shqiptarët janë fajtorë për ato që pësuan.

Më 4 janar 1924 u bënë zgjedhjet poër kryesinë e re të shoqatës "Bashkimi" ku u dha llogari nga kryetari i deriatëhershëm Hafiz Xhemali për aktivitetin e kryer dhe gjendjen ekonomike të shoqërisë, raport i cili u pëlqye dhe u miratua.

Pasi mbaruan zgjedhjet, kryetari i pleqësisë së kaluar, me një fjalë të shkurtër me rastin që shkon në Shqipëri, ku u zgjodh Asamblist në Parlamentin Shqiptar, i zgjedhur në qytetin e tij të lindjes Dibër, falënderoi të gjithë anëtarët për përkrahjen që pati pleqësia e kryesia prej tij (kryetar i së cilës qëndroi 15 vjet rrjesht), uroi pleqësinë e re të dalë faqebardhë dhe shtoi : *" Vërtet trupi im largohet nga kjo koloni ku linda dhe u rrita si shqiptar , si patriot..."*

Në kohën kur Hafiz Xhemali bënte këtë përshëndetje, administrata e qeverisë turke, e pa çliruar ende nga mentalitetet e vjetra antishqiptare, kishte nxjerrë një urdhër për deklarimin e Hafiz Xhemal Mullait person i padëshirueshëm për aktivitetin e tij patriotik në favor të Atdheut, të Shqipërisë, por atë tashmë e priste Atdheu i tij, për të cilin, deri në këtë moment kishte punuar pa u lodhur.

Fillimi i vitit 1924, Hafiz Xhemalin e gjen në Shqipëri, deputet të Dibrës në Kuvendin Kushtetues, propozuar nga shqiptarët e Turqisë, në një kohë kur gjendja politike e vendit ishte shumë e acaruar. Veprimtaria e Hafiz Xhemalit në Parlament i përmbahet plotësisht formulës së betimit të bërë prej tij si deputet, si dhe parimeve të shenjta të Kuranit të madhnueshëm, të cilave ai u është përmbajtur gjithë jetën e tij, e jo vetëm në politikë, por kudo, kurdo e ndaj kujtdo. Ai, si predikator i porosive të Kuranit, zbatonte me rigorozitet parimin se: *"Ai që nuk i zbaton vetë mësimet e Kuranit, nuk ka të drejtë morale t'i predikojë ato për të tjerët."*

Në diskutimet e tij, ndjehet thellësisht ndjenja e dashurisë për Atdheun dhe Kombin, e humanizmit, e drejtësisë e përgjegjësisë së lartë ndaj detyrës, e tolerancës fetare dhe politike, e guximit qytetar, e dashurisë së madhe për dijen e kulturën, e etikës qytetare, e ndershmërisë dhe pastërtisë morale, duke kryer kështu me nder detyrat e larta që i qenë besuar. Hafizi, si kryetar i Komisionit të Drejtësisë në Parlament, dha një ndihmesë të shquar në hartimin e ligjeve themelore të shtetit shqiptar, që dhe sot, pas gati 90 viteve, spikasin për vlerat që mbartin.

Ndër këta ligje qe ai për ndëshkimin e fajeve si: propoganda kundër kombit dhe indipendencës shqiptare, përzjerja e fesë kundër politikës kombëtare e që sjell armiqësi dhe ftohtësi midis elementëve dhe feve të njohura në Republikën Shqiptare, propoganda antikombëtare jashtë Shqipërisë që bashkëpunon dhe merr të holla nga shtete të hueja, pjesëmarrja në komitete antikombëtare, ata që sjellin e shpërndajnë literaturë antikombëtare, etj. , e që si thotë Hafiz Xhemali: *"Këto gjana na kanë damtue mjaft në të kaluemen, prandaj duhet t'u presim rrugën."*

Kur në Parlament po diskutohej për të drejtat e minoriteteve, Hafizi vëren: *"Më vjen shumë keq për zotërinjtë M.K. dhe D.S. (deputetë të minoritetit), të cilët, kur asht bisedue disa herë çështja e shqiptarëve në Greqi, nuk kanë fol asnjë gjysëm fjale. Sot, për grekofonët kërkojnë me insistim të jepen të drejta sa nuk u asht dhanë në asnjë shtet. Fqinjët tanë as më të voglën të drejtë nuk u kanë dhanë bashkëatdhetarëve tanë, e këta zotërinj për këtë s'kanë thanë gja ndonjëherë. Pra shfaq hidhërimin dhe kërkoj të shënohet në proçes verbal, se sa liri kanë në Parlamentin tonë deputetët të flasin për pakicat jo shqiptare, kurse në shtetet fqinje as që munt të zihet emri i tyre në gojë."*

Gjatë diskutimit të ligjeve për dënimin e familjeve të të arratisurve, Hafizi me ndjenjë të admirueshme drejtësie dhe humanizmi thotë: *"Po na paraqitet një projekt ligj mbi internimin e fëmijëve e konfiskimin e pasurisë së t'arratisunve. Kodi penal duhet t'i kërkojë kriminelëve të japin llogari për fajet që kanë ba dhe jo të dënojë të tjerët për fajin e tyne"*... Më tej, gjatë debatit me një koleg i thotë: *"Jemi në shekullin e XX-të, e bota e qytetnueme gratë i nderon tue ju dhanë të drejtë vote e i zgjedhin deputete dhe ne i internojmë."*

(vijon në numrin e ardhshëm)

Vetëm në Dibër mund të mësoni mbi historinë e Skënderbeut...

Përse u harrua Dibra *në këtë përvjetor të vdekjes së Skënderbeut?!*

Nga **AHMET ÇAUSHI**

Kanë kaluar mbi 500 vjet qëkur Skënderbeu nisi jetën, kurorëzoi lavdi, qëkur detyroi të ktheheshin të mundur dy sulltanët më të fuqishëm të perandorisë më të madhe të kohës, perandorisë Osmane. Në këtë 550 vjetor të vdekjes së tij duheshin kujtuar e plotësuar studimet në vendin ku lindi, ku arriti fitore të pakrahasuara në botë për të çliruar e mbrojtur trojet Shqiptare. Nga skeptikët e kësaj historie si dhe nga shërbyesit e të huajve që me siguri janë mbjellje e huaj në tokat Shqiptare janë shkruar shkrime me qëllim për të zvogëluar ose mohuar luftën e heroit tonë kombëtar. "Skënderbeu ka qenë kaçak", "Skënderbeu lindi me datë 6 maj", "Skënderbeun mund ta kenë mbytur mushkonjat" e të tjera shkrime që mohojnë luftën e Skënderbeut.

Si mund të jetë kaçak një udhëheqës që komandoi të gjithë popullin shqiptar dhe mundi dhjetra mijëra forca ushtarake të perandorisë më të madhe të kohës, asaj Osmane, një person që bashkoi të gjitha principatat Shqipëtare.

Jo, Skënderbeu nuk vdiq nga mushkonjat si Aleksandri i Maqedonisë. Ai vdiq i nderuar dhe i respektuar nga populli i tij dhe nga e gjithë bota.

Jo, Skënderbeu nuk ka datëlindje të njohur. Gënjehet. Po të fillosh jetën e heroit me gënjeshtra e tërë lufta e tij vihet në pikëpyetje. Ai nuk ka lindur më 6 maj. Me 6 maj ka lindur Gjergji i Kapadokias, i cili për besnikëri ndaj Jezusit u kryqëzua nga perandoria Romake. Më vonë Vatikani i ka dhënë titullin "shenjt", pra Shën Gjergji i Kapadokias, i cili jetoi 1200 vjet para Skënderbeut. 6 maj nuk është ditëlindja e Skënderbeut. Heroi ynë nuk ka datëlindje të njohur, nuk është "shenjt" i asnjë feje. Gjergji ynë ka jetuar 1200 vjet pas Shën Gjergjit të krishterë.

Skënderbeu nuk luftoi për fe. Ai luftoi për Atdhe, për Shqipërinë, vinte nga një familje ortodokse Shqiptare. Në moshën e rinisë e mori peng sulltani dhe e dërgoi në Stamboll. E arsimoi në medrese. Gjergji Shqiptar kishte trup të bëshëm, të gjatë, të shkathët dhe të fortë. Ai kishte një zgjuarsi të lakmueshme. Në medresetë e Topkapisë, ai u dallua si më i miri nga të gjithë dhe u vlerësua nga sulltani. Mësoi shumë shpejtë disa gjuhë: turqisht, arabisht, persisht, italisht, sllavisht etj. Kur ishte në shkollë dhe pasi mësoi Kuranin u bë musliman dhe ndryshoi emrin nga Gjergj në Skënder dhe thirrej Skënder Kastrioti. Pasi mbaroi medresenë sulltani e zgjodhi me më të mirët dhe e futi në shkollën që quhej "Enderun", në të cilën përgatiteshin kuadrot më të larta për udhëheqjen e perandorisë, gjithashtu aty mësonin dhe artin ushtarak e Skënder Kastrioti ishte ndër më të shkëlqyerit. Kur vdiq Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut, sulltani e dërgoi Skënderin në Dibër dhe i dha gradën Bej e u quajt Skënderbej.

Çudirat për të thurur historinë e Skënderbeut shkojnë shumë larg. Këta studiues kanë kërkuar dëshmi për heroin tonë kombëtar në Vatikan, në Venedik, në Beograd, në Athinë, në Austri, në Francë, në Amerikë etj., ku Skënderbeu nuk ka jetuar asnjë ditë. Atje shkojnë për dy arsye: Për të gjetur shkrime për Skënderbeun dhe atje shkohet me fonde të konsideruara. Këta studiues duhet të veçojnë shkrimet e njëanëshme për interesat e këtyre vendeve, por nuk ndodh gjithnjë kështu. Këto shtrembërime herë-herë cënojnë historinë e heroit tonë kombëtar.

Dy vendet më të domosdoshme për të mësuar origjinën e Kastriotëve, bëmat e Kastriotëve dhe të Skënderbeut janë Shqipëria me qendër studimi Dibrën dhe Turqia për kohën që Skënderbeu ka jetuar në atë vend, kryesisht Stambolli. Kristo Frashëri, disa vite qëndroi në Dibër për ta mësuar mirë historinë e Kastriotëve dhe atë që mësoi në Dibër e shkruajti në dy libra për Dibrën. Ai vizitoi Kastriotin, vizitoi Çidhnën por edhe vende të tjera betejash dhe banimi. Edhe akademiku Pëllumb Xhufi ka



Foto © B.Karoshi

vizituar Dibrën për këtë problem. Nuk thuret historia e një populli edhe nga akademik që vijnë në Dibër për të marrë ndojnë votë ose për të ngrënë mish qengji meqë prodhimet e Dibrës janë më të shijshme se të çdo vendi tjetër. Këta "studiues" e mbushin historinë me të pavërteta e e quajnë të rëndësishme të gjejnë pas 500 vjetësh ditën e lindjes të Skënderbeut.

Kastriotët kanë jetuar në Kastriot edhe para se të vijnë turqit, edhe para se të vijnë serbët e Stefan Dushanit. Mes për mes Dibrës nga jugu në very kalon lumi i Drinit. Ai më shumë i lidh dy anët e Dibrës sesa i ndan e është pjesë e jetës së dibranëve në kohë paqeje por edhe në kohë lufte. Krahina Dibrane e Çidhnës (Kidhna - i thotë Barleti)është ndër më të përmendurat në historinë e Dibrës. Dibranët kanë pasur prona në të dy anët e lumit Drin. Në stinën e verës këta dibranë punonin e jetonin në krahun e djathtë të Drinit, punonin tokat kurse në dimër kalonin në krahun e majtë të Drinit. Të njëjtën gjë bënin edhe kur ishin në luftë. Kur sulmoheshin nga sllavët kalonin në krahun e majtë të lumit Drin, organizoheshin dhe mbroheshin nga sllavët. Kur sulmoheshin nga latinët kalonin në anën e djathtë të Drinin e bënin të njëjtën qëndresë si me sllavët. Edhe sot, pas 500 vjetësh nga ajo kohë shumë dibranë kanë prona edhe në të djathtë edhe në të majtë të Drinit. Përmendim disa: Kaloshët, Koltrakët, Nokët, Përnezhët, Dertet, Spatët, Buci, Alijet etj., kanë toka, zabele dhe bjeshkë në të dy anët e lumit Drin. Edhe Kastriotët atëhere kishin prona në Kastriot dhe në Sinë e që të dy fshatrat janë banim i Kastriotëve. Kjo krijoi mundësinë që kronistët të shënojnë Sinën si vendbanim të Kastriotëve. Fshati i Kastriotit ka të dhëna të shumta dhe të gjalla që vërtetojnë vendbanimin e Kastriotëve: Emri i fshatit, kalaja e Gjonit, troja Gjonit, pusi i Gjonit, përroji i Kastriotit, fusha e Kastriotit,

Skënderbeu nuk luftoi për fe. Ai luftoi për Atdhe, për Shqipërinë, vinte nga një familje ortodokse shqiptare. Në moshën e rinisë e mori peng sulltani dhe e dërgoi në Stamboll. E arsimoi në medrese. Gjergji shqiptar kishte trup të bëshëm, të gjatë, të shkathët dhe të fortë. Ai kishte një zgjuarsi të lakmueshme. Në medresetë e Topkapisë, ai u dallua si më i miri nga të gjithë dhe u vlerësua nga sulltani.

guri i Skënderbeut, fshati Kukaj-vendbanim i 5 heronjëve të kohës së Skënderbeut: Pal Kukaj, Gjergj Kukaj e njëri prej tyre u rrop për së gjalli prej turqve. Kastriotët, gjithmonë kanë qenë luftëtarë të përmendur. Car Stefan Dushani i serbëve u mundua ti zhdukë edhe fshatin edhe Kastriotët. Këtë punë bënë edhe turqit. Kastriotët janë shpërngulur për ti shpëtuar zhdukjes.

Mungesa e të shkruarit të gjuhës së tyre nga vendasit veniti të kaluarën heroike të Kastriotëve. Populli i ruajti këto kujtime. Para disa vitesh në odat dibrane kjo histori tregohej dhe iu pasua brezave. i imponuan popullit tonë ndryshimin e emrave për njerëz, për fusha dhe male, për kodra dhe përrej, na imponuan edhe ndryshimin e emrave të fshatrave. Me shumë forcë këtë e bënë serbët. Emri Kastriot përmendet edhe para shekullit të dymbedhjettë. Ndoshta serbët e hoqën këtë emër. Kastriotët lindën dhe jetuan në Dibër dhe luftuan për Dibrën, por edhe mund të kenë lëvizur nëpër vende të tjera. Djali i Skënderbeut u detyrua të emigrojë në Itali. A thua edhe Skënderbeu ka qenë italian, apo matjan, krutan, venedikas etj.? Kur vdiq Gjoni, Skënderbeu u dërgua në Dibër, sepse kështu i kishte premtuar sulltani Gjonit. Erdhi në Dibër me emrin Skënder. Kur u emërua në krye të Sanxhakut të Dibrës iu dha grada Bej e që atëherë e deri sa vdiq ai u thirr Skënderbeu. Kështu e thirrën shqipëtarët, kështu iu drejtuan turqit, venedikasit, italianët, por edhe të tjerët. Skënderbeu kurrë nuk e braktisi këtë emër muslimani. Kurrë nuk iu kthye emrit të mëparshëm "Gjergj".

Beteja midis ushtrisë europiane, që komandohej nga Hunjadi, me turqit ka qenë ndër më të ashprat. Skënderbeu u thirr nga sulltani për të qenë pjesë e turqve. Ai shfrytëzoi rastin për të realizuar planin e tij për çlirimin e atdheut. Skënderbeun e shoqëronin Dibranët. Ai nuk i bashkoi forcat e veta as me turqit as me koalicionin e të krishterëve të Hunjadit. Që këtu duket qartë se Skënderbeu nuk do të luftonte për fe. Skënderbeu mori fermanin për sanxhakbeun e Krujës dhe me dibranët që e shoqëronin u kthye përsëri në vendin e të parëve të tij, në Dibër. Me dibranët u nis për në Krujë, e rrethoi atë, i dorëzoi fermanin mëkëmbësit të sulltanit, i cili u largua nga Kruja.

Gjoni i dorëzoi sulltanit të katër djemtë e tij: Stanishin, Raposhin, Konstandinin dhe Gjergjin. Thuhet se Gjoni dhe tre djemtë e tij, duke veçuar Konstandinin pranuan fenë Islame. Gjergji kishte trup të gjatë e të mbushur, ishte i shkathët si askush tjetër dhe tregonte një zgjuarsi të rrallë. Sulltani shihte tek Gjergji një luftëtarë besnik të Perandorisë, prandaj e mbajti në Topkapi, qendër kryesore e Sulltanatit. Gjergji dallonte nga të gjithë për vecoritë intelektuale e shëndetësore, prandaj e rregjistruan në shkollë, në medrese. Mësoi në këto shkolla të lexonte e të shkruante në gjuhën turke, arabe, perse, por edhe gjuhë të Europës si italisht, sllavisht etj. Në përvetësimin e artit ushtarak të kohës ai ishte më i miri. Mësimi i fesë Islame ishte detyrë në të gjitha shkollat edhe për jeniçerët, ndërsa pranimi i fesë Islame nuk ishte domosdoshmëri. Në rradhët e ushtrisë turke kishte me shumicë jeniçerë të krishterë e të feve të tjera. Gjergji me dëshirë pranoi fenë Islame dhe zgjodhi emrin Skënder. Këtë emër e kish pasur një udhëheqës shumë popullor e i dashur për popullin e tij, që thirrej edhe me emrin Dhul Karnejn, por emri i parë i tij ishte Skënder. Historinë e tij e mësoi në medresenë e Stambollit. Gjergjit i pëlqeu ky udhëheqës popullor. Pas vdekjes së Gjonit sulltani e dërgoi Skënderin në Dibër me këtë emër. Ai e emëroi Bej të sanxhakut të Dibrës. Që këtu u thirr Skënderbej. Fjala Bej është gradë ushtarake e sulltanatit. Skënderbeu me këtë emër bashkoi popullin në luftë kundër pushtuesve turq. Me këtë emër mundi dy sulltanët më të fuqishëm të turqve osmanë. Me këtë emër fitoi 18 beteja të zhvilluara në Dibër midis turqve pushtues dhe shqiptarëve. Me këtë emër fitoi gjithsej 26 beteja kundër turqve, venedikasve dhe të tjerë. Me këtë emër shkoi i respektuar prej populli të tij dhe tërë popujve në varr. Me këtë emër bashkoi popullin shqiptar pa dallim besimi fetar. Populli ynë gjatë gjithë jetës së tij dhe sidomos gjatë rilindjes dhe luftës për pavarësi, gjatë gjithë kohës këtë emër, Skënderbej, vendosi në udhëheqje në luftërat për pavarësi dhe liri.

Në Dibër do të mësoni historinë e Skënderbeut, sepse në të gjitha kuvendet e Dibrës është transmetuar brez pas brezi. Në Dibër do të shihni fshatin e Kastriotit, ku janë edhe sot mbetjet e kalasë së Gjonit, pusi i Gjonit, troja e Gjonit, përroi i Kastriotit, fusha e Kastriotit, emra tokash, kodrash, fushash e të tjera me emrat e Kastriotëve si në asnjë vend tjetër. Kastriotët përmenden në Dibër edhe para ardhjes së serbve të Stefan Dushanit, 200 vjet para Skënderbeut. Në Dibër do të gjeni edhe Kanunin e Skënderbeut dhe në këtë kanun do të veconi edhe disa qëndrime të Skënderbeut për ndryshim të kanunit të Lekës me zgjidhje nga feja Islame. Në Dibër do të gjeni Hasin që përmend Marin Barleti, bile disa Has. Emri Has vjen nga fjala arabe "Hasa" që ka kuptimin e një cope toke bujqësore që thiret gurishte e që shtrihet afër lumenjve ose rrëzë kodrave. Hasi i Çidhnës ndodhet disa qindra metra në të djathtë të Drinit të zi. Më i përafërmi Has është në Çidhën të Dibrës, disa dhjetëra metra në të djathtë të Drinit. Në Dibër do të shihni fushën e Torviollit, e cila shtrihet pasi Radika merr kthesën drejt veriut dhe vazhdon të zbresë drejt fushës së Kastriotit dhe Ferrës së Pashës. Në Dibër do të shihni 18 vendet e betejave, do të vëreni luginat e veshura me pyje nga niseshin dibranët kundër pushtuesve. Në Dibër do të habiteni me fshatin e Çidhnës ku sulltan Mehmeti i dytë vrau 8000 dibranë: pleq, gra, fëmijë e të sëmurë ku ishin strehuar në kohën e rrethimit të tretë të Krujës.

Përse pushtuesit kërkuan të shfarosin Dibrën? Përse u zhvilluan 18 beteja, nga 26 gjithsej, në Dibër? Përse sulltan Mehmeti i dytë u nis për Turqi e në Elbasan mori kthesën për të ardhur në Dibër. Kaloi nëpër Mat dhe arriti në Dibër për ta zhbë popullin e Dibrës? Përse nuk sulmoi një qytet tjetër? Përse nuk zhbiu një qytet tjetër në Elbasan, Mat, etj.? Përgjigja është se Dibra ishte vendi i Kastriotëve, se populli i Dibrës ishte bazë e fuqishme e përkrahjes së komandantit të vetë.

Skënderbej dibrani largoi nga Kruja pashain turk, ndërsa dibranët ruanin maleve të Krujës dhe rreth e qark Krujës.

(vijon në faqen 22)

Rruga e Arbërit nr. 154

tregim

Pranvera ishte në shpërthimin e saj të furishëm. Majëmaleve bora po shkrihej dhe kallëpet e bardhë rrokulliseshin rrëpirave. Kishte çelur gjethi i ri dhe pylli ngjante si i lyer me mjaltë.

Guri i Vashës

Nga **Arian KADIU**

1.

Kryekomandanti po kthehej nga Petraalba. Era loste me pelerinën e tij ngjyrë qielli, që i fërfëllonte pas shpatullave. Nga goja e atit bryms varej shkuma e bardhë, kurse kokrra djerse i rrokulliseshin nga qafa. Kishin dhjetë ditë që udhëtonin. Kishin vrapuar natën dhe ditën. Nga kalaja e Krujës në Albulenë, nga Arbulena në Modriç, në Stellush, në Petraalbë (Guri i Bardhë, ky toponim romak e nervozonte atë), e prej andej qenë nisur për në kalanë e Sllluçit, mbi qytetin e Varoshit, në Qafëmurrë. Kryekomandanti po kontrollonte kështjellat. Skënderbeu po përgatitej kundër këtij rrebeshi. Zbuluesit e nisur nga Edreneja, ndërronin kuajt rrugës dhe, kur arrinin, binin si të vdekur te portat e kështjellave Mezi pëshpëritnin: - Po vijnë...

Pas vrapimeve të shpejta me atllarë, kuvendeve të vogla,

ndalesës në qendrat e banuara, ku duhet të shuante edhe zënkat midis princave, teksa kontrollonte ushtrinë, vetmia dhe heshtja e maleve po i qetësonte kalorësit dhe vetë atë.

Tutje shquheshin pishat e larta dhe bredhat me kurorë.

Befas kryekomandanti qëndroi. Pas tij qëndruan të gjithë. Komandanti i gardës pretoriane iu afrua me të shpejtë. Balli i Skënderbegut ishte vrenjtur, sikur në shpirtin e tij të jehonin gjëmimet e betejave dhe furtunat e pyjeve.

Komandanti i gardës lëvizi kokën, gjersa shikimi i tij u ngul atje, ku tregonte dora e Skënderbegut.

- Në Varosh, më duket se ka ushtri armike. Mblidhuni! - thirri ai.

Kalorësit e qarkuan.

- Të mos na ikë Sllluçi nga duart, - tha.

- Të nisemi tre nga tre, nga të gjitha anët.

- Për Arbërinë! - u betuan burrat.

Skënderbegu tërhoqi me forcë frerin e atit, e shpoi me yzengji në bark dhe u nis me rrëmbim. Nga patkonjtë e kuajve përhapeshin shkëndija. Ata djem me trup të lidhur e të gjatë të gardës, vinin nga betejat.

Të nesërmen, kur u takuan në majën e Balgjajt, fytyrat e luftëtarëve ishin çelur. Në Varosh nuk kishte këmbë armiku.

- Sllluçi është yni! - tha ngadalë Skënderbegu. Sytë e tij vështruan një për një ushtarët e pluhurosur të gardës pretoriane. Vuri buzën në gaz. Gazi i tij shpërndante një dashuri të thellë vëllazërore.

Tutje, para, shtrihej Varoshi. Përbri qytetit, në verilindje, mbi shkëmbinjtë e pjerrët e të zhveshur, kalaja e Sllluçit ngrihej drejt qiellit si një grusht vigan.

2.

Pranvera ishte në shpërthimin e saj të furishëm. Majëmaleve bora po shkrihej dhe kallëpet e bardhë rrokulliseshin rrëpirave. Kishte çelur gjethi i ri dhe pylli ngjante si i lyer me mjaltë.

Lulashi po vinte midis hijeve në shtegun e pishnajës. Vajza kishte vënë enën e drunjtë në ujëvarë dhe ishte ulur nën gjelbërim. Ajo e pa, u ngrit në këmbë dhe u kthye drejt tij.

- Lulash! - nuk ishte fjalë, por psherëtimë, trazim ndjenjash. Ishte një thirrje e gëzueshme, por edhe e përmbajtur.

Ai po afrohej nga ujëvara e shkumëzuar dhe e ndali vështrimin mbi të, duke e shikuar kushedi për të satën herë, nga koka te këmbët. Ajo i kishte flokët e butë si mëndafsh i hollë, me reflekse transparente. Balli i saj i pastër sikur qe larë me qumësht delesh, ndërsa shtati i hajthëm dhe i drejtë.

Lulashi nuk fliste. Një ngulç i egër ia trazoi herë pas here gjoksin. Buzët e ashpra diçka donin të thonin, por heshti.

- Zai... - përveç këtyre tingujve nuk u dëgjua më asgjë. Duke e soditur vajzën, sytë e djalit u zbutën, tiparet e fytyrës iu mbushën dhe diçka e gëzuar iu drodh në shpirt. Qerpikët e saj ishin të gjatë si hala pishash, sytë i kishte të kthjellët. Lëkura e butë si lëmyshk, hunda pak me kurriz në harmoni me tiparet e tjera, buzët si petale zambaku, fytyra disi e gjatë, e gdhendur, me mollëzat pak të kërcyera, stolisur me kuqëlimin e butë të agimit.

- Ishe atje? - pyeti Zaimira.

- Nuk arrita te streha - tha Lulashi.

Te livadhi i Limoçës ishte një shkëmb i murrmë, me një strehë që dilte jashtë. Skënderbegu merrte në ushtri djemtë që arrinin me kokë strehën e gurit.

Sytë e vajzës u errën, e humbën shkëlqimin dhe djali uli kokën si të qe fajtor.

- Fola me një kapedan.

- Dhe..

- Kjo luftë s'është e para dhe as e fundit - më tha. - Armiqtë prapë do të na sulen dhe Arbërisë prapë do t'i duhen luftëtarë.

Djali shtrëngoi nofullat sikur po hante veten nga inati dhe heshti i mërzitur.

- Po armët? - e pyeti vajza me zë të ëmbël.

- Sot - tha djali me tiparet e prishura sikur të qe futur në një mugëtirë kaltëroshe.

Ai e vështroi me mall vajzën nga koka te këmbët dhe mori të ikë.

- Lulash!

Ai ndaloi çapin.

- Kur të falet yll i agimit, të pres te livadhi Limoçës.

- Zaimira!

Vajza nuk iu përgjigj. Lulashi u kthye të shkonte

- Për ku? - e pyeti ajo.

- Në pyll - dhe u nis. Ajo e ndoqi me sy. E dinte se në pyll djemtë vraponin, kapeshin për degësh, kacavirreshin e shtonin forcat e trupit për t'u bërë gati për luftë.

Ai po largohej bashkë me dhimbjen dhe dashurinë e tij. Kjo kishte ndodhur një vit më parë, kur kryekomandanti kishte urdhëruar të boshatisej qyteti. Kishin ikur gjithë burrat në mal me Skënderbegun. Rrebeshi armik po vërshonte.

Skënderbegu dhe ushtria kishin dalë në pyjet përreth, kurse djemtë e rinj si Lulashi vrojtonin. Në luftë shpatat kishin thyer eshtrat dhe eshtrat kishin thyer shpatat. Kur i thanë djalit se i qe vrarë i ati, ai ende ishte te kalaja për vrojtim.

Pas dy muajsh ata ishin kthyer në qytet. Lulashi ish bërë i heshtur dhe i vrenjtur. Në shpirt sikur i rridhnin rrëke të shurdhëta. Me kohë e pak nga pak në shpirtin e tij të zhuritur lëshoi lastarët delikat dashuria.

Ai zbuloi në vetvete përsëri ndjenjën e gëzimit dhe ky intimitet ishte si një vatër drite që e mbushte me ngrohtësi.

Lulashi ishte nisur drejt liqenit në thellësi të pyjeve. Skënderbegu kishte urdhëruar të mos priteshin pyjet në afërsi të qytetit. Në pyjet e dendura fshiheshin luftëtarët që stërviteshin ose prisnin të dëgjonin vikamën e bririt të sulmit.

3.

Varoshi e kishte filluar festën. Ndonëse ajo nuk qe fetare, ishte bërë tradicionale. Kur Skënderbegu merrte ushtarë, populli bënte festë. Festa u shtonte besimin njerëzve, se ata do t'i mposhtnin armiqtë.

Ajo ndihej në zhurmën e mbytur që vinte ngado dhe në rrëmujën që vihej re nga njeri cep i qytetit në tjetrin. Të gjithë përgatiteshin.

Grupe-grupe luftëtarët pastronin shpatat dhe zbukuronin dorezat. Gratë u sillnin kupa me musht dhe lëngu jetëdhënës i rrushit u ripërtërinte energjitë. Luftëtarët e sprovuar të gardës pretoriane stërvitnin ushtarët e rinj për krijimin e formacioneve të zhdërvjellëta të luftimit.

Lulashi kalonte menduar midis rrëmujës dhe i shikonte me zili ushtarët e rinj, që qenë radhitur nën flamurin e Arbërit e do të luftonin pranë kryekomandantit. Ishte nisur vetëm për te farkat e kovaçëve dhe ndjeu se nga Gropa ku punonin ata, vinte një fry-mëmarrje e thellë dhe e ethshme. Kacnijasit, që qenë kovaçë të Skënderbegut, kishin përveshur llërët dhe, duke lëvizur gjyrykët, flakëronin eshkën. Burrat thatimë e të zeshkët dhe me muskuj si bronz shkonin e vinin nëpër farka.

- Dua një shpatë - i tha ai burrit të parë që ndaloi pranë tij.

- Eja! - i tha kacnijasi dhe e shoqëroi gjer në një kthinë. Aty, shpatat qenë hedhur mbi njëra-tjetrën, kurse heshtat qenë ngulur në truall.

- Zgjidh e merr - foli burri dhe doli jashtë.

Metalet e skuqura e të rrahura me çekiç tani shkëlqenin. Lulashi ndjeu një ngazëllim të ri në zemër dhe bëri një hap para e zgjati dorën. Mori një shpatë. E pa. Mori një tjetër. Edhe një tjetër. Dhe zgjodhi atë që i pëlqeu më tepër: shpata ishte e shkurtër, e përkulur si sqep shqiponje e me dorezë prej fildishi.

Ngjeshi shpatën, u bashkua me trimat që stërviteshin dhe e kaloi me ta tërë ditën.

Ngadalë ra nata. Qyteti, si në ditë feste, u mbush me pishtarë. Ai ngjante si një konstelacion me yje të ulura poshtë, fare poshtë. Lulashi shikonte shkëlqimin e zjarreve të ndezura tutje, që dukej si ujë i kulluar që del nga burimi.

Ishte mbështjellur me pelerinë e mendonte: "Arbëria! Trojet tona! Çdo pëllëmbë e Arbërisë nxjerr burra, nxjerr luftëtarë! Sikur të qe e mundur të kishte sa shumë luftëtarë. Sikur ata të mbinin nga toka. Hej, sikur të ishte e mundur që në vend të grurit të mbilleshin luftëtarë, ne, luftëtarë do të kishim mbjellur. Atëherë njerëzit do të hanin frutat e trëndafilave të egër, kaçet. Ata do të pinin vesën e mëngjesit dhe do të njomnin gojën me stërkalat e ujëvarës. Gjithë ujin që kishte liqeni, puset, vijat e borës, pellgjet që formoheshin në dimër, do t'i ruanin për të vaditur tokat e mbjella me luftëtarë. Ah, sikur të mbilleshin luftëtarë! Jo për të zaptuar të tjerët, jo, por që hasmi të mos guxonte të vinte më këmbën në Arbëri. Prijësit e tyre do të pëlcisnin nga marazi e do t'u binte pika poshtë mureve të kalave... Për Arbëri, ata s'do të na mundnin dot!". Lulashin e mundonte brenga e tij dhe ofshani me mllef. "Si nuk u zgjata edhe ca. A s'është e mundur që dy vjet të shkojnë në një dhe unë të isha më i gjatë... Për Arbëri!"

Mjegullat mbi liqen po gjelbëronin. Ai u ngrit, mori pishtarin në dorë dhe u nis për te Livadhi i Limoçës. Duke ecur, veshi i kapi tingujt e një melodie. Boshllëkun përreth po e mbushte lahuta dhe zëri i Këngëtarit të Verbër. Kur arriti në vend, ai e dëgjoi këngën të plotë. Në atë instrument të vjetër kënga rridhte ngadalë, epike. Ajo tregonte e kujtonte luftërat plot sakrifica, pastaj kur tingujt dukej se shuheshin, lahuta dridhej në duart e lahutarit të verbër dhe telat binin fort e ngrinin lart një klithmë, një besatim, një vendim që s'kishte forcë që mund t'i bëhej pritë.

Sytë e atyre që këndojnë janë gjysmë të mbyllur. Këngëtari i Verbër i kishte të mbyllura përgjithmonë. Ai ishte plagosur në një betejë dhe kishte humbur ndjenjat. Kur ishte përmendur e kishte parë veten në fushë midis trupave të pa jetë. Ishte ngritur, e kishte lidhur vetë plagën dhe pati nisur të këndonte. Ai kish parë pranë vetes kalin dhe e kishte përkëdhelur. Edhe kali e kish njohur dhe pati hingëllirë. Një patrullë ushtarake e kishte dëgjuar edhe këngën e tij, edhe hingëllimën e kalit dhe i kishte zënë. Në kampin e tyre ia kishin nxjerrë sytë me hanxhar të skuqur. Ia kishin vrarë edhe kalin. Burri kishte prerë qimet e jeleve të kalit dhe më vonë me to kishte tendosur harkun e lahutës. Që atëherë ai i binte asaj pa pushim. U jepte zemër dhe ngrinte moralin e luftëtarëve, se kënga e tij ishte madhështore.

Lulashi u mbështet në trungun e fortë të një pishe dhe dëgjonte.

Lahuta binte. Pishtari, ngulur në tokën e butë, hidhte në fytyrën e plakut lloj-lloj ngjyrash. Mbi lahutë, tek bishti i drunjtë, ishte gdhendur një kokë dhie si ajo e përkrenares së Skënderbegut. Në dorën e djathtë kishte harkun e lahutës, me gishtat e trashë të dorës tjetër shtypte telat, ndërsa kokën e tij të madhe me krelat e flokëve të gjata e kishte afruar te koka e gdhendur. Jeleku i zbërthyer në gjoks, qëndisur me gajtan kuq e zi, i varej prapa si një shpend i stërmadh.

Lulashi e priste agimin pranë këngës. Agimi pa lyente me argjend gjethet e hardhive, të kërcejve si gjarpërinj uji mbështje-llur në plepa, gurët e bardhë, barin e rritur, kuajt që tundnin zilkat dhe luftëtarët që flinin me shpatat poshtë kokave të tyre. Djalin e kishte mbërthyer të tërin kënga dhe, për çudi, edhe brenda tij, midis trazimeve që i gëlonin ndjeu një këngë ripërtëritëse.

Një njeri me pishtar erdhi drejt melodisë dhe ndaloi dy hapa larg djalit. Lulashi e diktoi, ngriti kokën dhe kur e njohu, brofi menjëherë në këmbë. Zaimira shtrëngonte në dorë dy vegla të gjata hekuri. Ajo i zgjati njërën vegël dhe i tha:

- Nxirr ca shkrepa nga toka dhe afroi te Guri i Burrave!

Lulashit i regëtiu zemra dhe buza i qeshi. Deshi t'ia shprehte këtë vajzës, t'i thoshte një fjalë të mirë, ta vështronte në sy, mirëpo Zaimira u largua. Ajo po kalonte nën harqet me dredhëla, rrumbullak si kube, drejt qendrës së Limoçës plot me luledele.

Lulashi copëtoi një kreshtë. I mbështolli krepat me krahë dhe i afroi pranë Gurit të Burrave. Zaimira solli disa grushta me argjil të njomur dhe një plis të trashë këputur nga livadhi. Vajza i vuri gurët poshtë te këmbët, nën strehën që dilte jashtë dhe vuri sipër plisin e rëndë.

- Provoje strehën, – tha ajo.

Lulashi u drejtua për te shkëmbi i murrmë me një ndjenjë ngazëllimi. Zemra i rrahu fort. "A do ta arrij?" Ai hipi. Koka preku strehën e shkëmbit.

- Hej! - thirri - E preka.

Sytë e tij u ndezën. Vajza kishte hapur gojën dhe buzët si petla i dukeshin shumë të njoma, sikur prej tyre të buronte freskia. Ai zgjati krahët drejt saj dhe vajza iu hodh në qafë. Djali ishte i lumtur. Po ashtu edhe vajza. Ata ishin të lumtur.

Lulashi e Zaimira notonin në një det që herë dallgëzonte e herë shushurinte. Zemra u buçiste në kraharor. Qielli po kthjellohej dhe mali po ndriste nga dielli në lindje. Ujëvarat i spërkatnin me një pluhur të lagët dhe të artë. Bar i njomë e i butë i dehte me aromën e lule kupëzave.

4.

Populli kishte vërshuar në rrugë. Tingëllima e xhingrave dhe tum-tumet e kudumeve(kudume – një lloj darabuku) dridheshin në ajrin e elektrizuar nga thirrjet, që përhapeshin në largësi e shu-mëfishoheshin në lugina. Turma dyndej, përplasej, zgjaste kokën, duart, thërriste, qeshte, fshinte lotët.

Mbi qafën e Dardhës qëndronte Skënderbegu i rrethuar nga garda pretoriane. Kryekomandanti hipur mbi atin bryms kishte një pamje hijerëndë. Ai buzëqeshte dhe fërkonte ngadalë me dorë mjekrën e gjatë. Para tij kalonte ushtria.

Kryekomandanti buzëqeshi. Ai pa duart e njerëzve që përshëndesnin dhe fëmijët e vegjël mbi krahët e nënave iu dukën si mirazhi i ushtrive të ardhshme. Po nuk ishte iluzion. Kjo ishte e vërtetë. "Për Arbëri- mendoi ai - ne nuk do të shuhemi!" - dhe buzëqeshi përsëri.

Ushtria kalonte me zhurmë.

Lulashi ecte midis shokëve, shikonte kryekomandantin dhe me zemër kërkonte Zaimirën. Kur befas e pa vajzën. Ai rendi drejt saj. Ajo rendi drejt tij.

- Lulash!

- Zaimira!

Dhe asgjë më tepër. Vajza nxori nga gjiri një shami dhe ia dha.

- Te Livadhi i Limoçës - tha ajo dhe vrapoi për atje.

Ai i mori erë shamisë. Pastaj e hapi. Në cohën e bardhë ishin qëndisur, në të dy anët, një shpatë dhe një zemër. Në mes ajo kishte portretin e një fëmije.

- Zaimira! – pëshpëriti ai dhe e kuptoi gjuhën e qëndismave në shaminë e dhuruar. Tutje, vajza ngjante me një statujë të bardhë dhe me mend e quajti Guri i Vashës.

Kur e tha edhe me zë shokët e dëgjuan dhe pyetën: Ku është ky vend? Ai ua tregoi me dorë Zaimirën.

Xhingrat e kudumeve u dëgjuan më fort. Ishte sinjali i qetësisë. Përqark ra heshtja. Skënderbegu u ngrit mbi yzengji, nxori shpatën nga milli dhe thirri:

- Për Arbëri!

Shpata e tij priste horizontet.

5.

Pas luftërash të përgjakshme, të huajt ikën drejt rrugës së kthimit. Edhe luftëtarët shqiptarë po ktheheshin në shtëpi. Në krye të karvanit ishin trupat e të vrarëve dhe të plagosurit rëndë.

Në qytetin e Varoshit,në bedenat e kalasë së Sllluçit dolën vajzat dhe nuset e reja, që pritnin të dashurit e zemrës. Nënat e të rinjve, fëmijët e të moshuarit kishin dalë më përpara, atje te Fusha e Bunarit, në hyrje të qytetit. U dëgjua topi,që lurasit i pa-tën ndërtuar Skënderbegut me dru dardhe.

Lulashi, së bashku me disa trima të rinj, dredhuan në anën perëndimore, andej ku ishte vendosur dybeku i kafesë për kalanë. Ata u ngjitën në bedena, ku prisnin vajzat dhe nuset e reja.

(vijon në faqen 22)

tregim nga Ramiz Gjini

Në ashensor

Kujdestari i pallatit, z. Martinez ndalon në korridor përballë ashensorit. Ai shtyp butonin dhe pret.

I duhet të zbresë në bodrum, të marrë veglat për të montuar një bravë dere.

Heq kapelen, prek me mollëzat e gishtave çaçkën e kokës, - ku aksidentalisht pati marrë një plagë, që tashmë sapo është mbyllur, - dhe bie në dilemë: ta kruajë, apo të mos e kruajë plagën?

Zoti Martinez do që ta kruajë, sepse… O zot, sa i kruhet! Mirëpo ai e di, që po e kruajti, plaga do malcohet e do hapet sërish, ndaj vendos të mos e kruajë.

Ashensori vjen që nga kati i nëntë dhe ndalon në të gjashtin ku pret z. Martinez.

Hapet dera.

Para tij shfaqet Frida Ofman hypur mbi vithet e saj krekcare. Nën qerpikët e gjatë kallp, shkëlqejnë një palë sy kunadheje. Një medaljon me fytyrën e përvuajtur të papës Vojtila, varur për qafe me një zinxhir floriri, ka ngecur shtrembët në deltën e gjinjve të saj bajagi të mëdhenj.

- Miremengjez, z. Martinez, - përshëndet Frida Ofman.

- Mirmëngjez, znj. Frida, - ia kthen ai. Dhe pyet: - Si është plaka Marie?

- Keq,- thotë Frida Ofman. - Shumë keq…

I shkëlqejnë sytë prej gëzimit, të cilin, as që përpiqet ta fshehë.

Frida Ofman sapo ka lënë turnin e saj të punës natën. Po zbret, që të marrë autobusin për tu kthyer në shtëpi. Ajo paguhet nga bashkia e New York-ut për t'i shërbyer plakës Maria Merkin, një ish soprano, që pati punuar në "Balshoi Teater" të Moskës. Prej dymbëdhjetë vjetësh, kjo ish artiste, shtyn e vetmuar ditët e saj të fundit në apartamentin 9B; dhe vuan nga sëmundja e harresës.

Dy ditë më parë, kur Marien e mori ambulanca për ta çuar në spital, kujdestari i pallatit, z. Martinez, pati një parandjenjë sikur po e shikonte për herë të fundit. Por nuk qe ashtu. Marien e mbajtën nja dy orë në spital dhe e kthyen sërish.

- Doktori ka thënë që Maries i ka vdekur truri, - nis të shpallë gjithë qejf kumte Frida Ofman. Vetëm zemra po e mban në jetë. Por edhe zemra do e lërë shpejt, nuk do i rrahë më shumë se një javë... Sa të vdesë Maria, unë mbartem që andej ku jam dhe futem në apartamentin e saj. Dhe ty, sigurisht, të jap hakun që të takon. Kështu e kemi bërë marrëveshjen. Apo jo, z. Martinez?

Z. Martinez përtypet. Heq kapelen, prek me mollëzat e gishtave të dorës plagën e sapombyllur në çaçkë të kokës dhe… O zot sa i kruhet! Por, zoti Martinez është durimtar i madh. Sërish vendos të mos e kruajë.

- Po, - thotë ai, teksa vendos kapelen në kokë, ngadalë e disi përtueshëm. - Kështu e kemi bërë marrëveshjen.

Ashensori ndalon në katin e tretë.

Hapet dera.

Para tyre shfaqet nëpunësi i postës, një zezak fort i ngjallmë, që kullon djersë teksa mban një pako të madhe në duar.

Z. Martinez, bën shenjë me gisht. I jep tjetrit të kuptojë që ashensori po zbret poshtë.

Nëpunësi i postës nëpërdhëmb një fjalë që nuk merret vesh. Gjithë përtesë, niset të ngjitë shkallët.

Dera mbyllet dhe ashensori vihet sërish në lëvizje.

- Më pëlqen kjo lagje, - thotë Frida Ofman. - Dhe pallati, gjithashtu, më pëlqen. Pastaj, sikur u mësova. U bënë pesë vjet që gati çdo ditë, hy e dal nga ai apartament. Më është bërë si banesa ime, prandaj e dua.

- Të shikojmë çfarë do na sjellë java tjetër, - thotë z. Martinez. - Dhe t'i qëndroni marrëveshjes, që kemi bërë, - paralajmëron ai.

- Ç'është ajo fjalë z. Martinez?! - bën çudi Frida Ofman, ndërsa shpupuris flokët me gishta. - Jam grua serioze unë. Pesëqind dollarë zëre se i ke në xhep.

Ashensori mbërrin në katin e parë.

Hapet dera.

Para tyre shfaqet e bija e plakës Marie. Thirret Galina dhe banon në Queens. Një bijë e përkorë, që rrezaton mirësi; me mëngët gjithmonë të përveshura, e gatshme t'ia hyjë çdo lloj pune që vlen. Në duar, ajo mban disa qese të mbushura plot me ushqime. Çdo të shtunë, vjen rregullisht të shikojë nënën e saj.

- Mirmëngjes! - përshëndet Galina.

- Mirmëngjes! - ia kthejnë përnjëherësh të dy.

- A fjeti mirë mbrëmë mamaja? - pyet ajo.

- Shumë mirë ka fjetur, - thotë Frida Ofman. – Vetëm se, ti e di… Shpesh të thërret në emër dhe nis e llafoset me ty përgjumësh.

- Si gjithmonë... - thotë Galina. Dhe sytë i rrëmbushen me lot.

- Mos u mërzit, - e ngushëllon Frida Ofman. - Nëna juaj gëzon shëndet të plotë. Ju garantoj që do i kapërcejë njëqind vjetët.

Z. Martinez përtypet njëherë si zakonisht; pastaj heq kapelen, prek me mollëzat e gishtave plagën e sapombyllur në çaçkë të kokës, dhe… O zot sa i kruhet! Por, siç e thamë, zoti Martinez është durimtar i madh. Sërish vendos të mos e kruajë.

- Ditën e mirë, - thotë Frida Ofman.

- Ditën e mirë, - ia kthejnë të dy përnjëherësh.

Frida Ofman, përshkon korridorin me hapa të shpejtë, hap derën kryesore dhe humbet në rrugë mes dyndallës së njerëzve që shkojnë e vijnë.

- Ju lutem, z. Martinez, a mund të më përcillni deri në katin e nëntë? - pyet Galina. - Dua t'ju tregoj diçka.

- Patjetër, - thotë z. Martinez.

Ajo vendos në dysheme qeset me ushqime që mbante në dorën e djathtë, shtyp butonin për në katin e nëntë ku banon e ëma e saj nëntëdhjetëvjeçare, nxjerr nga xhepi një facoletë dhe prek me të sytë e njomur me lot.

Ashensori nis të ngjitet lart.

-Te lutem, fol me pronarin e pallatit, që ta lyejë apartamentin e mamasë time, - thotë ajo - U bënë plot shtatë vjet, që nuk është lyer. A është e drejtë kjo?

- Jo, kjo nuk është e drejtë, - thotë z. Martinez.

- Dritaret hapen e mbyllen me shumë vështirësi. Nuk mbaj mend mirë, por më bëhet se u a kam thënë këtë kohë më parë…

- Po, ma keni thënë, - thotë z. Martinez. - Por janë shumë të vjetra. Skeleti i tyre prej druri, është mufatur e kalbur nga lagështira. Nuk kam çfarë bëj.

- Frigoriferi, gjithashtu, nuk ftoh aq sa duhet. Do ta shikoni edhe vetë…

- Këtë nuk e dija, - thotë z. Martinez.

Ashensori ndalon në katin e pestë.

Hapet dera.

Para tyre shfaqet sërish ai nëpunësi i ngjallmë i postës, që vazhdon të kullojë djersë.

Z. Martinez, sërish bën shenjë me gishtin tregues. Kësaj here, i jep tjetrit të kuptojë që ashensori po ngjitet lart.

Nëpunësi i postës bën një gjest pakënaqësie me dorë. Gjithë përtesë, niset për të zbritur shkallëve.

Dera mbyllet dhe ashensori fillon të lëvizë.

-Frigoriferin po e blejë vetë, - thotë Galina me një zë që i rezonon thellë në kraharor. - Do blej edhe televizor të ri. Sobën e gatimit, gjithashtu, do e hedh në plehra, do blej një tjetër shumë më të mirë. Do vendos tapetë të butë në dhomën ku fle nëna ime… Edhe për dhomën e ndenjes do blej tapetë të butë. Gjithashtu, dua t'i ndërroj të gjitha dritat në tavane; do blej abazhure që varen, nga më të bukurit që mund të gjenden. Nëna është mbretëresha ime. Sëmundja ia ka fshirë gjithë kujtesën, e ka bërë të mos më njohë as mua, që jam vajza e saj; por nuk ka gjë, e njoh unë atë…

Dhe sërish, prek me facoletë sytë e rrëmbushur me lot.

- Më thoni, çfarë kërkoni nga unë? - pyet disi i prekur z. Martinez.

- Të më ndihmoni t'i montoj të gjitha këto sa thashë, - i lutet ajo. - Dhe t'i kërkoni pronarit të lyejë apartamentin. Do ju a shpërblej mirë mundimin. Më thoni, sa doni?

Z. Martinez përtypet sërish; pastaj heq kapelen, prek me mollëzat e gishtave plagën e sapombyllur në çaçkë të kokës, dhe… O zot sa i kruhet! Por zoti Martinez,- e thamë dy herë, por ia vlen ta themi apet, - është durimtar i madh. Sërish vendos të mos e kruajë.

- Pesëqind dollarë, - thotë ai.

- Dakord, - pranon ajo. - Dhe do u jem shumë mirënjohëse, ta dini.

Ashensori mbërrin në katin e nëntë.

Hapet dera.

Z. Martinez përkulet, kap qeset e mbushura me ushqime, që ajo i pati lënë në dysheme dhe i bie pas drejt apartamentit 9B, ku banon mbretëresha e saj.

Me tu kthyer, z. Martinez zë vend përballë ashensorit. Shtyp butonin, heq sërish kapelen, prek me mollëzat e gishtave plagën e sapombyllur në çaçkë të kokës, dhe sërish bie në dilemë: ta kruajë, apo të mos e kruajë?

New York, verë, 2018

Të gjithë librat e Ramiz Gjinit mund t'i gjeni pranë rrjetit të librarive Adrion në Tiranë, librari ART'S te ish-Stacioni i Trenit, librarisë M&B në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari "Fleta XXI" në Peshkopi.

Email: mbbotime@gmail.com

Tel: +355 69 20 68 603 (Viber)

+355 68 65 08 441 (Whats App)









Dibra dhe Skënderbeu meritojnë një përmendore aq të lartë sa të shihet në Dibër, në Prizren, në Shkodër, në Janinë, më tej edhe në Beograd, në Romë e Venedik, në Athinë dhe në Stamboll.

Përse u harrua Dibra në këtë përvjetor të vdekjes së Skënderbeut?!

(vijon nga faqja 19)

Skënderbeu sulmoi dhe çliroi Danjën nga malazezët e krishterë. Ai i preu rrugën katolikëve të Malit të Zi për të vendosur sundimin e tyre në Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë e deri në Korfuz. Skënderbej dibrani u preu rrugën italikëve për të dalë në gadishullin e Ballkanit si dikur Perandoria Romake. Skënderbeu i Dibrës për herë të parë i bashkoi shqiptarët në Lezhë, e mbrohej prej dibranëve për të evituar sulmet e turqve dhe të venedikasve. Skënderbeu i Dibrës vazhdon të jetë mësim, atdhedashuri dhe guxim për shqiptarët e të gjitha kohërave. Lexuam edhe një shkrim të një matjani që pretendon se Skënderbeu na paska qenë matjan. Matjan ishte Ballabani, që nuk e degjoi Skënderbeun për tu kthyer në atdhe edhe si bari, sepse kështu do të ishte më i nderuar.

Çfarë i dha Dibra e Skënderbeut Shqipërisë gjatë luftërave 1443-1468 e më tej? Mbështetur në të dhënat e defterëve turk, të viteve 1430 dhe 1467 Kristo Frashëri bën krahasimin: Në vitin 1430 Dibra kishte 57700 banorë, ndërsa në vitin 1467 kishte vetëm 10700 banorë (57700-10700=47000). Dibra i dha Shqipërisë 44000 dëshmorë e të larguar. Dibra kishte 171 fshatëra dhe i mbetën 153. 18 fshatëra u zhdukën fare. Çdo fshat kishte jo më pak se 40 shtëpi me familje të mëdha patriarkale. Mbetën vetëm 5-6 shtëpi për çdo fshat, gjithashtu numri i pjestarëve të familjes u pakësua shumë. Ja pra cfarë i dha Dibra këtyre luftërave të udhëhequra nga Skënderbeu për të siguruar vazhdimësinë e jetës shqiptare në viset e veta. Studiuesit e historisë duhet të kishin zbritur prej kohësh në Dibër për të kërkuar këto xhevahire të ruajtura nga populli i Dibrës. Asnjë historian veçuar Kristo Frashërit dhe Pëllumb Xhufit nuk kanë kërkuar në Dibër. "Sikur edhe për kureshtje" për të vizituar fshatin e Kastriotit e emërtimet e shumta me këtë emër. Dibra kurrë nuk e ka kursyer dijen, punën dhe gjakun për interesat kombëtare. Dibra ndali vërshimin sllav(serbo-bullgar) të vazhdonte pushtimet në Ballkan. Dibra i tregoi Hajredin Pashës se populli shqiptar e Skënderbeu jetojnë. Dibra ndali Car Dushanin dhe e detyroi të ikte nga kishte ardhur. Dibra, në vitin 1913, ndali serbët të dilnin në Durrës për të penguar shpalljen e pavarësisë. Dibra i dërgoi Shkodrës mbi 3000 burra luftëtarë për ta mbrojtur nga Karadaku. Kur pyeteshin këta luftëtarë se ku po shkonin ata përgjigjeshin: Shkojmë të biem shehidë (dëshmorë), as për plaçkë e as për vjedhje. Dibranët nuk iu bindën Ali Pashë Tepelenës për të vrarë meshkujt e një fshati shqipëtarë, vetëm pse ishin kundërshtarë të Aliut. Ata i thanë: "Pasha", nuk kemi ardhur tek ti për të vrarë shqiptarët, por për të mbrojtur vendin nga të huajt. Dibra e vetme ka mbrojtur kufijtë prej pushtuesve të huaj.

Dibra i dha titullin "Hero Kombëtar" Krujës. Përsëri ishte dibrani Haxhi Lleshi që në kuadrin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, 1968, ai që ia dorëzoi popullit të krujës këtë dekoratë të lartë.

Edhe Lezha e cila shijon nderin që i bëhet prej 500 vjetësh për Lidhjen e Lezhës e ka nga Dibranët. Kjo lidhje u arrit sepse ishte dibrani Skënderbej që e organizoi këtë lidhje, ishin dibranët ata që e rrethuan për mbrojtje dhe e mbrojtën këtë qytet, bënë të arrihej kjo lidhje.

Kush ishte qëllimi i luftës së Skënderbeut? Pse Skënderbeu la të jetuarit në kryeqytetin e botës së atëhershme, Stambollin, dhe erdhi të flejë maleve e të ushqehet me ushqimet më të thjeshta që gatuante populli shqiptar! Pse Skënderbeu la lavdinë që mund të siguronte në perandorinë më të madhe të kohës dhe erdhi të luftonte për një popull kaq të vogel? A luftoi Skënderbeu për fe dhe për çfarë feje? Të gjitha këta pyetje e kanë përgjigjen shumë të qartë. Ai erdhi dhe luftoi për lirinë e popullit të tijë. Ai erdhi t'i sigurojë popullit të tijë lirinë dhe pavarësinë. Skënderbeu në moshën e re në Shqipëri thuhet se ishte i besimit ortodoks edhe pse nuk e njihte këtë fe, në besimin e familjes së tij. Në Stamboll ndoqi shkollat më me emër të Stambollit, ndoqi medresetë që në themel të programit të këtyre shkollave ishte Kurani. Në mënyrë krejt të ndërgjegjshme njohu fenë Islame dhe u konvertua në Islam. Vetë zgjodhi



emrin Skënder. Më vonë, shumë më vonë, kur ai numërohej komandant i zoti për ushtrinë turke, sulltani i dha gradën Bej dhe u quajt Skënderbej. Me këtë emrër muslimani luftoi, fitoi dhe thuri lavdi kundër pushtuesve turq, kundër venedikasve të krishterë, kundër të gjithë atyre që kërcënonin vendin tonë. Përse pretendojnë të krishterët ta quajnë Skënderbeun të krishterë? Në vitin 1998, misionari i krishterë Mark Klark, punoi disa vite në Dibër dhe propaganda e tij ishte: Skëndërbeu ka qenë i krishterë prandaj kthehuni në fenë e të parëve tuaj, në fenë e Skënderbeut. Askush nuk i shkoi prapa. Skënderbeu nuk luftoi për fe, luftoi për atdhe. Ai luftoi me të njëjtën ashpërsi kundër turqve muslimanë, kundër venedikasve dhe italikëve të krishterë dhe kundër gjithë atyre që kërcënonin vendin tonë. Ja disa të dhëna të tjera interesante, të dhëna nga ortodoksi Kristo Frashëri dhe të tjerë, që tregojnë se Skënderbeu nuk ka qenë i krishterë. Ai bëri ndryshime në kanunin ekzistues atëherë, bëri kanunin e tij mbi shumë baza islame. Ky kanun ka marrë jetë në Dibër: 1-Si i miri si i keqi janë njësoj. Prej të mirit del i keqi dhe prej të keqit del i miri. (Në kanunin e krishterë ishte ndryshe) 2-Vendin e kreut të shtëpisë duhet ta zejë pjestari më i aftë i familjes. 3-Fëmija kur lind e ka pjesën njësoj me të madhin. 4-Gruaja mund të ndahet me burrin vetëm për vjedhje e punë të pandershme, ndryshe sa thuhet në kanunet tjera. Gruaja merr sa gjysma e pjesës së pasurisë së burrit. 5-Gjaku nuk ngel për faj, ai shkon për gisht e jo për fis (Dënohet vetëm fajtori). Të tëra këto sipas normave të fesë Islame. Thuhet e shkruhet se në familjen e Gjon Kastriotit numëroheshin së paku 5 muslimanë: Gjoni, tre djemtë dhe Hamzai.

Kush ishte karakteri i Skënderbeut? Tërësia e veçorive psiqike e morale që përbëjnë individualitetine njeriut e që shfaqen në sjelljet dhe punët e tij ishin më të spikaturat që formonin karakterin e Skënderbeut. Skënderbeu ishte i vendosur në arritjen e qëllimit të tij e që ishte liria e pavarësia e popullit të vet. Ai ishte besnik, trim, i pa përkulur, i drejtë, i dashur me njerëzit. Që të gjitha këto i mbyllin të gjitha rrugët për ta akuzuar Skënderbeun si "tradhëtar", si kaçak, si thyes i besës etj. Ai dhe vetëm ai mundi me këta cilësi e veti të rralla të luftojë e të fitojë kundër perandorisë më të madhe të asaj kohe, Turqisë, por edhe kundër Venedikut, kundër tyre edhe kur ishin së bashku.

Dibra dhe Skënderbeu meritojnë një përmendore aq të lartë sa të shihet në Dibër, në Prizren, në Shkodër, në Janinë, më tej edhe në Beograd, në Romë e Venedik, në Athinë dhe në Stamboll. S'ka pse fshihen zyrtarët tanë kur kanë vizitorë të huaj. Ky lapidar, ashtu siç u ka dhënë zemër në të kaluarën, do tu japë edhe brezave të ardhshëm për mbrojtjen e atdheut, por edhe kujtesë për të huajt se këtij populli që nuk iu ul koka për rreth 3000 vjet beteja e qëndresë me më të mëdhenjtë e kohërave, do të vazhdojë të jetë i lirë e i pavarur.

Gurri i Vashës

(vijon nga faqja 20)

Kur panë trimat e tyre, nisën të këndojnë këngën tradicionale të besnikërisë. "Ne dëgjonim erën e malit dhe e kuptonim shushurimën e fjalëve të gjetheve. A kishte lajmëtar më të mirë për të na treguar për luftën e trimave dhe nëse ata jetonin, se sa era që vinte nga mali i lartë? Zogjtë krahëlehtë na pëshpëritnin gjithmonë se ata luftonin si dragonj dhe jetonin si shqiponja. Ne, vashat, i presim ata, i presim me net e ditë. Për nëntë vjet, nëntë muaj e nëntë ditë do t'i prisnim te pragu i portës dhe nuk do të martoheshim. Ne, vashat do të pyesnim yjet, shqiponjat dhe valët e detit se ku gjendeshin trimat tanë. Dhe vetëm kur këta do të heshtnin dhe nuk do të përgjigjeshin,ne do të martoheshim me dheun e zi. Por trimat u kthyen dhe gëzimi rrjedh nga buzët tona. Në sytë e tyre ndrit fitorja, në duart e tyre shkëlqen shpata".

Pasi mbaroi kënga vajzat u takuan me djemtë dhe nuset me burrat e tyre. Lulashi dhe Zaimira qëndronin përballë, shiheshin sy në sy, digjeshin nga mall e dëshira dhe heshtnin. Djali nxori nga xhepi shaminë dhe e hapi. Shpata dhe zemra qëndronin pranë e pranë dhe mbronin portretin e vogëlushit.

U dëgjua përsëri topi dhe gjithë populli shkoi të hidhte një grusht dhe në varret e trimave. Mjekët popullorë merreshin me të plagosurit. Varoshi atë natë nuk flinte. Si një luan i stërmadh ai lëpinte plagët dhe përpiqej t'i shëronte.

Shpejt u bënë edhe dasmat. Në dasmën e Lulashit e Zaimirës morën pjesë kapedanë dhe luftëtarë.

* * *

Ditët pas martesës ishin shumë të bukura. Dhe muajt kalonin me shpejtësinë e veriut. Por zbuluesit që vinin nga Lindja sillnin lajme të reja për afrimin e armiqve. Në mjegullën e pluhurit nuk dalloheshin sa mijëra rrugëtonin, por dihej se karvani s'kishte të mbaruar, sikur tërë Perandoria po sulej kundër Arbërisë.

Skënderbegu mblodhi përsëri luftëtarët dhe, kësaj here, i ndau forcat pjesë-pjesë.

Çetat filluan ta godasin armikun në befasi. Pashai, që e kishte ngrehur çadrën në kalanë e Grazhdanit, ishte nervozuar shumë dhe komandantët nuk guxonin t'i tregonin më për humbjet e ushtarëve. "Ku janë të mallkuarit - turfullonte ai. -Vijnë, na godasin dhe zhduken si një ëndërr".

Pashai u mbyll në çadrën e tij ngjyrë rozë dhe tri ditë e tri net nuk doli fare. U përgatit hyxhymi i madh kundër vendasve. Të huajt u ngjitën nëpër kodra. Por këmbë burri nuk dukej gjëkundi. Tri ditë e tri net turqit nuk lanë gur pa përmbysur dhe qoshe pa kontrolluar. Frymë njeriu nuk dukej. Të tërbuar, ata dogjën disa shtëpi, vranë Këngëtarin e Verbër dhe disa qen stani. Ditën e katërt ata u kthyen në kala dhe i njoftuan pashait se mbi shqiptarët kishte rënë murtaja e perëndisë dhe ata qenë zhdukur. Pashai vështroi malet. "Të jetë e vërtetë?! Kaçakët, dinsëzëtl" - shfreu me urrejtje. Sa qetësi kishte tani në male! Ai urdhëroi të festohej fitorja dhe kazanët e mëdhenj u vunë në mes të sheshit.

Lajmi i fitores së tyre përshkoi tërë ushtrinë që ishte shpërndarë fushave, brigjeve të lumenjve dhe gjer në kalanë e Sllugit. "Erdhi koha të më njohin se kush jam unë" - mërmëriti me egërsi pashai, duke mbushur me kabuni lugën e florinjtë, dhuratë e padishahut.

Pas disa ditësh kasnecët përhapën në të gjithë Lurën urdhrin: "Pashai kërkon 300 nuse nga Lura në kalanë e Grazhdanit". Gratë dhe nuset e reja shtangën nga habia. Ato drejtuan sytë nga malet dhe fjala arriti shpejt në veshin e Skënderbegut, që po përgatitej së bashku me trimat e tjerë.

* * *

Trimat u mblodhën në kuvend përpara kryekomandantit. Ata ishin të zymtë e të menduar. "Ai kërkonte 300 nuse në çadrën e tij?!" Biseduan mes tyre dhe shpejt ranë dakord. Natën, duke u kacavjerrë si ketërit, shumë luftëtarë zbritën në fshatra, u hapën sëndyqet e nuseve dhe vajzave të fejuara e u përgatitën edhe treqind duvakë.

Nuk kaloi më shumë se një javë, kur u përhap lajmi tjetër: 300 nuset ishin nisur nga Lura për në kalanë e Grazhdanit.

Nuset rrugëtuan gjatë. Në krye u printe jevgu i lodrës, që i binte të njëjtit ritëm: tam-tam! dhe, në interval, vetëm shurdhëri.

Kur karvani i gjatë i kuajve u duk atje tej, në kampin tjetër ranë trompetat dhe borijet. Pashai u ngrit rëndë-rëndë në këmbë duke fërkuar duart e ngallura. Hija e trishtimit sikur po i davaritej. ashtu si mjegullën që e përpin lugina e lumit. Ndjeu një lehtësim në shpirt, ndonëse nuk i hiqej një merak. E megjithatë, shendi i ushtrisë e kapi edhe atë. "I nënshtrova! Arbëria e Skënderbegu u gjunjëzuan përpara meje!". Në mesditë vargani kaloi portën kryesore të kalasë. Një oficer deshi t'i zbulonte vajzat, por jevgu i lodrës i tha se vajzat shqiptare nuk zbulohen para një ushtrie të tërë. Do t'i dorëzonin me nder, pastaj le të bënin ç'të donln me to. Atëherë i numëruan, i morën në dorëzim dhe një togë asqerësh i shoqëroi për te pashai. Jeniçerët faleshin për këtë mrekulli të zotit. Nuset hipur mbi kuaj, kishin ulur kokën nën duvakun e kuq e të rëndë.

Rreth e rrotull mbretëronte një heshtje e thellë, e pazakontë. Ç'do të bënte tani pashai? Ai i bëri shenjë jeniçerit më të çartur të zbulonte nusen e parë. Të tjerët shqyen sytë dhe ia patën zili fatin. Kur jeniçeri zgjati dorën për t'i ngritur duvakun nuses, befas u dëgjua një fishkëllimë. Pas fishkëllimës të treqind nuset flakën duvakun. Jeniçeri ra me shpatën e ngulur midis brinjëve. Turqit u tronditën e u tmerruan. Nën duvak qenë fshehur treqind luftëtarë, që shtrëngonin frenat e kuajve. Me shpejtësinë e vetëtimës, ata nxorën shpatat dhe me klithma e thirrje u sulën kundër të huajve. Edhe në këtë betejë gjaku vajti deri në gju të kalit. Beteja zgjati dy orë dhe brenda kësaj kohe u vranë shumë njerëz. Pashai mezi shpëtoi e ia mbathi për te Sulltani.

Lajmi i fitores së Grazhdanit u përhap me shpejtësi dhe ushtria armike u ngrit e u nis pas pashait të saj. Njëzet luftëtarë nga garda ranë për liri, kurse Lulashi e të tjerë të plagosur rëndë, mezi mbaheshin.

Bashkëluftëtarët u lidhën sa mundën plagët dhe i nisën për në Varosh. Kur iu afruan qytetit të heshtur e në zi, Lulashi ndaloi kalin, ngriti me mundim sytë dhe pa nga bedenat e kalasë. Vështrimi i tij i mjegulluar nga humbja e gjakut, me vështirësi i dalloi vajzat dhe nuset e reja që prisnin trimat e tyre atje lart. Zaimira nuk ndodhej midis tyre. Atëherë, me forcat e fundit rrotulloi qafën dhe vështroi nga Guri i Vashës. Edhe te Livadhi i Limoçës prisnin një grup grash. Sipas traditës, te ky vend, luftëtarëve u dilnin përpara gratë shtatzëna. Ata puthnin shpatat e luftëtarëve që fëmijët e tyre të bëheshin trima si baballarët. Lulashi nguli sytë te Guri i Vashës dhe u përpoq të dallonte Zaimirën. Ku ishte? Ku ishte?... Dhe e dalloi. Ajo... midis nuseve të tjera. Zaimira ishte... Lulashi ndjeu një sëmbim në zemër dhe gjaku i pakët, që i kish mbetur në trup, sikur gurgulloi nëpër damarë me forcë. Ai nuk ia ndau sytë Zaimirës dhe s'i durohej gjersa kali të afrohej pranë saj. "E unë mendoja, a mund të mbilleshin luftëtarë? Ne do të pinim vesën e mëngjesit dhe të gjitha ujërat, ujërat e liqenit, të puseve, të vijave të borës e të pellgjeve, do t'i ruanin për të vaditur tokat me luftëtarë. Hej, Lulash - i tha vetes. Po luftëtarë ne do t'na lindin gratë tona. Gjersa të ketë djem për t'u martuar, gjersa do të ketë vajza që do të bëhen nëna dhe gjersa të ketë nëna që do të tundnin djepat, për Arbëri nuk do të shuhemi".

Kali kishte qëndruar te Guri i Vashës dhe Zaimira ishte afruar. Ajo shikoi me ndrojtje barkun disi të rritur dhe puthi shpatën e Lulashit. Lulashi deshi t'i thotë një fjalë të ëmbël, por nuk pati fuqi të hapte gojën. Luftëtari u përkul mbi qafën e kalit, u kap pas jeleve dhe... mundi të zbresë.

Zgjati dorën drejt saj, por nuk arriti. Me pikëzat e fundit të fuqisë që buron nga shpirti njerëzor e mbështeti dorën mbi barkun e nuses së re. Vetëm tani Zaimira kuptoi se ç'donte të bënte i shoqi. "O Zot! I vogli ishte aty. I gjallë". E goditi barkun e nënës dhe Lulashi e ndjeu atë. "O Zot! Ç'krijesë e magjishme!" Ai lëvizte, ishte pranë tij!

Lulashi u ul në gjunjë dhe krejt i pafuqishëm e mbështeti kokën mbi barkun e gruas. Zaimira i përkëdheli tëmthat. O Zot! Ishte ai! Të tjera goditje ia grafulluan gjakun burrit, gjersa trupi iu lëshua ngadalë e hijshëm në tokë.

nekrologji

Lamtumirë miku ynë **Ramazan Rama**!



Ike shpejt nga kjo botë zhurmë madhe miku ynë Ramazan. Nuk e menduam kurrë ikjen tënde në këtë mënyrë kaq të qetë, kaq të paqtë por vdekja u tregua tinzare. Të shkëputi në këtë mënyrë nga gjiri ynë, nga miqësia, shoqëria, familja dhe të mori në botën e përtejme. Të mori në një moshë që ende ne, miqësia, shoqëria, familja kishim shumë nevojë për ju.

Ramazan Rama ishte djali më i vogël i Ismail Melanit. Ishte lindur më 9 gusht të vitit 1952 në një familje të madhe e të njohur patriotike e atdhetare në fshatin Melan. Jeta e tij nuk ishte se jeta e bashkëmoshatarëve të tij. Jo, i takoi të kalonte mjaft peripeci të vështira, duke u goditur edhe nga ajo e quajtura Luftë e klasave, se i ati i tij, Ismail Melani që shkriu pasurinë për luftën e madhe nacional-çlirimtare paska "gabuar në ideologji", dhe domosdo që këto "gabime" duhej ti paguanin fëmijët e tij.

Shkollën fillore e përfundon në fshatin e tij të lindjes Melan me nota të mira dhe shtatëvjeçaren në Grevë. Vazhdon me sakrifica të mëdha gjimnazin në qytetin e Peshkopisë të cilin e përfundon me nota të mira por për arsye biografike nuk i japin të drejtë studimi për në shkollë të lartë.

Pas mbarimit të gjimnazit, duke parë dhe rezultatet e tij dhe me ndërhyrjen e miqve të familjes e dërgojnë në një shkollë dy vjeçare në Tiranë për totpograf të cilën e mbaron në vitin 1974. Sapo mbaron këtë shkollë fillon punë pranë Ndërmarjes së Ujrave në Peshkopi si dhe në Ndërmarjen e Bonifikimit po në Peshkopi ku punoi dhe dha kontributin e tij disa vjeçar në sektorë të ndryshëm dhe gjiothmonë larg vendlindjes si në Liqenin e Zi në Tërnovë, ndërtimin e kanalit Lubalesh- Gjoricë, në ndërtimin elagjes së re Kamen, në ristrukturimin e rrugës Bllatë-Maqellarë etj.

Ramazani punoi në Lurë, Selishtë, Bulqizë, Kala të Dodës dhe kurrë nuk u ankua apo të mërzitej për këto pa drejtësi që i bëhej, përkundrazi ai punoi fort, me disiplinë dhe dijet e tij i vuri në zbatim gjithmonë të veprave që ndërtoheshin. Ishte njeri i thjeshtë, kërkues shumë karshi vetes dhe të tjerëve, këmbëngulës dhe korerekt në marrëdhënje me punën dhe njerëzit sa të ngjallte vetëm respekt.

Ramazani nuk u ankua kurrë edhe për rrugën që bëri katër vite me radhë nga Melani në Peshkopi për të vazhduar gjimnazin, në kohë me borë dhe me shi, dhe ia doli, ia doli për mrekulli se e përfundoi shkollën me rezultate të shkëlqyera. Nuk u ankua as kur bënte rrugën nga Melani në Lurë, në Selishtë, në Bulqizë më së shumti në këmbë si dhe anasjelltas. Jo, ai nuk dinte të ankohej, ai dinte të punonte, dinte të buzëqeshte, dinte të ndidhmonte të tjerët.

Në vitin 1979 martohet me Meliha Asllani

Ramazan Rama sot nuk është më midis nesh por tek ne ka lënë një boshllëk të madh. Do na mungosh Ramazan, do na mungosh me atë buzëqeshjen tënde duke pirë kafen e mëngjesit, do na mungojnë ato shakatë e tua të zakonshme, do na mungojë ajo sjellja jote bujare dhe fisnikëria juaj e rrallë.

nga Kërçishti i Poshtëm ku lindën, rritën dhe arsimuan pesë fëmijë: Ismailin,Nevilën,Xhemilen, Jonidën dhe Fikretin.

Pikërisht në moshën më të bukur, në kohën më të mirë, kur ishte bërë gjysh disa herë dhe nipërit dhe mbesat i mbushnin atë boshllëk që ia krijuan vitet e rinisë, Ramazan Rama ndahet nga jeta fare pa pritur duke lënë në pikëllim miq e shokë, familjen, vëllezërit e motrat, bashkëshorten djemtë e vajzat, nipërit e mbesat.

Ramazan Rama sot nuk është më midis nesh por tek ne ka lënë një boshllëk të madh. Do na mungosh Ramazan, do na mungosh me atë buzëqeshjen tënde duke pirë kafen e mëngjesit, do na mungojnë ato shakatë e tua të zakonshme, do na mungojë ajo sjellja jote bujare dhe fisnikëria juaj e rrallë.

Dheu qoftë i lehtë për ty miku dhe shoku ynë Ramazan! Njeriu nuk është i përjetshëm në këtë botë, por ajo çfarë ke bërë dhe ndërtuar ti ndër vite do të mbetet e pa vdekshme, miku dhe shoku ynë Ramazan!

Nehat Daci, Shkëlqim Pula,
Hidër Daci, Shaqir Skarra

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

Në kujtim të inxhinierit
Xheladin Torba

Kryeinxhinieri fjalëpak e punëshumë

Nga **HASHIM HOXHA**



Rreth një vit më parë u nda nga jeta inxhinieri i palodhur, qytetari korrekt dhe i përkushtuar, bashkëshorti i sjellshëm dhe prindi shembullor Xheladin Torba. E shoqja Resmia dhe dy djemtë e tij Ermali dhe Andrini do ta kujtojnë gjithmonë me respekt jo vetëm për vlerat dhe cilësitë personale profesionale, perspektivën që u hapi me djersën dhe ndershmërinë e tij.

Xheladini lindi në Shimçan në vitin 1943. Me të mbaruar teknikumin e ndërtimit plot dëshirë dhe vullnet, pa u dekurajuar nga vështirësitë, punoi si teknik zbatimi në Rruga Ura Milot – Qafë-Buall dhe segmentet e vështira malore të minierës së kromit Bulqizë. Pas përfundimit të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Inxhinieri Ndërtimi Ndërtimi që nga viti 1968 deri në vitin 1972 kontribuoi me devotshmërinë që e karakterizonte në qytetin e largët të Bajram Currit. Atje për mëse 5 vite dha kontributin e tij modest në ndërtim apartamentesh banimi, objektesh social-kulturore, shkolla, spitale, kinema, rrugë rurale për të lidhur fshatrat e zonës mes njëri-tjetrit etj.

I pafjalë dhe me devotshmëri të shtuar pas emërimit si inxhinier zbatimi në Dibër punoi kudo ku e caktuan dhe ku ishte i nevojshëm duke filluar nga kantieret më të vështira që prej metalurgjikut të Elbasanit (Dibra kishte një sektor atje) deri te hapja e rrugëve të thepisura të minierës Bulqizë, fabrikës së tullave Vakuf etj.

Puna e palodhur, përkushtimi e mbi të gjitha aftësitë profesionale iu shpërblyen. Në vitin 1876 e emëruan Kryeinxhinier të ndërmarrjes së ndërtimit Dibër në vartësi të të cilit ishin 5 kantierë me mbi 1200 punonjës. Me vrull të shtuar drejtoi dhe zbatoi punën teknike në ndërtimin e spitalit aktual të Peshkopisë, Pallatit të Madh të Kulturës, apartamente banimi (rreth 100 të tilla në vit, në Peshkopi, Bulqizë, shkolla 8-vjeçare dhe të mesme në çdo fshat të Dibrës, rrugën 25 kilometra Peshkopi-Kala e Dodës, Hecin e Arrasit mbi lumin e Setës, ujësjellësin aktual që vazhdon t'i shërbejë jo vetëm banorëve të Peshkopisë por edhe të shumë fshatrave të Dibrës, kanale dhe rezervuare të shumtë për vaditje etj. Banorët autoktonë të qytetit vazhdojnë ta vlerësojnë kontributin e tij për ndërtimin e fabrikës së pijeve alkoolike, fabrikës së qumështit, atë të bukës dhe mobilierisë së përpunimit të drurit. Aktiviteti i tij i shtrirë edhe në Bulqizë bëri që nga puna e tij e palodhur të përfundojë faza e dytë e përpunimit të kromit, u ndërtuan shkolla të shumta 8-vjeçare e të mesme, furra buke etj.

Shumë e rëndësishme dhe me vlerë të pallogaritshme ishte përvoja e tij në rikonstruksionin e tranverbangut Klos-Bulqizë duke i kursyer popullit 34 don bullona, 350 ton hekur dhe 1300 ton çimento.

Këmbëngulja dhe vullneti i tij në pozicionin e kryeinxhinierit të ndërmarrjes së ndërtimit për 16 vite bëri që Peshkopia të kishte frigoriferin me kapacitet 300 tonësh, fabrikën e makaronave, linja të ndryshme për prodhim inertesh, llaçi e betoni dhe ofiçina të pafundme.

Edhe pasi doli në pension përsëri tërhoqi mënjanë nga profesioni. Pasioni për punë dhe dëshira për të ndihmuar komunitetin e Dibrës e aktivizoi përsëri që nga viti 2001 deri në 2007 në drejtorinë rajonale rrugore Dibër si kryetar i degës teknike. Duke hartuar dhe zbatuar projektet e shumta, ai u kujdes në mirëmbajtjen e 242 km rrugë nacionale dhe rurale. Xheladini nuk u shqua dhe vlerësua nga të njohurit e shumtë vetëm për punën si kryeinxhinier. Mbi të gjitha ai ishte njeri me zemër të madhe sjellje pothuajse të përsosur. I respektueshëm dhe fjalë ëmbël me të afërmit dhe gjithë sa e njihnin mundohej të ndihmonte këdo që i drejtohej. Këtë lloj mirësjellje nuk e kishte vetëm me hallexhinjtë, por edhe me të persekutuarit e regjimit të mëparshëm. Shumë prej tyre gjenin strehë e përkrahje prej tij në ndërmarrjen që drejtonte. Jo vetëm kaq, ai këmbëngulte gjithmonë që puna e tyre të vlerësohej pa u trembur nga pozicioni i tyre denigrues prej pushtetit komunist. Ngritjet e herë pas hershme në kategori u mundësonin atyre rritjen e pagës. Të persekutuari e kësaj kohe dhe pasardhësit e tyre nuk ia harrojnë mbrojtjen e vendosur në ato vite të vështira si he ndihmën dhe guximin e pakursyer sepse vetëm ato që i kanë kaluar ato situata i njohin vështirësitë e asaj periudhe. Nga piedestali më i lartë përfundoje në batakun më të ndyrë të jetës. Por fati ndoshta edhe ndershmëria e kursyen atë dhe familjen e tij.

Xheladin Torba mbi të gjitha ishte njeri me zemër të madhe sjellje pothuajse të përsosur. I respektueshëm dhe fjalë ëmbël me të afërmit dhe gjithë sa e njihnin mundohej të ndihmonte këdo që i drejtohej. Këtë lloj mirësjellje nuk e kishte vetëm me hallexhinjtë, por edhe me të persekutuarit e regjimit të mëparshëm.

Nga tërë ky aktivitet dhe përkushtim i jashtëzakonshëm mund të thoshim pa drojë që duhet t'i akordohet një vlerësim nga institucionet vendore këtij inxhinieri të palodhur, që me kontributin e tij e bëri më të bukur qytetin tonë dhe më të pranueshme jetën e banorëve të Dibrës dhe Peshkopisë.



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose pwrmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

BOTIMET M&B

Librat më të shitur gjatë vitit 2018. Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë rrjetit të librarive "ADRION", librari "Art's" të Stacioni i Trenit në Tiranë, FletaXXI në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit.



cyan magenta yelloë black